


© “Copyright“

I

Ines Anna Maria JAHO

Viti, 2021



UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS

**FAKULTETI I BIZNESIT
PROGRAMI I DOKTORATURËS
“SHKENCA EKONOMIKE”**

**“MENAXHIMI I SEKTORIT ENER GjITIK
SHQIPTAR DHE NDIKIMI I REFORMAVE –
PAKETA 3-TË ENER GjITIKE”**

Doktoranti

Ines Anna Maria Jaho

Udhëheqësi Shkencor

Prof.Assoc.Dr. Osman Metalla

Durrës, 2021

Udhëheqësi i Ines Anna Maria Jahos vërteton se ky është version i miratuar i disertacionit të mëposhtëm:

**“MENAXHIMI I SEKTORIT ENERGHJITIK SHQIPTAR
DHE NDIKIMI I REFORMAVE – PAKETA 3-TË
ENERGHJITIKE“**

Prof. Assoc. Dr. Osman Metalla

Durrës, 2021

“MENAXHIMI I SEKTORIT ENERGHJITIK SHQIPTAR DHE NDIKIMI I REFORMAVE – PAKETA 3-TË ENERGHJITIKE”

Përgatitur nga: Ines Anna Maria Jaho

“Disertacion i paraqitur në Fakulteti i Biznesit Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës. Në përputhje të plotë me kërkesat për gradën “Doktor”.

Durrës, 2021

Dedikime/Mirënjohje

Jam mirënjohëse Zotit për cdo hap në jetën time, që e ndricon atë cdo minutë!

Dedikoj këtë punim djalit tim që më ka bekuar, familjes time për besimin e plotë tek unë gjithmonë! Personave të vecantë tek unë të cilët më kanë mbështetur pa kushte, vetëm që unë të realizoja këtë arritje si kompletim të viteve të mia në shërbim të dijes por edhe misionit tim.

Mirënjohëse udhëheqësit shkecor për suportin e pa ndare gjate kësaj faze.

Dedikoj këtë punim doktorature cdo personi i cili gjen veten tek dija, tek drita. Cdo personi i cili kontribuon për të cuar përpara punët e nisura në energji, sado në hije të jenë ata, janë motorri dhe shpirti i ndryshimeve dhe arritjeve. Puna e përulur e cdo njërit nga ne qoftë e mbare!

Ines Anna Maria Jaho

Deklaroj se kjo tezë përfaqëson punën time origjinale dhe nuk kam përdorur burime të tjera, përveç atyre të shkruajtura nëpërmjet citimeve.

Të gjitha të dhënat. Tabelat, figurat dhe citimet në tekst, të cilat janë riprodhuar prej ndonjë burimi tjetër, duke përfshirë edhe internetin, janë pranuar në mënyrë eksplicite si të tilla.

Jam e vetëdijshme se në rast të mospërputhjeve, Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore në Doktoratë të F.B është i ngarkuar të më revokojë gradën në Doktoratë, që më është dhënë mbi bazën e kësaj teze, në përputhje me Rregulloren e Programeve të Studimit të Ciklit të Tretë (Doktoratë) të UAMD-së, neni 33, miratuar prej Senatit Akademik të UAMD-së me Vendimin Nr. 16, datë 28.03.2013.

Durrës, më _____

Firma

Përmbledhje

Energjia në përgjithësi dhe ajo elektrike në veçanti është një nga produktet më të rëndësishme për një ekonomi. Ajo është forcë motorre pothuaj në të gjithë proceset ekonomike, sociale dhe jetësore të një vendi. Po kështu sektori i energjisë me të gjithë industrinë që e përbëjnë luan një nga rolet më të rëndësishme në rritjen e ekonomive kombëtare dhe në përgjithësi në zhvillimin e një vendi. Bazuar në këto konstatime tashmë të pranura gjërësisht si të vërteta, nisemi të analizojmë këtë sektor, të identifikojmë përbërësit e tij, problemet që e shoqërojnë, proceset që zhvillohen bashkë me sektorin dhe që e lidhin atë ngushtësisht me zhvillimin në të gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë dhe të një vendi në përgjithësi.

Përtej zhvillimit kombëtar energjia paraqitet si një produkt specifik edhe në nivel rajonal, ndërkombëtar dhe komunitar, e vendosur nën protokolle sjellje, kooperimi dhe zhvillimi që shpesh kushtëzojnë edhe modelet e zhvillimit të saj.

Ky punim synon të ofrojë një pamje të plotë dhe të detajuar të situatës teknike dhe financiare të sektorit të energjisë elektrike, shkaqet kryesore të gjendjes aktuale dhe mësimet e nxjerra deri tani, për një menaxhim më të mirë të sektorit. Punimi analizon arsyet e rritjes së performancës në fazën e parë të reformës, dhe njëkohësisht analizon qëndrueshmërinë e sistemit elektroenergjitik; dhe së dyti, vlerëson rrugën e re të zhvillimit të sektorit të zgjedhur nga Qeveria Shqiptare përmes një reforme të thellë që do mund të garantojë një funksionim më të mirë në kushtet e ekonomisë së tregut, duke përmirësuar dy treguesit kryesorë të tij, sigurinë e furnizimit me energji elektrike të ekonomisë dhe standardet e kërkuara të cilësisë, bazuar në standardet më të larta të furnizimit të saj (standardet e aplikuara në Komunitetin Europian të Energjisë dhe të kërkuara e monitoruara nga Sekretariati i këtij komuniteti për të gjithë vendet anëtare dhe palët kontraktore).

Punimi në vijim, merr në konsideratë gjendjen e sistemit elektro-energjitik shqiptar pas viti 2004 e deri në vitin 2014, duke bërë një ekzaminim të thellë dhe të detajuar të të gjithë zhvillimit të tij gjatë këtyre viteve, dhe duke analizuar edhe reformat e ndërmarra në këtë sektor për ta sjellë atë në një model të ri me performancë të lartë që i përgjigjet gjërësisht zhvillimit të përgjithëshëm të vendit, porë dhe më gjërë, të rajonit të Ballkanit Perëndimor, rajonit të Mesdheut dhe BE.

Ai fokusohet në vërtetimin e hipotezës se kjo reformë është e domosdoshme për të garantuar një zhvillim të tillë.

Fjalët kyçe: Energji elektrike, rrjete, sisteme, menaxhim i integruar, eficiencë, reformë, performancë, zhvillim.

Summary

Energy in general, but the electric energy in particular, is one the most important products for an economy. It is a driving force almost in the base of all the economic, social and vital processes of a country. The energy sector as well, including all the industries comprising it, plays one the most important roles in the growth of the national economies and, generally speaking, in the development of a country.

Based on such stated conclusions, already approved and verified widely as true, we start analysing this sector through this study, in order to identify its comprising elements, problems facing, and the processes running together with this sector, which closely connect it with the development in the all other sectors of the national economy and the development of a country generally.

Beyond the national development, the energy shows up as a particular product even in regional, international and community level, established under certain behaviour, cooperation and development protocols which often conditions even its development models.

This dissertation aims to offer a complete and detailed picture of the technical and financial situation of the power sector, the main causes of the actual situation and the lessons learned till now, in order to provide a better management of the sector. It analyses the reasons of the increased performance in the early stage of the reform and, in the same time, analyses the consistency and sustainability of the power system; second, it estimates the new road map of the development of this chosen sector to be reformed by the Government of Albania through a very deep reform, which will guarantee a better functioning in the premises of the free market economy, improving its two main indicators, security of supply with electric energy of the national economy and the required standards of the quality of supply, based on the highest standards of supply (the standards applied in the European Community of Energy and required/monitored from its Secretariat for all the member countries and the contracting parties).

The study continues with a review of the situation of the Albanian power system after 2004 until 2014, making a deep and detailed check-up of its development throughout these years, analysing as well the reforms carried in this sector in order to bring it in a new high performance model, in support of the general development of the country, but even wider, in support of the region of Western Balkan, Mediterranean and EU.

It focuses in the prove and certification of the hypothesis that this is a necessary reform in order to guarantee such a development.

Key words: Electric energy, networks, systems, integrated management, eficiency, reform, performance, development.

Përmbajtja e lëndës

	Faqe
Përmbledhje	7
Hyrje	14
KAPITULLI I PARË	
1.Tregu energjitik, gjendja, historiku dhe proceset ligjore e rregullatore	23
1.1 Historiku dhe proceset ligjore e rregullatore të ndërmarra në sistem	23
1.2 Historiku i kërkesës	37
1.3 Gjendja e sistemit dhe përcaktimi i problemit	40
1.4 Zhvillimi i kapaciteteve gjeneruese	45
1.5 Zhvillimi i rrjetit të transmetimit	46
1.6 Zhvillimi i rrjetit të shpërndarjes	47
1.7 Proceset e detyruara nga përafrimi i legjislacionit shqipëtar me atë europian	49
1.7.1 Paketa e tretë e energjisë dhe përafrimi i legjislacionit shqipëtar të energjisë	50
1.8 Ndarja (Unbundling) e sistemit në ndërmarrje të pavarura	50
1.9 Modeli i tregut pas ndarjes së shpërndarjes nga furnizimi	51
1.9.1 Detyrimi për shërbim publik në furnizim me energji elektrike	54
1.10 ERE - roli i saj rregullator	55
1.10.1 Sistemi i tarifimit me fashë	55
1.11 Reforma e vitit 2014	56
1.11.1 Kreditë e mëdha dhe implikimet e ndikuara prej tyre (Kredia e Bankës Botërore dhe kredia nga EBRD)	58
1.11.2 Investimet e kryera në sistem dhe nevoja për amendim e Planit të Rimëkëmbjes Financiare të Sektorit të Entërgjisë Elektrike	59
1.12. Situata dhe zbatimi i reformës në vendet e Ballkanit Perëndimor	62

KAPITULLI I DYTË

Rishikimi i literaturës, modeli i tregut dhe diskutime rreth ndërtimit dhe funksionimit të tij **65**

2.1 Vështrim kritik i literaturës	65
2.1.1 Legjislacioni i ri që rregullon sektorin e energjise elektrike	67
2.1.1.1 Ligji bazë i sektorit të energjisë elektrike	67
2.1.1.2 Ligji për energjitë e rinovueshme	68
2.1.1.3 Ligji për eficiencën e ndërtesave në konsum energjie	69
2.2 Dokumente të rëndësishme të fazës së dytë të reformës	69
2.3 Paketa e tretë e energjisë	75
2.4 Paketa e energjisë së pastër për të gjithë europianët	78

KAPITULLI I TRETË- Metodologjia **81**

3.1 Metodologjia e kërkimit dhe vlerësimit të të dhënave	81
3.2 Përcaktimi i hipotezave	82
3.3 Hartimi i pyetësorëve	83

KAPITULLI I KATËRT **85**

Analiza e të dhënave dhe rezultateve, si edhe testimi i hipotezave

4.1. Analiza e të dhënave dhe testimi i H.1	85
4.2 Analiza statistikore e të dhënave nga pyetësorët	87

KAPITULLI I PESTË - Konkluzione të studimit **126**

KAPITULLI I GJASHTË - Rekomandime e Përfundime **129**

ANEKSI **132**

BIBLIOGRAFIA **143**

Lista e Tabelave dhe Lista e Figurave

1. Tabela 1 Hendeku financiar i sistemit elektro-energjitik vendës	faqe 28
2. Tabela 2 Tarifat e shitjes së energjisë elektrike sipas reformës	faqe 30
3. Tabela 3 Projektionet e humbjeve të energjisë elektrike deri në 2020	faqe 31
4. Figura 1 Parashikimi i nevojës për mbështetje financiare e sektorit 2015-2024	faqe 34
5. Tabela 4 Parashikimet për humbjet dhe arkëtimet 2014-2022	faqe 36
6. Figura. 2. Kërkesa për financim në sektorin e shpërndarjes	faqe 37
7. Tabela. 5. Segmentet e konsumatorëve sipas konsumit	faqe 38
8. Tabela. 6. Familje në nevojë që përfitojnë mbështetje me subvencion direkt në skemë pensioni për efektet e reformës tarifore të energjisë elektrike	faqe 39
9. Figura 3. Prodhimi historik i energjisë elektrike në vend 2009-2019	faqe 45
10. Tabela. 7. Tarifat e reja të energjisë elektrike me bazë tensioni	faqe 56
11. Figura 4: Palët kontraktore në rajon dhe ALPEX	faqe 64
12. Tabela. 8. Pasqyra e elementeve të politikave të reformës të propozuara për fazën e parë.	faqe 73
13. Tabela. 9. Pasqyra e elementeve të politikave të reformës, të propozuara për afatin e dytë kohor të zbatimit të reformës.	faqe 74
14. Tabela. 10. Energji e pastër për të gjithë konsumatorët europianë - kuadri ligjor dhe rregullator	faqe 79
15. Tabela. 11. Situata detyrimeve financiare e sektorit publik të energjisë elektrike (milliard lekë)	faqe 86
16. Grafiku. 1. Ndikimi i rritjes së çmimit të energjisë elektrike në kosto në disa sektorë.	faqe 123
17. Grafiku. 2. Ndikimi i rritjes së çmimit të energjisë elektrike disa produkte ose shërbime.	faqe 124
18. Tabela. 1. Shpërndarja e të intervistuarve sipas qarqeve	faqe 126

Akronime

EC - Këshilli European

ACER - Agjensia për Bashkëpunim e Rregullatorëve të Energjisë

KESH - Korporata Elektro-energjitike Shqiptare

FPSH - Furnizuesi Publik me Shumicë

IPP - Prodhues Private të Energjisë

OST - Operatori Sistemit të Transmetimit

ERE - Enti Rregullator i Energjisë

OSHEE - Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike

PPE - Prodhuesit Privatë të Energjisë

OSSH - Operatori i Sistemit të Shpërndarjes

FSHU - Furnizuesi i Shërbimit Universal

EnC - Komuniteti i Energjisë

MIE - Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë

PRFSE - Plani i Rimëkëmbies Financiare të Sistemit të Energjisë

BB - Banka Botërore

ENTSO-E i Rrjeti European i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit - Elektrik

BE - Bashkimi European

FTL - Furnizuesi i Tregut të Lirë

OER - Operatori i Energjive të Rinovueshme

ALPEX i Bursa Shqiptare e Energjisë

PVE - Prodhuesit e Vegjël të Energjisë

HEC - Hidrocentral

EBRD - Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim

OD - Over Draft
 TEC - Termocentral
 TAP - Trans Adriatic Pipeline
 IAP - Ionian Adriatic Pipeline
 LNG - Gaz i Lëngshëm natyral
 CAO SEE i Kordinatori për Zyren e Ankandeve i Europës Jug Lindore
 SCADA- Autoriteti Mbikqyres mi Kontrollin dhe Përvetësimit të të Dhënave
 TSO - Operatori i Sistemit të Transmisionit
 OEN - Operatorët me Eksperiencë Ndërkombëtare
 PTE - Pjesëmarrësit e Tregut të Energjisë
 IFN - Institione Financiare Ndërkombëtare
 WB - Banka Botërore
 CGAP - Aksion Planit për Qeverisjen e Korporatave
 HUPX - Bursa Hungareze e Energjisë
 IEC - Statuti Ndërkombëtar i Energjisë
 BERZH - Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
 PRE - Politika e Elementeve të Reformës
 PBL - Politika e Huamarrjes Baze
 ENTSG - Rrjetet Europiane të Sistemit të Transmisionit për Operatorët e Gazit
 NECP - Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën
 SD - Devijim Standart
 PSO - Detyrimi i Shërbimit Publik

Hyrje - PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Sektori i energjisë është një nga sektorët në të rëndësishën të të gjithë jetës ekonomike në një shoqëri moderne industriale. Ai është përbërësi kryesor pothuaj në të gjitha aktivitetet njërëzore, duke filluar që nga gatimi, ngrohja, ndriçimi, shëndeti, ruajtja e produkteve ushqimore, prodhimi industrial dhe transporti. Cilësia dhe qëndrueshmëria e furnizimit të tregut me energji, është një nga objektivat kryesor të këtij sektori. Ka shumë faktorë që influencojnë në furnizimin me energji, ndër të cilat jo më pak të rëndësishëm janë dhe disponueshmëria e energjisë, çmimi si dhe aksesit ndaj saj.

Ky punim merr në analizë të thelluar fillimisht gjendjen e sektorit elektro-energjetik shqipëtar në vitet 2013-2014, faktet dhe problemet e tij të akumuluar ndër vite gjatë të gjithë ndryshimeve që ai ka pësuar. Ai shqyrton zbatimin e reformave në sektor para vitit 2014 si në reformimin e tij, ashtu edhe në përafrimin e legjislacionit dhe kuadrit rregullator që nga viti 2004 si dhe efektet që ka dhënë zbatimi i këtyre reformave në mirëmenaxhimin e sektorit. Më tej, punimi analizon të gjithë situatën nën këndvështrimin e gjetjeve të lidhura me këtë periudhë të zhvillimit të sektorit, për të renditur të gjithë elementët për të cilët kërkohej ndërhyrje dhe ndryshim, në mënyrë që të garantohej një performancë e rritur e sektorit dhe një reformim i plotë i tij sipas direktivës europiane dhe paketës së tretë të energjisë 2009/72/EC [Rregullorja për energjinë elektrike (EC) nr. 714/2009 dhe Rregullorja ACER, nr. 713/2009 e përmirësuar në lidhje me qasjen mjedisore me direktivën europiane 2009/72/EC], e cila mbulonte pesë aspekte të rëndësishme:

1. ndarjen e plotë dhe daljen më vete të operatorëve të sistemit të transmetimit dhe atij të shpërndarjes (unbundling process),
2. pavarësia e rregullatorit (në rastin tonë e ERE),
3. ACER (Agency for the Cooperation of Energy Regulators - çertifikimi i rregullatorit),
4. kooperimi ndër kufitar dhe
5. tregje të hapura e të drejta (asnjanëse).

Sistemi elektro-energjetik shqiptar është nën një proces të thellë reformimi për të përmbyllur plotësisht këtë proces në përputhje me direktivën evropiane të përmendur më lart dhe me të gjithë ndryshimet që kanë ndodhur ndërkohë nga lançimi i saj deri në vitin 2021, përfshirë dhe masat e reja të cilat duhet të ndërmerren për të bërë të mundur që efektet e pandemisë së covid-19 ndaj sektorit dhe konsumatorëve të jenë sa më të ulta dhe të menaxhueshme.

Në kushtet e mësipërme sektori energjetik po përjetonte një krizë të thellë financiare për shkak të privatizimit të dështuar të kompanisë së shpërndarjes që zotërohej me 75% të aksioneve të saj nga ana e kompanisë Çeke Ćez a.s. Në Tetor 2014 situata filloi të ndryshojë përmes rimarrjes së aksioneve nga ana e shtetit Shqipëtar i cili themeloi një kompani të re shpërndarje, kompaninë shtetërore ĆOSHEEò, e cila zotëron 100% të aksioneve, por me një situatë financiare të trashëguar mjaft të vështirë. Debitë për pagesat e energjisë elektrike nga konsumatorët fundorë ishin më shumë se 130 miliard lekë, borxhi ndaj të tretëve ishte mbi 75 miliard lekë. Sektori i shpërndarjes përballej me një kombinim

të sfidave që lidheshin me energjinë e pafaturuar për shkak të mungesës së matësve, ose matësve të dëmtuar dhe humbjeve në sistem, si dhe me arkëtimet e pamjaftueshme për energjinë e faturuar nga familjet dhe bizneset të cilat çuan në lindjen e problemeve financiare të ish-kompanisë private të shpërndarjes Cez Shpërndarje. Blerja e kompanisë nga shteti shqipëtar ishte e detyruar pas këtij falimentimi dhe kjo solli edhe kosto të tjera shtesë si pasojë e kredive të marra ndaj të tretëve nga Cez gjatë funksionimit të saj, të vlerësuara në një total prej rreth 92 milion Euro, shifër për t'u paguar tanimë nga OSHEE në katër këste vjetore. Ky borxh do të përfshihej i gjithi në tarifën e re fundore të energjisë për konsumatorët sipas nivelit të tensionit.

Humbjet e energjisë ishin rritur ndjeshëm ndërkohë që investimet në shpërndarje ishin të papërfillëshme dhe rrjeti i shpërndarjes në një gjendje shumë të rëndë teknike. Gjatë viteve të administrimit kur sistemi i shpërndarjes ishte i privatizuar, totali i investimeve në rrjet ishte vetëm 8 milion Euro nga mbi 900 milion Euro apo vetëm 0,89% e nevojave për ndërhyrje prioritare në rrjetin e shpërndarjes.

Varësia nga reshjet si dhe furnizimi vetëm përmes hidrocentraleve të KESH të vendosura në kaskadën e lumit Drin në veri të vendit dhe nga energjia e gjeneruar nga prodhuesit e vegjël private (gjithnjë hidro-energji), shkaktonte paqëndrueshmëri në prodhimin e energjisë elektrike në vend. Kjo përbënte një kërcënim në lidhje me parashikimin e importeve, duke sjellë kështu një rrezik për sigurinë e furnizimit.

Sfida e furnizimit me energji elektrike të Shqipërisë ndikohej më tej nga kufizimet e kapacitetit transmetues të brendshëm dhe të jashtëm të lidhur me rajonin, si dhe nga sasia e pamjaftueshme e energjisë në dispozicion për furnizimin dhe tregtim nga vendet fqinje. Kjo situatë, përballë ngjarjeve ekstreme klimaterike, ndikon negativisht jo vetëm në Shqipëri, por edhe tek fqinjët e saj, duke shkaktuar një efekt negativ. Situata elektro-energjitike e viteve 2017-2019 e vërtetoi këtë fakt dhe risk për sistemin. Dëmi i shkaktuar në sistem nga pasiguritë e motit dhe situata e vështirë hidrike në vend ishte rreth 135 milion Euro në 2017, rreth 80 milion Euro në 2018 dhe rreth 120 milion Euro në 2019. Kjo ishte energji e blerë në treg të lirë në kushte emergjence nga ana e OSHEE për të garantuar 100% sigurinë e furnizimit për tregun. Ndryshimi i situatave klimaterike si pasojë dhe e ngrohjes globale e bejnë këtë pasiguri gjithnjë e më prezente në sektoret e energjistikës.

Një vështirësi tjetër me të cilën sektori po përballlej, ishte detyrimi financiar ndaj energjisë së blerë nga PPE-të (Prodhuesit Privatë të Energjisë). Ky detyrim ishte akumuluar nga shtimi i sasisë së prodhuar nga HEC private (IPP) me më shumë se sasia e planifikuar dhe me tarifa shumë favorizuese blerjeje, shumë më të larta se çmimet e tregut të energjisë të vendosura nga ana e qeverisë dhe të miratuara nga ERE.

Një situatë e tillë e KESH kërcënonte shumë seriozisht sigurinë kombëtare dhe një kolaps potencial të sistemit elektro-energjitik në vend. Gjithashtu, kjo vendoste në risk mjaft të lartë zbatimin e projekteve për sigurinë e kaskadës të iniciuara nga KESH me ndihmën e partnerëve financiarë ndërkombëtarë. Pothuajse të gjithë detyrimet e KESH ndaj këtyre partnerëve përballoheshin nga buxheti i shtetit qysh prej vitit 2009, kur nga privatizimi i sistemit të shpërndarjes dhe ndarja e sistemit me tre nivele, transmetim, gjenerim dhe shpërndarje, nuk adresoi detyrimet e kaluara të KESH ndaj partnerëve financiarë të marra për ndërhyrje në transmetim dhe shpërndarje me investime.

Për shkak të fakteve të përmendura më lart, si dhe për faktin se sektori i energjisë është shumë i ndërruarur, çdo ndryshim në sistem jep menjëherë një efekt zinxhir nga një shoqëri në tjetrën. Duke marrë parasysh se OSHEE ishte e pamundur në kushtet aktuale (viti 2014),

që të gjeneronte të ardhura të mjaftueshme për të paguar kostot e saj, i gjithë sektori i energjisë ishte i ndikuar negativisht dhe në prag kolapsi.

KESH dhe OST ishin me aftësi paguese të dobët për shkak të situatës së mësipërme dhe si pasojë të vlerësuar me risk shumë të lartë financimi në tregun financiar. Kjo situatë ishte bërë e qëndrueshme dhe përbënte një rrezik të veçantë për KESH, meqë ai nuk mund të realizonte pagesat e kësteve të kredisë, të blente energji elektrike nga PPE-të, dhe të importonte energjinë e nevojshme për të plotësuar kërkesat e brendshme të tregut të rregulluar. Rrjeti i shpërndarjes ishte në pjesën më të madhe të tij pa u investuar prej mesatarisht 36 vjet.

Edhe pse u ndërtua termocentrali i Vlorës, kjo pasuri nuk është ende funksionale për shkak të problemeve të pazgjidhura teknike. Aktualisht KESH duhet të përballojë edhe kostot e shlyerjes së kredisë për ndërtimin e tij, si edhe kostot e ruajtjes dhe mirëmbajtjes së tij. Kjo kosto është afërsisht 1.4 miliard lekë në vit.

Në këto kushte, për të garantuar sigurinë e furnizimit me energji elektrike dhe cilësinë e saj në furnizim, kishte një nevojë urgjente për të realizuar investimet me objektiv zvogëlimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes, dhe për të zgjeruar dhe përmirësuar rrjetin e transmetimit të OST, për të realizuar një furnizim të sigurt me energji.

Duke pasur parasysh këto kushte, sektori nuk ka qenë në gjendje ta nxjerrë veten nga një *modus operandi* të menaxhimit të krizës, në një mënyrë të qëndrueshme operacionale. Prandaj Banka Botërore (BB) ofroi në Qershor 2014 një kredi prej 150 milionë US\$ që do të disbursohej gjatë një programi investimor prej pesë vitesh 2015-2019, e orientuar në të gjithë sistemin elektro-energjitik. Ky program modest financimi, kur kemi parasysh nevojën e një financimi prej më shumë se 1.5 miliard US\$, shoqërohej gjithashtu me një program shumë agresiv masash për reformimin e sistemit elektro-energjitik për nxjerrjen e tij nga kriza e thellë.

Bazuar në vlerësimet e bëra në kushtet e mësipërme qeveria vendosi të ndërmarrë një plan rimëkëmbje për sektorin për një periudhë prej 5 vitesh 2015-2019. Plani i propozuar për Rimëkëmbjen Financiare të Sektorit të Energjisë u përqendrua në tre shtylla kryesore:

- a) rritjen e efektivitetit operacional,
- b) forcimin e kapaciteteve institucionale dhe vendosjen e mekanizmave të kontrollit e drejtimit të kompanive, si edhe
- c) qëndrueshmëri financiare për përballimin e investimeve dhe përmirësimeve në infrastrukturë.

Në këtë situatë në të cilën gjendej sistemi elektro-energjitik, objekti i këtij studimi disertacioni, është:

- Analiza e gjendjes së sektorit dhe e performancës së sistemit publik të energjisë elektrike deri në Dhjetor 2014, duke e krahasuar atë me ndryshimet që imponon instalimi i modelit të ri të tregut të energjisë elektrike i miratuar me ligjin bazë të sektorit elektro-energjitike 43/15 të miratuar në Shkurt 2015, duke finalizuar me vërtetimin rezultateve dhe performancës elektro-energjitike dhe financiare të sistemit nën kushtet e modelit të ri të tregut.
- Analiza e thelluar e elementeve të tregut shqipëtar të energjisë dhe përgjigjet ndaj këtyre pyetjeve do të çojnë, sëbashku me analizën sasiore e cilësore të të dhënave të performancës së sistemit të marra nga përgjigjet e pyetësorëve, në vërtetimin e hipotezave bazë të këtij studimi dhe do të japin shumë përgjigje të vlefshme në

lidhje me reagimet e ndërsjella të faktorëve të ndryshëm që ndikojnë në performancën elektro-energjitike të sektorit.

Qëllimi i punimit

Qëllimi i këtij studimi është të ofrojë një pamje të plotë dhe të detajuar të situatës teknike dhe financiare të sektorit të energjisë elektrike, shkaqet kryesore të gjendjes aktuale dhe mësimet e nxjerra deri tani për një menaxhim më të mirë të këtij sektori, si dhe të analizojë rezultatet dhe qëndrueshmërinë e sistemit në fazën e parë të reformës, dhe të vlerësojë alternativat e mundëshme për një menaxhim më të mirë të këtij sektori përmes vazhdimit të reformave që do të garantojnë një funksionim të sektorit në kushtet e ekonomisë së tregut.

Reforma do të fokusohet në përmirësimin e dy treguesve kryesorë të sektorit:

- a) sigurinë e furnizimit me energji elektrike të ekonomisë dhe
- b) standartet e kërkuara të cilësisë, bazuar në standardet më të larta të furnizimit të saj (standartet e aplikuara në Komunitetin Europian të Energjisë dhe të kërkuara e monitoruara nga Sekretariati i këtij komuniteti për të gjithë vendet anëtare dhe palët kontraktore).

Vlerësimi në këtë studim i vendimeve të marra nga ana e Qeverisë në vite, synon gjithashtu identifikimin e problemeve të shfaqura gjatë reformës dhe të propozojë ndryshime të mundëshme të cilat do të mund të garantojnë sa thamë më lart, sigurinë e furnizimit dhe cilësinë e tij sipas standardeve të BE.

Objektivat kërkimore të punimit

Ky punim, mbështetur dhe në objektivin e përcaktuar më lart, synon të realizojë këto objektiva kërkimore:

- *Të identifikojë shkaqet e dështimit të sistemit nën modelet e mëparëshme të organizimit të tregut dhe hallkave të tij.*
- *Të identifikojë arsyet e nevojës për një liberalizim në tregut të energjisë elektrike.*
- *Të bëjë një analizë të tregjeve të energjisë në rajon dhe në BE.*
- *Të analizojë nëse reformimi i sistemit dhe modelimi ndryshe i tregut të energjisë elektrike një detyrim në axhendën e anëtarësimit në BE, apo një hap drejt një performance më të mirë në çdo dimension i sektorit elektro-energjitik.*
- *Të analizojë lidhjen e reformës në sistemin publik elektro-energjitik me pjesën tjetër të tregut të energjisë në përgjithësi.*
- *Të analizojë të ardhmen e vendosjes së modelit të ri të tregut si dhe rolin e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike në këtë reformë dhe sa do ndikojë në performancën e sektorit.*
- *Të krijojë një mekanizëm të monitorimit të implementimit dhe monitorimit të këtyre reformave për një menaxhim të qëndrueshëm të sektorit energjitik në Shqipëri*
- *Të ofrojë rekomandime për qeverinë Shqiptare lidhur me vijueshmërinë e reformave për një menaxhim më të mirë të tregut të energjisë në vënd.*

Realizimi i objektivave të këtij punimi është bërë nëpërmjet përdorimit të metodave kërkimore të kombinuara, analizimit të situatës aktuale në vënd dhe në rajon, kërkimit primar dhe sekondar, grumbullimit të të dhënave nëpërmjet operatorëve të ndryshëm si dhe intervistave të ndryshme që janë realizuar nëpërmjet grupeve të ndryshme sikurse janë përdoruesit familjarë, jo familjarë, buxhetore dhe jo buxhetore si dhe bizneset e ndryshme. Të gjitha këto do të trajtohen në kapitujt e mëtejshëm të këtij studimi.

Rëndësia e këtij punimi shkencor

Sistemi energjitik është jetik për ekonominë dhe sigurinë kombëtare të vëndit. Rrjedhimisht, mirëmenaxhimi i këtij sektori është një prioritet absolut për një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë si dhe rritjen e sigurisë së furnizimit të polullatës dhe të industrisë.

Ky punim zhvillohet pikërisht në një kohë kur në vënd ka filluar implementimi i reformave të rëndësishme në këtë sektor. Zhvillimi i sektorit është bërë në përputhje me strategjitë sektoriale të hartuara dhe të miratuara nga ana e Qeverive Shqiptare, por implementimi i tyre si dhe rezultatet nuk kanë dhënë rezultatet e duhura. Privatizimi i sektorit, dhënia me koncension e sistemit të shpërndarjes kompanisë Çeke CEZ, rezultoi një praktikë jo e suksesshme e për këtë qëllim, në vitin 2014, qeveria vendosi rikthimin e kësaj kompanie në 100% publike.

Në sistemin e gjenerimit të energjisë elektrike (KESH) situata financiare dhe strukturore e sektorit energjitik paraqitejsi më poshtë:

- KESH ishte një kompani prodhuese e cila përfshinte brenda saj FPSH që krijonte një barrë shtesë në financat e saj për shkak të kostove të paparashikueshme të importit, të prodhimit me shumë luhatje të energjisë nga IPP, të cilat nuk reflektoheshin saktë në çmimin e saj final të shitjes së energjisë të vendosur në mënyrë arbitrare.
- Niveli i borxhit vetëm në KESH ishte 74 miliard lekë. Nuk ishin të përfshira në këtë shifër detyrimet e krijuara brenda vitit 2014 ndaj IPP prej mbi 9.4 miliard lekë për energjinë e papaguar ndaj këtyre të fundit.
- Mospagesat, ose pagesat e vonuara nga konsumatorët kishin bërë që OSHEE të mos jetë në gjendje të paguajë tërësisht KESH dhe OST, duke sjellë vonesa të pagesave ndaj palëve të treta, si edhe duke gjeneruar borxh të ri ndaj tyre. Totali i faturave debitorë ndaj operatorit të shpërndarjes nga konsumatorët në përgjithësi ishte 130 miliard lekë, dhe vlera negative e aksioneve ishte më e madhe se (-)72 miliard lekë.
- Mospagesa e faturave të energjisë ndaj KESH nga OSHEE për energjinë elektrike të konsumuar nga rrjeti për konsumatorët dhe për mbulimin e humbjeve të shpërndarjes kishin maturuar një borxh i cili ishte afërsisht 53 miliard lekë.
- Për arsyet e sipërpërmendura KESH ishte detyruar të marhte hua në formë overdraft-i me kosto të lartë për një vlerë prej 36 miliard lekë, nga të cilat ishin të mbuluara me garanci sovraane vetëm 26.5 miliard lekë.
- Pamundësia e KESH për të vepruar si një njësi tregtare (shitje dhe blerje me vëndet fqinjë ose në tregun e parregulluar vëndës), që kishte kufizuar mundësinë e krijimit të fitimeve nga eksporti ose tregu i parregulluar (KESH mund të shesë vetëm kur

tregu i rregulluar nuk kërkon energji, apo në situata të prurjeve të jashtëzakonshme të kaskadës së Drinit).

- Kushtet e paparashikueshmërisë atmosferike për vitet e ardhshme e kufizonin KESH (furnizuesi i mundësisë së fundit, subjekt i detyrimit për shërbimin publik) nga të qenit në gjendje të parashikojë saktësisht nevojat për import dhe për këtë arsye ta reflektonte atë në tarifën e cila miratohet nga ERE.
- KESH si korporata kombëtare e prodhimit të energjisë elektrike, kishte nevojë për një reformim të thellë strukturor dhe aplikim të standardeve ndërkombëtare të qeverisjes së korporatave, duke garantuar nivele të ndara të vendim marrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së saj (zgjedhja e këshillit mbikqyrës/administrativ, zgjedhja e administratorit/bordit të drejtorëve, përcaktimi i varësisë së njësive së auditimit të brendshëm etj), si edhe të përgjegjësisë mbi ruajtjen dhe administrimin e aseteve etj.

Në këto kushte ky punim trajton elementët më të domosdoshëm të analizës së sektorit dhe identifikimin e alternativave për një zhvillim të qëndrueshëm të tij. Deri më tash një analizë e tillë është bërë pjesore dhe jo e interguar duke përfshirë të gjoithë elementët kryesore, ndaj dhe ky punim vjen si një vlerë e shtuar në ofrimin e një studimi të plotë dhe një trajtimi integral të analizimit të ecurisë së reformave si dhe të implementimit të Paketës 3 të energjisë.

Ky punim ka vlera teorike dhe praktike. Nga pikëpamja teorike, ky punim ofron një plotësim të mëtijshëm të të gjithë atyre studimeve dhe trajtimeve që i janë bërë sektorit deri më tani, duke vertetuar se qasjet e qeverive në këtë sektor, jo gjithnjë kanë rezultuar pozitive dhe kanë kërkuar ndërmarrjen e veprimeve korrektuese. Njëkohësisht, ndërmarrja e reformave, është analizuar duke u munduar të evidentojë aspektet pozitive të këtyre reformave si dhe duke identifikuar elementët të cilët nuk kanë qenë në performancën e duhur.

Në praktikë ky studim vëren se mbështetur në analizën konkrete të situatës së sektorit energjitik në vënd, është e nevojshme vazhdimi dhe thellimi i reformave si dhe implementimi i Paketës 3 të Energjisë. Kjo do të bënte që sektori energjitik në Shqipëri të krijonte qëndrueshmëri, të ofronte burime alternative të furnizimit duke interguar me mirë dhe prodhuesit e vegjël në sistem nëpërmjet liberalizimit të tregut energjitik, dhe natyrisht e kombinuar kjo me mirëmenaxhimin e sistemit, do të kishim një furnizim të qëndrueshëm, dhe një menaxhim më të mirë të të gjitha burimeve të sektorit.

Në këtë kontekst ky punim i sugjeron qeverisë Shqiptare të vazhdojë procesi i reformimit të sektorit si dhe masat e parashikuara në dy dokumentet më të rëndësishëm të tij, Plani i Konsolidimit Financiar të Sektorit Publik të Energjisë Elektrike dhe Plani Strategjik i Masave për Reformimin e Sektorit Energjitik.

Të përfundojë plotësisht procesi i ndarjes së OSHEE dhe i konsolidimit nga ana funksionale dhe financiare, por edhe juridike i tre ndërmarrjeve bija të saj; Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Furnizuesi Shtetëror Universal dhe Furnizuesi i Tregut të Lirë. OSHEE Group të garantojë plotësisht ndarjen edhe në realitet duke garantuar funksionimin e pavarur të tyre në një sistem menaxhimi korporate tre tier - bord drejtorësh, këshill administrimi, ortaku OSHEE Group, këshilli mbikqyrës i OSHEE Group, dhe asambleja e ortakëve e përfaqësuar nga Ministria përgjegjëse për energjinë.

Të garantohet furnizimi me energji elektrike i shpërndarjes dhe furnizimit në periudha të vështira të prodhimit të energjisë elektrike për shkak të thatësisë, duke krijuar një fond të përhershëm kontigjence për këtë qëllim. Ky është edhe kërkesë e ligjit për miratimin e kredisë së Bankës Botërore të vitit 2015.

Të diversifikohen burimet e furnizimit me energji elektrike në vend nga burime të tjera përveç ujit. Ministria duhet të vazhdojë nxitjen e përdorimit të këtyre burimeve me politika incentive dhe me lehtësim procedurash për licensimin e tyre.

Ky punim mendohet të jetë një kontribut dhe një ndihmë për sektorin energjistik në tërësi, operatorëve prodhues publikë dhe privatë, të shpërndarjes, konsumatorëve. Njëkohësisht ky punim i shërben dhe vendimmarrjes politike në hartimin e strategjive të zhvillimit të sektorit energjistik në vënd.

Përmbajtja e Tezës

Ky punim doktore paraqet një pasqyre të përgjithshme të sektorit energjistik në vënd si dhe një analizë të këtij sektori në vëndet fqinje dhe vëndet e bashkimit Evropian. Njëkohësisht bëhet një trajtim i plotë i reformave të zbatuara në sektor si dhe rezultatit të tyre e më tej trajtohet nevoja për vazhdimin e këtyre reformave me qëllim përmirësimin e menaxhimit dhe performancës së sektorit në tërësi. Punimi përfundon me gjetjet dhe rekomandimet duke theksuar nevojën për thellimin e reformave. Punimi synon të adresojë pyetje të tilla si:

- Cilët kanë qenë shkaqet e dështimit të sistemit nën modelet e mëparshme të organizimit të tregut dhe hallkave të tij?
- Pse duhet të derregullohet tregu i energjisë elektrike?
- Si janë të organizuar dhe si sillen tregjet e energjisë në rajon dhe në BE?
- A është reformimi i sistemit dhe modelimi ndryshe i tregut të energjisë elektrike një detyrim në axhendën e anëtarësimit në BE, apo një hap drejt një performace më të mirë në çdo dimension i sektorit elektro-energjitik?
- Sa lidhet kjo reformë në sistemin publik elektro-energjitik me pjesën tjetër të tregut të energjisë në përgjithësi?
- Cila është e ardhmja e vendosjes së modelit të ri të tregut roli i Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike në këtë reformë dhe sa do ndikojë në performancën e sektorit?
- Cfarë prodhoi reforma e deritanishme dhe ndryshimet e bëra në kuadrin e masave të marra?

Ky punim doktore është ndërtuar në pesë krerë të cilët në mënyrë të përmbledhur trajtojnë:

- Në kreun e parë ky punim trajton një ekranizim të situatës dhe identifikim të problemeve në sektorin elektro-energjitik, të faktorëve që ndikojnë në këtë situatë si edhe tregon objektivat e vendosura para këtij sektori për zgjidhje. Në këtë kapitull jepet një historik i kërkesës dhe gjendjes së saj strukturore. Në të jepet gjithashtu edhe një panoramë e qartë e gjendjes financiare të secilit segment të ofertës dhe të kërkesës për energji elektrike. Gjithashtu në këtë kapitull jepet edhe një panoramikë e përmbledhur e masave të marra dhe e reformës së zbatuar nga qeveria Shqiptare, si edhe e objektivave të vendosur në këtë program reforme të miratuara edhe me

ligj nga parlamenti. Në këtë kontekst përcaktohen edhe një sërë risqesh me të cilat mund të përballlet zbatimi i programit të reformës në mënyrë që të merreshin masat e duhura për zvogëlimin e tyre.

Kreu i parë trajton shkurtimisht edhe nevojën e inicijimit dhe përmbushjes së procesit të përafrimit të kuadrit ligjor dhe rregullator të sektorit me *acquis communautaire* të direktivës europiane të përcaktuara qartësisht në paketën e tretë të energjisë 2009/72/EC, e detyrueshme për zbatim deri në fund të vitit 2020 nga të gjithë vendet anëtare të EnC dhe të palëve kontraktore me të. Në këtë kapitull jepen në mënyrë konceptuale edhe disa procese si ai i ndarjes së OSHEE dhe krijimit si entitet i pavarur të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), si edhe i derregullimit¹ dhe liberalizimit² të tregut. Në këtë kuadër jepet edhe një saqim i rëndësishëm lidhur me detyrimin e shërbimit publik si edhe i rolit të rregullatorit, ERE. Një vend të rëndësishëm në këtë kapitull zë edhe reforma në sektorin e energjisë elektrike me të gjithë fazat e saj, 2014-207, 2018-2022, si edhe aktet ligjore që i sanksionojnë ato.

- Kreu II përqendrohet në rishikimin e literaturës për qëllim të këtij studimi si edhe të opsioneve të ndryshme të marra në konsideratë për projektimin e modelit të ri të tregut dhe të reformimit të sektorit elektro-energjitik në vend. Kryesisht janë trajtuar strategjitë sektoriale të zhvillimit të energjisë në vënd, sikurse është strategjia Kombëtare e energjisë e vitit 2013-2020. Kjo strategji trajton objektivat për periudhën 2013-2020 si dhe përcakton masat për përmirësimin e sektorit elektrik publik të energjisë, duke përfshirë masat organizative, teknike, masat e qeverisë, masat për zhvillimin e metejshëm të sektorit për vitet 2013-2020. Njëkohësisht edhe përmirësimi i kuadrit ligjor dhe ndërmarrja e reformave të këtij sektori është parashikuar në këtë strategji. Edhe strategjia e vitit 2018 i 2030 parashikon ndërmarrjen e masave ligjore si dhe të investimeve të caktuara në sektor për bërjen e këtij sektori më efficient në sigurimin e një furnizimi më të qëndrueshëm të energjisë si dhe në uljen e çmimit të furnizimit të energjisë. Në këtë kre, janë trajtuar dhe nismat kryesore ligjore që kanë ndikuar në përmirësimin e sektorit, si dhe artikuj e publikime të tjera në këtë sektor.
- Në kreun e III trajtohet Metodologjia e punimit dhe variablat e përzgjedhura. Ky kre, bën një përshkrim të modelit teorik dhe bën përcaktimin e hipotezave të vlerësimit. Kërkimi është i ndarë në dy etapa: në kërkimin parësor dhe atë sekondar. Në kërkimin parësor jepet jepet mënyra e grumbullimit të të dhënave si dhe trajtohen rezultatet e pyetësorëve dhe konkluzione e nxjerra nga to. Në kërkimin sekondar analizohen të dhënat e sektorit si dhe lidhja ndërmjet faktorëve/variablave të ndryshme. Hipotezat e ngritura në këtë studim janë:
- **Hipoteza e parë: (H-1)** Reformat e ndërmarra nuk ndikojnë në performancën e sektorit të energjisë elektrike.
- **Hipoteza e dytë: (H-2)** Performanca e sektorit të energjisë elektrike për ekonominë kombëtare rritet si pasojë e zbatimit të reformës legislative dhe rregullatore në

¹ Derregullimi i tregut - nxjerrja në treg të lirë, të parregulluar e konsumatorëve të cilët furnizohen me detyrim nga FSHU (Furnizuesi i Shërbimit Universal).

² Funksionimi i tregut të energjisë i lirë nga kufizimet, ku çdo gjë vendoset në bazë të mekanizmit të kërkesë-ofertë.

sektorin elektro-energjitik, rritjes së investimeve në infrastrukturë dhe në kualifikimin e stafit.

Këto hipoteza në vetvete janë të mbështetura dhe në një numër nën hipotezash të cilat trajtojnë efektin e sejcilit prej variablave të pavarur në performancën e energjisë në vënd. Pikërisht për këtë qëllim janë hartuar dhe pyetësorët të cilët kjanë për qëllim të trajtojnë element të tillë si:

- 1) cilësinë e furnizimit me energji elektrike,
- 2) sigurinë e furnizimit,
- 3) nivelin e shërbimit të ofruar për klientët nga operatori i sistemit të shpërndarjes, OSHEE,
- 4) niveli i shërbimit teknik të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe
- 5) gjykimi i përdoruesve fundorë mbi sistemin e ri tarifor.

Një strukturim i tillë i pyetjeve ka bërë të mundur identifikimin e variablave dhe shtrimin e regresioneve të shumëfishtë, testimin e tyre për multikolinearitet dhe autokorrelacion, si edhe analizën bashkëngjitime të tyre për performancë sipas grupeve të përdoruesve dhe përformancë totale të të gjithë sistemit.

- Kreu i IV trajton analizën e të dhënave, rezultatet dhe testimin e hipotezave. Në këtë kre është bërë regresioni i shumëfishtë duke analizuar variabla të tillë të pavarur sikurse është cilësia e furnizimit me energji, niveli i sigurisë në zonë, niveli i shërbimit të klientëve, shërbimet e shpërndarjes, ndikimi i sistemit të ri tarifor. Zhvillimi i këtyre regresioneve për çdo segment të madh konsumi (bazuar në qenien juridike të konsumatorëve/klientëve), duke iu referuar të dhënave nga pyetësorët, tregon se ka korelacion dhe signifikançë të fortë mes variablave të përzgjedhur si të pavarur për vlerësimin e performancës dhe atyre të përzgjedhur për vlerësimin e çdo variabli. Gjithashtu, vërmë një shpërndarje normale të këtij vlerësimi kur i referohemi shpërndarjes territoriale të të intervistuarve.

Të dhënat në studim rezultojnë të pranueshme përse i përket autokorelacionit dhe po kështu multikolinearitetit dhe vërtetojnë që modelet e regresioneve janë zgjedhur drejt dhe po kështu regresioni i cili tregon lidhje të fortë dhe të qëndrueshme të pesë variablave kryesorë me variablin e performancës së sektorit nën efektin e reformës së ndërmarrë me të dy fazat e saj 2015-2017 dhe 2018-2022.

Nga e gjithë analiza statistikore e trajtuar në këtë kre, bazuar në të dhënat e të tre grupeve të pyetësorëve të cilët mbledhin opinione lidhur me elementët kryesorë të reformës në sektorin e energjisë, vërtetohet plotësisht se **H-2** është një hipotezë e suksesëshme dhe po kështu edhe reforma e ndërmarrë në sektorin e energjisë elektrike.

- Kreu i V, paraqet gjetjet dhe rekomandimet e këtij punimi. Ky punim është i një rëndësie praktike pasi i shërben institucioneve, prodhuese, shpërndarëse dhe rregulluese të energjisë si një dokument i cili partashtron disa gjetje të rëndësishme dhe mbi bazën e tyre janë hartuar dhe rekomandimet përpermirësimin e menaxhimit dhe të performancës së sektorit energjitik në vënd.

KAPITULLI I PARË i Tregu energjitik, gjendja, historiku dhe proceset ligjore e rregullatore

Studimi merr ne shqyrtim dhe krahason gjendjen e sistemit elektro-energjitik shqipëtar nga viti i parë i zbatimit të reformimit të tij, 2004 e në vazhdim, duke analizuar proceset e ndodhura dhe reformimin e tij deri në ditët e sotme. Pjesë e këtij studimi nuk është periudha para fillimit të këtyre reformave të iniciuara me paketat e mëherëshme në sektorin e energjisë, dhe veçanërisht historiku dhe zhvillimet e sistemit elektro-energjitik në kohën e regjimit komunist dhe të ekonomisë socialiste. Një studim i tillë krahasimor dhe të jetë objekt analize dhe studimesh në të ardhmen. Ndryshimet midis këtyre dy periudhave të mëdha para dhe post 1991, nuk paraqesin interes bazuar në qëllimin e studimit edhe për arësyen se krahasimet dhe analizat i takojnë vetëm periudhës së instalimit të demokracisë dhe ekonomisë së tregut në Shqipëri, alternativave të zhvillimit në këtë situatë të re, ku rregullat e lojës dhe zhvillimi ekonomik ndodh në mënyrë shumë të ndryshme, ku në themel të tij qëndron ekonomia e konkurrencës, e decentralizuar, dhe jo ajo e planifikuar, autarkike e para 1991.

1.1 Historiku dhe proceset ligjore e rregullatore të ndërmarra në sistem

Sektori elektro-energjetik shqiptar funksionon si një sistem i ndërlidhur i aktiviteteve të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike. Kërkesa për energji plotësohet kryesisht nga kompanitë publike të aktiviteteve të prodhimit kryhen nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) dhe prodhuesit e vegjël apo të mesëm privatë të energjisë elektrike (Hidro-energji), si edhe prodhuesit e energjisë nga burime të tjera të rinovueshme, kryesisht energjia e diellit ose e erës; aktiviteteve të rrjetit të transmetimit dhe operimit të tregut kryhen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST), ndërsa aktiviteteve të shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë kryhen nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ose OSHEE. Pjesë e këtij tregu dhe e zonës së parregulluar të tij është edhe tregëtimi i brendëshëm me shumicë të energjisë të cili mbulohet nga tregëtarët e energjisë elektrike.

Sektori është i monitoruar dhe pjesa më e madhe e tij e rregulluar nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE).

Në Tetor të vitit 2014 Qeveria rimori përsëri 100 për qind të aksioneve të ish kompanisë ñCez Shpërndarje që i ishin dhënë përmes një procesi privatizimi kompanisë çeke ñCez a.sò.

Me qëllim fillimin e procesit të liberalizimit të tregut, në vitin 2011, të gjithë konsumatorëve jo-familjarë të furnizuar në linjën e tensionit të lartë 220 kV dhe 110kV, u detyruan të bëhen konsumatorë të kualifikuar dhe të zgjedhin furnizuesit e tyre në tregun e lirë të energjisë, gjë që bëri që Shqipëria të ketë aktualisht disa konsumatorë të kualifikuar të tensionit të lartë (TL) me konsum vjetor prej 700 GWh në vit (14 për qind e kërkesës së përgjithshme të energjisë elektrike), duke e çliruar KESH-in dhe operatorin e shpërndarjes nga detyrimi për t'ia furnizuar ata me tarifa të rregulluara. Nga ana tjetër kapacitetet e disponueshme të gjenerimit të KESH u zvogëluan më 81 MW për shkak të privatizimit të Hidrocentraleve të Ulzës, Shkopetit, Bistricës 1,2 dhe Lanabregas.

Në modelin e mëparëshëm të tregut, struktura e KESH ishte përgjegjëse për sigurimin e plotësimit të kërkesës për energji në Shqipëri për tregun me tarifa të rregulluara (duke përjashtuar energjinë e nevojshme për të mbuluar humbjet në rrjetin e shpërndarjes), si edhe për të siguruar energjinë e nevojshme për OST për rregullimin dhe balancimin e sistemit. KESH si kompani prodhuese e energjisë përfshinte brënda saj edhe strukturën autonome Furnizuesi Publik me Shumicë (FPSH). Roli i FPSH ka qenë të blejë së pari energjinë elektrike të prodhuar nga Prodhuesit e Hidrocentraleve të Vegjël të Energjisë (PVE) dhe Prodhuesve të Pavarur të Energjisë (PPE) nëpërmjet çmimeve të rregulluara (të aprovuar nga ERE) e të përcaktuara në Marrëveshjet për Blerjen e Energjisë, dhe të energjisë elektrike të prodhuar nga KESH me tarifën e rregulluar të miratuar nga ERE për aq sa është e nevojshme për të përmbushur kërkesat e tregut të rregulluar. Në rast se prodhimi i brendshëm nuk do të ishte i mjaftueshëm për mbulimin e kërkesës së tregut të rregulluar, FPSH ka patur detyrimin të blejë energji shtesë nga importi nga tregje të parregulluara, si edhe të blejë me çmime të favorizuara energjinë e prodhuar nga IPP. Fillimi reformës e kishte si masë prioritare, por tashmë edhe është e përmbushur, kalimin dhe përthithjen e FPSH brenda OSHEE nën Dizionin Tregëtar i cili mbulonte të gjithë funksionet e mëparëshme të FPSH, por dhe të tjera që lidheshin me sigurimin e të gjithë energjisë së nevojshme për tregun e rregulluar, duke çliruar KESH nga ky detyrim, pra edhe nga detyrimi i importit dhe blerjes së energjisë për këtë qëllim. Ky ndryshim thelbësor ndodhi në korrik të 2016 duke çliruar përfundimisht KESH nga detyrimi i blerjes së energjisë së gjeneruar nga IPP dhe nga importi. KESH mund të operonte në treg të lirë vetëm në rast optimizimesh tregëtare të rezervës energjitike të kaskadës së Drinit

Çështjet kryesore të identifikuara nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë (sot MIE - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) në segmentin e sektorit të prodhimit ishin si më poshtë:

Në sistemin e gjenerimit të energjisë elektrike (KESH) situata paraqitej si më poshtë:

- KESH është një kompani prodhuese dhe përfshirja e FPSH në strukturën e saj krijonte një barrë shtesë në planin e saj financiar për shkak të kostove të paparashikueshme të importit, të prodhimit me shumë luhatje të energjisë nga IPP, të cilat nuk reflektoheshin saktë në çmimin e saj të shitjes së energjisë, apo tarifave arbitrare të imponuara si rezultat i konflikteve të vazhdueshme me Cez Shpërndarje mes viteve 2011-2014, por edhe si rezultat i metodologjisë së zbatuar nga ERE për hartimin e tarifave të prodhimit të energjisë në nivel cost-recovery dhe jo sipas tregut. Përfshirja e detyrimit për të blerë prodhimin e PPE nuk reflektohej plotësisht në tarifën e shitjes, për shkak të prodhimit të paparashikuar (prodhimi i energjisë së HEC-ve varet nga prurjet e lumenjve) dhe/ose pezullimit të vendimeve për shkak të konfliktit ligjor me Cez Shpërndarje në vitet 2012-2014;
- Nevoja për amendim e marrëveshjeve të shërbimit midis enteve (KESH, OST, dhe OSHEE) dhe e procedurave të veçanta në aspektin e sigurimit të pagesave të faturuara, të cilat kishin krijuar hendeqe të mëdha financiare që nuk mbulohehin nga marrëveshjet financiare të KESH me qeverinë. Niveli i borxhit vetëm në KESH ishte 74 miliard lekë. Nuk ishin të përfshira në këtë shifër detyrimet e krijuara brenda vitit 2014 ndaj IPP prej mbi 9.4 miliard lekë për energjinë e papaguar ndaj këtyre të fundit.
- Mospagesat, ose pagesat e vonuara nga konsumatorët kishin bërë që OSHEE të mos jetë në gjendje të paguajë tërësisht KESH dhe OST, duke sjellë vonesa të pagesave

ndaj palëve të treta, si edhe duke gjeneruar borxh të ri ndaj tyre. Totali i faturave debitorë ndaj operatorit të shpërndarjes nga konsumatorët në përgjithësi ishte 130 miliard lekë, dhe vlera negative e aksioneve ishte më e madhe se (-)72 miliard lekë.

- Mospagesa e faturave të energjisë ndaj KESH nga OSHEE për energjinë elektrike të konsumuar nga rrjeti për mbulimin e humbjeve të shpërndarjes, borxh i cili ishte afërsisht 53 miliard lekë.
- Për arsyet e sipërpërmendura KESH ishte detyruar të marrte hua në formë overdraft-i me kosto të lartë për një vlerë prej 36 miliard lekë.
- Pamundësia e KESH për të vepruar si një njësi tregtare (shitje dhe blerje me vëndet fqinjë ose në tregun e parregulluar vëndës), që kishte kufizuar mundësinë e krijimit të fitimeve nga eksporti ose tregu i parregulluar (KESH mund të shesë vetëm kur tregu i rregulluar nuk kërkon energji, apo në situata të prurjeve të jashtëzakonshme të kaskadës së Drinit).
- Kushtet e paparashikueshmërisë atmosferike për vitet e ardhshme e kufizonin KESH (furnizuesi i mundësisë së fundit, subjekt i detyrimit për shërbimin publik) nga të qenit në gjendje të parashikojë saktësisht nevojat për import dhe për këtë arsye ta reflektonte atë në tarifën e cila miratohet nga ERE.
- KESH si korporata kombëtare e prodhimit të energjisë elektrike, kishte nevojë për një reformim të thellë strukturor dhe aplikim të standardeve ndërkombëtare të qeverisjes së korporatave, duke garantuar nivele të ndara të vendim marrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së saj (zgjedhja e këshillit mbikqyrës/administrativ, zgjedhja e administratorit/bordit të drejtorëve, përcaktimi i varësisë së njësisë së auditimit të brendshëm etj), si edhe të përgjegjësisë mbi ruajtjen dhe administrimin e aseteve etj.

Në kushtet e mësipërme sektori energjetik ishte zhytur në një krizë të thellë financiare për shkak të privatizimit të dështuar të kompanisë së shpërndarjes që zotërohej me 76% të aksioneve të saj nga ana e kompanisë Çeke ñCez a.s.ò. Në Tetor 2014 situata u ndryshua përmes rimarrjes së aksioneve nga ana e kompanisë shtetërore ñOSHEEò, e cila zotëron 100% të aksioneve, por me një situatë financiare pranë kolapsit total, ku siç përmenda më sipër, debitë për pagesat e energjisë elektrike nga konsumatorët fundorë ishin më shumë se 130 miliard lekë, borxhi ndaj të tretëve ishte mbi 75 miliard lekë (për energji të pashlyer ndaj KESH, detyrime ndaj palëve të treta për shërbime dhe kontrata të realizuara të pashlyera dhe për kredi afatgjata të pashlyera ndaj Ministrisë së financave), nga të cilat vetëm ndaj KESH 49 miliard lekë.

Varësia nga reshjet si dhe furnizimi vetëm përmes hidrocentraleve të KESH të vendosura në kaskadën e lumit Drin në veri të vëndit dhe nga energjia e gjeneruar nga prodhuesit e vegjël private (gjithnjë hidro-energji), shkaktonte paqëndrueshmëri në prodhimin e energjisë elektrike në vënd. Kjo përbënte një kërcënim në lidhje me parashikimin e importeve, duke sjellë kështu një rrezik për sigurinë e furnizimit.

Aktualisht i gjithë prodhimi në vënd varet nga hidrocentralet. Herë pas here nuk realizohet prodhimi i energjisë së parashikuar për shkak të luhatjeve të reshjeve, të cilat e pozicionojnë vëndin në një situatë jo të favorshme për sigurimin e një furnizimi të besueshëm dhe të përballeshëm të energjisë, meqenëse ai ndikohet së tepërmi nga kushtet klimaterike rajonale. Sfida e furnizimit me energji elektrike të Shqipërisë ndikohet më tej

nga kufizimet e kapacitetit transmetues të brendshëm dhe të jashtëm të lidhur me rajonin, si dhe nga sasia e pamjaftueshme e energjisë në dispozicion për furnizimin dhe tregtim nga vendet fqinjë. Kjo situatë, përballë ngjarjeve ekstreme klimaterike, ndikon negativisht jo vetëm në Shqipëri, por edhe tek fqinjët e saj, duke shkaktuar një efekt negativ. Situata elektro-energjitike e vitit 2017 e vërtetoi këtë fakt dhe risk për sistemin. Dëmi i shkaktuar në sistem nga pasiguritë e motit dhe situata ë vështire hidrike në vend ishte rreth 135 milion Euro.

Një vështirësi tjetër me të cilën sektori po përballej, ishte detyrimi financiar ndaj energjisë së blerë nga PPE-të. Ky detyrim ishte akumuluar nga shtimi i sasisë së prodhuar nga HEC private (IPP) me më shumë se sasia e planifikuar dhe me tarifa shumë favorizuese blerjeje, shumë më të larta se çmimet e tregut të energjisë të miratuara nga ERE dhe me të cilën KESH, bleu energjinë nga PPE-të, në vlerën e 9,3 lekë/KWh (66,4 Euro/MWh) për periudhën 2012-2014. Vetëm për vitin 2014, kostoja e blerjes së energjisë elektrike nga IPP, e pa mbuluar nga regjimi tarifar i FPSH/KESH, arriti në shumën rreth 2 miliardë lekë, në total 9.4 miliard lekë, e shkaktuar gjithashtu edhe nga mos ristrukturimi i tarifave nga ERE mes viteve 2012-2014³, për shkak të konfliktit të vazhdueshëm ligjor me CEZ Shpërndarje.

Një situatë e tillë e KESH kërcënonte shumë seriozisht sigurinë kombëtare dhe një kolaps potencial të sistemit elektro-energjitik në vend. Gjithashtu, kjo vendoste në risk mjaft të lartë zbatimin e projekteve për sigurinë e kaskadës të iniciuara nga KESH me ndihmën e partnerëve financiarë ndërkombëtarë. Pothuajse të gjithë detyrimet e KESH ndaj këtyre partnerëve përballoheshin nga buxheti i shtetit qysh prej vitit 2009, kur nga privatizimi i sistemit të shpërndarjes dhe ndarja e sistemit me tre nivele, transmetim, gjenerim dhe shpërndarje nuk adresoi detyrimet e kaluara të KESH ndaj partnerëve financiarë të marra për ndërhyrje në transmetim dhe shpërndarje.

Sektori i shpërndarjes përballej me një kombinim të sfidave që lidheshin me energjinë e pafaturuar për shkak të mungesës së matësve, ose matësve të dëmtuar dhe vjedhjeve në sistem, si dhe me arkëtimet e pamjaftueshme për energjinë e faturuar nga familjet dhe bizneset (52% arkëtime korrente në vitin 2013), të cilat çuan në lindjen e problemeve financiare të ish-kompanisë private të shpërndarjes CEZ Shpërndarje. Blerja e kompanisë nga shteti shqipëtar ishte e detyruar pas këtij falimentimi dhe kjo solli edhe kosto të tjera shtesë si pasojë e kredive të marra ndaj të tretëve nga CEZ gjatë funksionimit të saj, të vlerësuara në një total prej rreth 92 milion Euro, shifër për t'u paguar tanimë nga OSHEE në katër këste vjetore. Ky borxh do të përfshihej i gjithi në tarifën e re fundore të energjisë për konsumatorët sipas nivelit të tensionit.

Humbjet e energjisë ishin rritur në një mesatare vjetore 45% deri në fund të vitit 2013 dhe vetëm në muajin Dhjetor 2013 ato arritën 53%, ndërsa në vitin 2014 rezultuan me një përmirësim të rëndësishëm në më pak se 38%;

Investimet në shpërndarje ishin të papërfillëshme dhe rrjeti i shpërndarjes në një gjendje shumë të rëndë teknike. Gjatë viteve të administrimit të privatizuar të shpërndarjes totali i investimeve në rrjet ishte vetëm 8 milion Euro nga mbi 900 milion Euro që ishte nevoja për ndërhyrje prioritare në rrjetin e shpërndarjes.

Për shkak të fakteve të përmendura më lart, si dhe për faktin se sektori i energjisë është shumë i ndërruar, çdo ndryshim në sistem jep menjëherë një efekt zinxhir nga një shoqëri

³Në dhjetor 2014 ERE miratoi me vendim ristrukturimin e tarifave të vitit 2013 dhe 2014 për PPE në përputhje me metodologjinë që ishte në fuqi e përcaktuar nga VKM.

në tjetrën. Duke marrë parasysh se OSHEE ishte e pamundur në kushtet aktuale të momentit, 2014, që të gjeneronte të ardhura të mjaftueshme për të paguar kostot e saj, i gjithë sektori i energjisë ishte i ndikuar negativisht dhe në prag kolapsi.

KESH dhe OST ishin me aftësi paguese të dobët për shkak të situatës së mësipërme dhe si pasojë të vlerësuar me risk shumë të lartë financimi në tregun financiar. Kjo situatë ishte bërë e qëndrueshme dhe përbente një rrezik të veçantë për KESH, meqë ai nuk mund të realizonte pagesat e kësteve të kredisë, të blente energji elektrike nga PPE-të, dhe të importonte energjinë e nevojshme për të plotësuar kërkesat e brendshme të tregut të rregulluar. Rrjeti i shpërndarjes ishte në pjesën më të madhe të tij pa u investuar prej mesatarisht 36 vjet.

Edhe pse u ndërtua termocentrali i Vlorës, kjo pasuri nuk është ende funksionale për shkak të problemeve të pazgjidhura teknike. Aktualisht KESH duhet të përballojë edhe kostot e shlyerjes së kredisë për ndërtimin e tij, si edhe kostot e ruajtjes dhe mirëmbajtjes së tij. Kjo kosto është afërsisht 1.4 miliard lekë në vit.

Në këto kushte, për të garantuar sigurinë e furnizimit me energji elektrike dhe cilësinë e saj në furnizim kishte një nevojë urgjente për të realizuar investimet me objektiv zvogëlimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes, dhe për të zgjeruar dhe përmirësuar rrjetin e transmetimit të OST, për të realizuar një furnizim të sigurt me energji.

Duke pasur parasysh këto kushte, sektori nuk ka qenë në gjendje ta nxjerrë veten nga një *modus operandi* të menaxhimit të krizës, në një mënyrë të qëndrueshme operacionale. Prandaj Banka Botërore (BB) ofroi në Qershor 2014 një kredi prej 150 milionë US\$ që do të disbursohej gjatë një programi investimor prej pesë vitesh 2015-2019, e orientuar kryesisht në sistemin e shpërndarjes. Duke marrë parasysh nevojat e larta të sektorit të energjisë, vetë projekti i financuar nga BB nuk është i mjaftueshëm për të trajtuar dhe zgjidhur të gjithë boshllëkun financiar të trashëguar dhe atë aktual, i cili kërkonte masa të mëtejshme shtesë dhe një reformë të thellë për të kapërcyer problemet e sektorit të energjisë. Sipas vlerësimit të bërë nga BB në vitin 2013 vetëm për sektorin e shpërndarjes investimet prioritare të nevojshme janë më shumë se 900 milion Euro. Mbështetja e BB përmes këtij financimi do të shërbente si një nxitje për rimëkëmbjen e sektorit dhe mbështetje të reformës e cila do të bënte të mundur daljen e tij nga kriza dhe futjen në një gjendje të qëndrueshme operimi.

Tabela .1. Hendeku financiar i sistemit elektro-energjitik vendës⁴

Nevoja e pritshme per para	Sektori i energjisë i konsoliduar (All/ miliardë)	2018	2019	2020	2021	2022
Financim i ri i jashtëm nga burime tashmë të planifikuara	I Rrjedhja e parase neto nga aktivitetet e rregullta operative	12.1	17.9	18.3	21.8	22.3
	II Rrjedhja e parase neto nga aktivitetet e rregullta operative	-16.2	-26.4	-20.6	-13.5	-9.5
	III Ripagesa e borxhit	10.5	8.9	8.9	8.3	9.4
	IV Reduktimi i gjendjes së overdraftit(kredia EBRD)	15.3	13.3	0	0	0
	Nevojat e financimit bruto per sektorin e energjise	29.9	30.4	11.2	0	-3.4
	(I+II+III+IV=A+B+C)					
Financim i ri i jashtëm nga burime tashmë të planifikuara	A Huadhenia e parashikuar ndermjet buxhetit	18	14.8	1	0.6	0.3
	B Huadhenie te tjera te parashikuara	5.5	9.9	3.4	2.1	0
	C Hendeku vjetor financiar¹	6.4	5.8	6.8	-2.7	-3.7

¹Boshllëku vjetor i financimit = diferenca midis nevojave vjetore të parave të pritshme dhe burimeve të reja tashmë të planifikuara të financimit të jashtëm ⁵

Bazuar në vlerësimet e bëra në funksion të realizimit të Planit të Rimëkëmbjes Financiare të Sektorit të Energjisë Elektrike, të rishikimit të rezultateve të parashikuara në këtë të fundit u vendos që të rishikohet ky plan dhe të miratohet në Planin e konsolidimit financiar të sektorit publik elektro-energjitik në dhjetor të 2018, i cili u miratua nga qeveria Shqiptare në janar me një vendim të saj, duke vendosur objektiva më ambicioze. Akoma, sic shihet edhe nga tabela .1. nevoja për investime mbetet e lartë, rreth 72 miliard lekë (rreth 576 milion Euro) dhe nga mbulimi i planifikuar me kredi edhe mbështetje buxhetore rreth 19 miliard leke për periudhën 2018-2020. Për shkak të situatës së vështirë hidrike dhe të nevojës për të blerë energji në tregun e lirë për të plotësuar nevojën në vend këto investime u gjykuan me risk të lartë rikthimi, dhe nëpërmjet këtij plani u vendos një kufi i sipërm investimesh në nivel shpërndarje prej rreth 30 miliard lekë për periudhën 2019-2022. Këto targete janë ende për t'u arritur dhe pritshmëritë janë të larta për vitin 2021.

Bazuar në këtë situatë të sistemit elektro-energjitik, qeveria Shqiptare vendosi të ndërmarrë një reformë të gjërë të sektorit me objektiv të përgjithshëm rritjen në standardet europiane të performancës së sistemit elektro-energjitik për arritjen e qëndrueshmërisë ekonomike dhe financiare të sektorit, me një fluks të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të parasë (cash flow), reduktimin e humbjeve të energjisë në nivelet e synuara, përmirësimin e arkëtimit të energjisë së faturuar dhe zbatimin e pagesave të rregullta të faturuara midis shoqërive dhe ndaj palëve të treta.

Si objektiva specifike të reformës ishin:

1. Mbyllja e hendekut financiar të trashëduar të sektorit të enërgjisë, brënda 5 viteve në vazhdim, 2015-2019;
2. Transformimi i sistemit të energjisë nga një sistem që gjeneron borxhe në një sistem të vetë-qëndrueshëm dhe me aftësi likuiduese;

⁴ Planin e Konsolidimit Financiar të Sektorit Publik Elektro-Energjitik, Janar 2019, pp. 20

⁵ Planin e Konsolidimit Financiar të Sektorit Publik Elektro-Energjitik, Janar 2019

3. Sigurimi i furnizimit të vazhdueshëm të energjisë për të gjithë vendin pa ndërprerje të energjisë elektrike;
4. Përmirësimi i efikasitetit të sistemit të energjisë në sektorin e shpërndarjes duke zvogëluar humbjet dhe duke përmirësuar arkëtimet;
5. Rritja e cilësisë së furnizimit me energji elektrike në vend;
6. Lehtësimi i mëtejshëm i aksesit të përdoruesve fundorë në rrjetin e shpërndarjes;
7. Rritja e efikasitetit të energjisë dhe ulja e kostove të sistemit;
8. Liberalizimi i tregut të energjisë elektrike;
9. Rritja e kapaciteteve gjeneruese të energjisë elektrike dhe diversifikimi i burimeve për gjenerimin e saj;
10. Rritja e kapaciteteve transmetuese ndërkombëtare dhe të brendshme me efekt të drejtpërdrejtë në sigurinë e furnizimit të tregut vendës dhe në rritjen e potencialeve të brendshme të gjenerimit të energjisë elektrike.

Ndërkaq, Reforma e Sektorit të Energjisë Elektrike filloi me një skemë të re tarifore për shitjen dhe shpërndarjen e energjisë elektrike e cila u bazua në kostot e aksesit në rrjet për nivel tensioni, ndryshe nga sistemi i mëparshëm tarifor i cili merrte përbazë një skemë rëndësie sektoriale me qëllim mbështetje më të lartë për disa sektorë. Kjo skemë ekzistuese nuk kishte as bazë ekonomike as arësye teknike apo akses në rrjet dhe prodhonte masë të lartë informaliteti dhe korrupsion pasiv dhe aktiv, sidomos në shpërndarje.

Tarifat e reja të miratuara nga ERE që aplikohen tashmë nga ana e Operatorit të Shpërndarjes që nga 2015 bazohen në aksesin në rrjet dhe janë si më poshtë:

Tabela. 2. Tarifatat e shitjes së energjisë elektrike sipas reformës

Tarifatat e shërbimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për vitin 2015		
Niveli i Tensionit	Cmimi (lekë/kwh)	Cmimi Pik (lekë/kwh)
Konsumatorë në 35 kV	9.5	10.93
Konsumatorë në 20/10/6 kV	11	12.65
Furra buke dhe prodhim mielli në 20/10/6 kV	7.1	8.17
Konsumatorë në 0.4 kV	14	16.1
Furra buke dhe prodhim mielli në 0.4 kV	7.6	8.74
Familjare	9.5	
Tarifa për konsumin e energjisë elektrike në ambjentet e përbashketa (ndriçim shkollë, pompë, ashensor)	9.5	
Tarife fikse e shërbimit për leximin në zero (lekë/muaj)	340	

Kjo u shoqërua me disa masa dhe veprime të domosdoshme:

Subvencionimi drejtpërdrejt i klientëve në nevojë për diferencën e çmimit të ri në krahasim me çmimin e fashës deri 300 kwh. Sot vlerësohen të jenë maksimumi 214,000 konsumatorë në këtë kategori. Qeveria ka pranuar përgjegjësinë për të subvencionuar familjet në nevojë për çdo ndryshim në çmim për sasinë e 300 kwh. Ajo subvencionoi me një shumë 1.7 miliardë lekë në vitin 2015 grupin e përcaktuar vulnerabël dhe përfitues të subvencionit nëpërmjet pagesave të pensioneve të tipeve të ndryshme (Pensionistë të vetëm, asistencë sociale, njerëz me aftësi shëndetësore të kufizuar dhe shoqërues të tyre - paraplegjikë e tetraplegjikë, të verbër, shurdhë e memecë -, punonjës publike me pagë nën 35 mijë lekë/muaj që janë kryefamiljarë dhe nuk kanë të punësuar të tjerë në familje) dhe me tej do t'i përditësojë ato sipas ristrukturimit të tarifave të rregulluara dhe totalit të konsumatorëve pjesë e grupit të subvencionuar.

KESH/FPSH pagoi brenda vitit 2015 borxhet ndaj IPP, të vlerësuara në rreth 9.2 miliardë lekë deri në fund të vitit 2014 (përfshirë HEC-in e Ashtës), për të cilat FPSH i detyrohej IPP-ve, duke shfrytëzuar brënda tremujorit të parë, rritjen e pagesave që OSHEE-ja bëri ndaj KESH/FPSH-së për borxhet, pagesa të cilat filluan të rriten menjëherë që në fillim të 2015 për shkak të masave të reja të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare dhe OSHEE.

Reduktimi i humbjeve në sektorin e shpërndarjes, me një mesatare prej 5% ulje në çdo vit, nga niveli prej 37.6% që rezultoi në fund të 2014, në një nivel prej 14% deri në vitin 2019. Sigurimi i furnizimit me energji do të përmirësohet duke diversifikuar portofolin e prodhimit, përmes fillimit të hyrjes në punë të TEC-it të Vlorës në rastet e emergjencave, dhe stimulimin e hidrocentraleve Rajonale të Furnizimit me Energji.

Plani i propozuar për Rimëkëmbjen Financiare të Sektorit të Energjisë u përqendrua në tre shtylla kryesore: rritjen e efektivitetit operacional, forcimin e kapaciteteve institucionale

dhe vendosjen e mekanizmave të kontrollit e drejtimit të kompanive, si edhe qëndrueshmëri financiare për përballimin e investimeve dhe përmirësimeve në infrastrukturë.

Me propozim të operatorit të shpërndarjes ERE shfuqizoi strukturën e tarifave me dy fasha për konsumatorët familjare dhe vendosi një tarifë që pasqyron kostot për të gjithë kategoritë e konsumatorëve, duke filluar nga Janari i vitit 2015. Tarifa mesatare e ponderuar me pakicë u ristrukturua në një tarife unike prej 9.5Lekë/kwh, duke sjellë një përmirësim në favor të konsumatorëve prej 7.4%, krahasuar me tarifën mesatare me sistemin e mëparëshëm prej 10.22 lekë/kwh. Ndërkaq tarifa mesatare e energjisë elektrike për të gjithë konsumatorët fundorë u bë 10,7 lekë/kwh, për shkak të rritjes së tarifës për konsumatorët jo-familjarë në masën 15 %. Gjithashtu, Qeveria mbështeti fuqishëm aksionet në terren për zbatimin e programit për reduktimin e vjedhjes së energjisë elektrike dhe përmirësimin e nivelit të arkëtimeve. Rezultatet ishin inkurajuese, pasi u reduktuan humbjet e energjisë elektrike në total nga 45% në 2013 në 26 %në 2017, si dhe u rrit niveli i arkëtimeve korrente nga 52% në 2013 në 91% në 2017, si edhe u sistemua skedulimi i pagesës për faturat e prapambetura të energjisë elektrike me akt-marrëveshje sipas kategorisë së konsumatorëve duke garantuar një të ardhur vjetore prej rreth 3.5 miliard lekë. Qëllimi i kësaj mase shtrënguese ishte garantimi maksimal i pagesës së faturës korrente.

Përmirësim i efikasitetit, kapacitetit institucional dhe qëndrueshmërisë financiare kërkon angazhim për implementimin e masave të mëposhtme. Për të qenë efektive, të gjitha hapat e këtij plani veprimi duhet të trajtohen me të njëjtën rëndësi. Këto veprime përfshijnë:

- a. Ulja e humbjeve dhe rritja e nivelit të arkëtimeve me mbështetjen e Projektit të Rimëkëmbjes së Energjisë duke respektuar targeted e mëposhtme të cilat u miratuan me VKM dhe Ligj:

Tabela. 3. Projektionet e humbjeve të energjisë elektrike deri në 2020

	Humbjet Teknike (%)	Humbjet Jo- Teknike (%)	Niveli i Arkëtimeve (%)
2014	17	20.6	90
2015	21.04	10.76	91
2016	17	9	92
2017	15	6	93
2018	15	4	95
2019	13	2	95
2020	12	2	95

- b. Zbatimin në terma afat shkurtër dhe afatmesëm të Planit të Rimëkëmbjes Financiare, përfshirë ndër të tjera:

- Heqjen e sistemit me fashë dy tarifor dhe mbajtjen e një strukture tarifore me bazë kostoje për nivel tensioni, me një nivel mesatar të ponderuar prej 10.7 lekë/kwh, të indeksuar me kostot operacionale dhe kursin e këmbimit, subjekt i rishikimit periodik. Grupet e prekuara nga ky ndryshim janë identifikuar dhe subvencionohen nga buxheti i shtetit përmes Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë;
 - Futjen e kufizimeve të një buxheti rreptësisht të kontrollueshëm dhe masave për kontrollin e kostove për të përmirësuar efikasitetin, produktivitetin dhe sigurimin e likujditeve të nevojshme veçanërisht gjatë katër viteve të ardhshme;
 - Shlyerjen e borxheve ndaj PPE-ve, brenda vitit 2015;
 - Të gjitha institucionet buxhetore dhe jo-buxhetore pas kësaj do të jenë subjekte të mekanizmave të detyrimit brënda departamentit të thesarit për të siguruar pagesë në kohë për të gjitha faturat e energjisë së konsumuar;
 - Rifinancimin/riprogramimin/ristrukturimin e borxhit të kushtueshëm kur është e mundur (sidomos shumave të tërhequra si overdraft - OD) për të ulur shërbimin e borxhit të KESH-it dhe për të përmirësuar fluksin e parasë (cash flow). Për këtë qëllim u arrit të bëhet një marrëveshje me EBRD për rifinancimin e të gjithë OD deri në masën e mbuluar me garanci sovraane, 218 milion Euro.
 - Shpenzimet kapitale do të shqyrtohen me kujdes nga ana e këshillave mbikëqyrës, si dhe Ministria e linjës dhe do të kufizohen vetëm me zërat thelbësore që janë konsistente me sigurinë e sistemit, programin e dakortësuar të reduktimit të humbjeve dhe që sjellin të ardhurat me të mëdha në terma afat shkurtër;
 - Miratimi i Ligjit të Energjisë Elektrike të paraqitur në parlament dhe së bashku me të Modeli i ri i Tregut të Energjisë i cili mundëson fillimin e liberalizimit të mëtejshëm të tregut, lirimin e KESH nga roli i FPSH dhe për pasojë krijimin e mundësisë për të tregtuar lirshëm energjinë shtesë përtej mbulimit të klientëve tarifor, të gjitha këto për t'u arritur brenda vitit 2018.
 - Miratimi i amendimeve në ligjin për Energjitë e Rinovueshme dhe miratimi i Planit Kombëtar të Energjive të Rinovueshme i cili do të bëjë të mundur një planifikim të qartë të kapaciteteve të reja prodhuese, diversifikimin e burimeve si dhe kontrollin më të mirë të kostove të energjisë të mbuluara nga regjimi tarifor.
 - Përcaktimi i tarifave të arsyeshme dhe në përputhje me nivelet tarifore të aprovuara nga ERE për prodhuesit e pavarur të energjisë, duke eliminuar krijimin e borxheve të reja si rezultat i furnizimit me energji elektrike përtej niveleve të miratuara në tarifë.⁶
 - Miratimin nga ana e ERE-s të tarifave të aksesit në rrjet sipas nivelit të tensionit për të mundësuar daljen në treg të klienteve të lidhur në tension të mesëm 35/20/10/6 kV.
 - KESH parashikohet të jetë në gjëndje të eksportojë energji gjatë disa viteve të ardhshme. Rrjedhimisht, Qeveria propozoi që të mbajë të rezervuar shumën e 30 milionë US\$, pjesë e kredisë së Bankës Botërore të alokuar për importet e KESH, derisa të jetë hartuar programi i zbutjes së rrezikut të sigurisë të burimeve hidrike.
- c. Mbjtjen e tarifave të përshtatëshme që reflektojnë kostot për furnizimin, transmetimin, shpërndarjen dhe shitjen e energjisë. Duhet të theksohet se këto tarifa, sipas metodologjisë

⁶ Këshilli i Ministrave me VKM nr.125, datë 11.2.2015, miratoi metodologjinë e përcaktimit të tarifave fikse të energjisë, për vitin 2015, që do të paguhen prodhuesve të vegjël të energjisë elektrike nga hidrocentralet, ndërsa ERE me vendimin nr. 27, datë 16.02.2015, përcaktoi tarifën për vitin 2015 për prodhuesit e pavarur të energjisë në vlerën 7.636 l/kwh.

së ERE, përfshijnë vetëm humbjet teknike dhe nuk pasqyrojnë humbjet jo teknike që janë rezultat i vjedhjes së energjisë nga një numër i madh konsumatorësh në kurriz të konsumatorëve të tjerë;

d. TEC i Vlorës do të ri-komisionohet në pritje të cmimeve më të ulëta të naftës bruto dhe/ose të furnizimit nga gazi i projektit TAP, duke e çuar në një strukturë me kosto të ndryshueshme me te ulet dhe komercial në tregun e energjisë elektrike.

e. Përmirësimin e administrimit të kompanive, transparencës dhe pavarësisë së rregullatorit për të vepruar në interes të publikut dhe vetëm në interes të publikut; dhe

f. Reformimin e modelit të tregut dhe të kuadrit ligjor/rregullator për kalimin progresiv të konsumatorëve të Tensionit të Mesëm, e më tej të të gjithë konsumatorëve nga tregu i rregulluar ⁷ në tregun e hapur të energjisë si dhe transferimin e strukturës së FPSH.

Impakti i përgjithshëm financiar i këtyre veprimeve paraqitet në Fig.1⁸ më poshtë. Kjo tregon se kërkesat e huamarrjes do të ishin të menaxhueshme prej periudhës aktuale deri në 2017, të llogaritura në 5.5, 5.2 dhe 3.7 miliardë lekë para se sektori të gjeneronte të ardhura pozitive dhe të fillonte rrugën e gjatë për t'iu shëndrruar në një sektor të shëndosh financiar.

Figura 1 tregon madhësinë dhe kohëzgjatjen e financimit shtesë që do të duhet në rastin kur a) Projekti i Rimëkëmbjes së Energjisë do të zbatohet sikurse është planifikuar dhe b) shpenzimet kapitale do të mbahen të kontrolluara (që do të thotë 60% e atij të propozuar në planin e biznesit) dhe c) kushtet klimaterike qëndrojnë në ose mbi nivelin e kushteve mesatare afatgjata.


Në këtë skenar, pritet që sektori të transformohet tërësisht brenda katër viteve, deri në 2018. Megjithatë, duket qartë se overdrafti për sektorin në tërësi do të rritet nga niveli aktual 36.26 miliardë lekë në 47.3 miliardë lekë deri në fund të vitit 2017. Kjo kërkesë shtesë tejkalon gatishmërinë e bankave të brëndshme për të kredituar fonde shtesë dhe pa ndërhyrjet e propozuara më poshtë, sistemi duket qartësisht i paqëndrueshëm. (figura e mëposhteme).⁹

⁷ Megjithatë kostoja e përfitimit të saj duhet të shqyrtohet me kujdes për arsye të subvencionit të qenësishëm të konsumatorëve familjarë nga konsumatorët tregtarë pas heqjes së tarifës me fashë.

⁸ Plani i Rimëkëmbjes Financiare të Sektorit të Energjisë Elektrike, 2015

⁹ Plani i Rimëkëmbjes Financiare të Sektorit të Energjisë Elektrike, 2015

Figura 1. Parashikimi i nevojës për mbështetje financiare e sektorit 2015-2024



Ajo që në fakt ka rezultuar deri tani është se masat shrënguese dhe administrative në sektor dhe në aktorët e tregut të energjise sollën rezultate me të larta duke shkurtuar kohën e zvogelimit të nevojës për financim sipas grafikut me dy vjet. Pra sistemi rezultoi me rezultat pozitiv dhe i vetëfinancueshëm që në fund të 2015. Këtu duhet përmendur edhe situata tejet e vështirë hidrike dhe klimaterike e vitit 2017 që e përballi sistemin më vështirësi likuiditeti duke qenë se ndërmarrjet e mëdha të sistemit nuk i ndryshuan planet e tyre investuese. Në këto kushte pati një injektim capital dhe hyra nga buxheti i shtetit në një vlerë prej 5.5 miliard lekë të cilat shkuan për përballimin e detyrimeve ndaj palëve të treta, kryesisht banka.

Ne vazhdim, për zbatimin e kësaj reforme u identifikuan edhe disa risqe. Kështu, nga studimi i planit të masave dhe programeve për zhvillimin e reformës për periudhën 2015-2019, është identifikuar se nevojiten ndryshime në strukturën dhe legjislacionin e sektorit për të përmirësuar efikasitetin dhe për të shkuar drejt një tregu të parregulluar, të cilat përfshijnë:

1. *Çështjet Financiare.* Madhësia dhe synimi i financimit shtesë që duhet, varet nga kushtet hidrologjike mesatare, kurset e këmbimit dhe përqindjet e interesit global, të cilat janë në një masë të madhe jashtë kontrollit të të sistemit aktual dhe të qeverisë.
2. *Rezistenca e publikut për të ndryshuar.* Ristrukturimi i tarifave, ndëshkimi penal i abuzuesve dhe shkelësve të ligjit, dhe ushtrimi i kontrollit për detyrimin për të paguar nëpërmjet ndërprerjes së furnizimit mund të ndeshë në rezistencën e publikut ndaj iniciativave për përmirësim. Kjo do të merret në konsideratë me anë të fushatës së ndërgjegjësimit të publikut e cila është duke u përpunuar nga OSHEE dhe MIE dhe do të fillojë aplikim të menjëhershëm në vazhdim të masave strukturore lidhur me reformimin dhe modernizimin e sektorit në lidhje me kujdesin ndaj klientëve dhe marrëdhëniet kontraktuale me konsumatorët dhe klientët.

3. *Çështjet legislative.* Ligji i ri për Sektorin e Energjisë Elektrike është miratuar tashmë sa bashku me aktet nënligjore për zbatimin e tij. Janë miratuar gjithashtu edhe ligji për burimet e rinovueshme, ligji për eficiencën energjitike të ndërtesave si edhe ligje dhe VKM të tjera që prekin sektorin dhe lidhen me reformën.
4. *Sistemi Gjygjësor (Gjykata).* Sistemi gjyqësor duhet të jetë i gatshëm të zbatojë dënimet për abuzimet e energjisë elektrike bazuar në ndryshimet që iu bënë kodit të procedurës penale dhe civile për këtë qëllim.
5. *Subvencionimi Social për Klientët në Nevojë.* A do financohet për vitet në vazhdim nga Buxheti i Qeverisë shuma prej 1.7 miliardë lekë si kompesim i energjisë elektrike të familjeve në nevojë? Është e nevojshme që ky subvencion të jetë i përfshirë në planet buxhetore afat-mesme dhe afat-gjata të Qeverisë.
6. *Reduktimi i çmimit të Kontratës për PPE-të.* Mundësia për të zbatuar reduktimin e çmimeve të diskutuara më parë mund të rezultojë në raste të vecanta në mosmarreveshje ligjore dhe vonesa.
7. *Kapacitetet Menaxhuese të Kompanisë së Shpërndarjes.* A do të ketë vullnetin dhe do të jetë në gjendje menaxhimi aktual i OSHEE të zbatojë uljen e humbjeve dhe përmirësimin e nivelit të arkëtimeve, në mënyrë aq kërkuese sa e supozon parashikimi? Në vitin 2018 pritet që Kompania e kontraktuar për shërbimet e menaxhimit të sigurojë praktika të shëndosha të menaxhimit dhe deri diku të izolojë kompaninë nga presioni nga jashtë saj.
8. *Reduktimi i Numrit të Konsumatorëve pa Matësa.* Është kritike që matësit e rinj të blihen dhe instalohen të sigurtë në një kohë sa më shpejt të jetë e mundur për të reduktuar humbjet jo-teknike.
9. *Rritja e Çmimeve për Njësitë Tregtare dhe Industriale.* Plani supozon që konsumatorët e rrjetit 35kV dhe 10kV të lënë tarifat e rregulluara dhe të paguajnë çmimet bazuar në çmimet e importit. Kjo do të rezultojë në një rritje potenciale të çmimeve të energjisë për disa konsumatorë, për shkak se mund të mos jenë të përgatitur për një situatë të tillë, duke i ekspozuar ata ndaj rreziqeve që do të paraqesin çmimet rajonale të energjisë në të ardhmen. A do të ushtrojnë ata presion politik për të mbetur si konsumatorët normal?
10. *Çmimet Rajonale të Energjisë.* Duke pasur parasysh faktin se Shqipëria duhet të importojë energji për të plotësuar nevojat hidrike, vendi është i ekspozuar ndaj rreziqeve të trashëguara të tregjeve rajonale të energjisë.
11. *Situata me TEC e Vlorës.* Parashikimi supozon që TEC-i Vlorës do të rehabilitohet dhe do të vihet në shërbim. Kjo do të varet nga çmimet e tregut botëror të karburantit, të cila janë deri diku përtej kontrollit të KESH-it.
12. *Borxhi i Konsumatorëve Buxhetorë.* Supozohet se borxhet e mëparshme të konsumatorëve buxhetore do të kompensohen me taksat dhe detyrimet e tjera të Qeverisë.
13. *Çështjet që lidhen me Taksat.* Administrata Fiskale është një faktor i rëndësishëm lidhur me mbledhjen e borxheve dhe faturave aktuale nga konsumatorët privatë, meqënëse ata mund të kontrollojnë, nëse të gjitha faturat e energjisë elektrike të përfshira në bilancin vjetor financiar të tyre janë likuiduar, duke shmangur mospagesën e detyrimit të energjisë, si një e mirë publike, dhe ndërkohë të zvogëlojnë fitimin dhe kështu me radhë të paguajnë më pak tatim mbi fitimin për aktivitetet e tyre.

Amendimi i Planit të Rimëkëmbjes Financiare të Sektorit të Energjisë Elektrike, si pasojë e progresit të vërejtur në rritjen e performancës së sistemit deri në vitin 2017, dhe miratimi i Planit të Konsolidimit Financiar të sektorit publik elektro-energjitik në janar të 2019, solli edhe ndryshime në targetet e performancës së sistemit. Kështu, ndryshoi plani i uljes së humbjeve duke u bërë më agresiv dhe po kështu ai i arkëtimeve korrente.

Tabela. 4. Parashikimet për humbjet dhe arkëtimet 2014-2022¹⁰

	Humbjet totale (%)	Mbledhja e te ardhurave¹ (%)
2014	37.8	91.9
2015	31.3	98.3
2016	28.0	92.0
2017	26.4	97.0
2018	25.0	95.0
2019	23.0	95.0
2020	20.0	95.0
2021	16.5	95.0
2022	15.0	95.0


¹Përfaqëson arketimet totale duke përfshirë shitjet nga vitet paraprake

Tanimë, humbjet nuk janë të ndara në humbje teknike dhe jo teknike, si edhe të ardhurat përfshijnë ato korrente dhe ato të prapambetura nga vitet e kaluara. Ato janë korrektuar në raport me parashikimet e Planit të Rimëkëmbjes Financiare të Sektorit të Energjisë Elektrike 2015-2019, të renditura këtu më sipër në tabelën nr. 3. Ato kanë reflektuar situatën e re të sektorit dhe përfaqësojnë nivelin e tyre të lidhur edhe me treguesit e investimeve në sektorin publik të energjisë elektrike. Numri i familjeve që kishin më shumë se tre Fatura pa paguar në fillimin e reformës në vitin 2014 ishte mbi 770 mijë, ndërsa në 2017, që është edhe viti bazë nga ku nis marrja e masave të reja për konsolidimin financiar të sektorit ishte rreth 55 mijë, duke marrë në konsideratë që të gjithë debitorët e OSHEE kishin nënshkruar një marrëveshje për pagimin me këste të këtij detyrimi ose e kishin shlyer atë *upfront* duke përfituar nga një reduktim prej 80% i kamatë vonesave të maturuara. Çdo konsumator që dështonte në zbatimin e aktmarrëveshjes, nuk mund të rikthehej më në të me kushtet e mëparëshme, por në kushte më agresive.

Rëndësi në këtë fazë iu dha riorganizimit të sektorit në të gjithë nivelet, gjenerim, transmetim dhe veçanërisht në shpërndarje, ku riorganizimi financiar në standard ndërkombëtare të korporatave, do ta bënte sektorin të financueshëm dhe me risk të ulur. Në këtë mënyrë do të mund të çlirohej buxheti i shtetit nga borxhi i ri për sektorin, duke krijuar hapësira mbështetje për sektorë të tjerë në vështirësi. Objektivi i planit të ri është ta kthejë sektorin elektro-energjitik në një sektor që vetëmbahet dhe ul kostot e operimit të tij pa mbështetjen e buxhetit publik.

¹⁰ Plan i Konsolidimit Financiar të Sektorit Publik Elektro-Energjitik, Janar 2019

Figura. 2. Kërkesa për financim në sektorin e shpërndarjes¹¹



Siç duket dhe nga tabela, rezulton një hendek financiar për shpërndarjen i cili duhet të mbushet. Ky mund të mbushet duke rritur eficiencën në operacionet e vetë shpërndarjes, pra, ulje më të ndjeshme të humbjeve, rritje të arkëtimeve, si edhe ulje të vazhdueshme të kostove të operimit nëpërmjet një organizimi më të mirë dhe nëpërmjet modernizimit. Mund të ulet ky hendek gjithashtu edhe përmes financimit me burime të huajtura, ose përmes reflektimit të tij në tarifën fundore. Duke qenë se objektivi kryesor strategjik i shpërndarjes është të ruajë të paktën nivelet aktuale të tarifës fundore, gjithashtu duke patur parasysh se mbi 87% e tregut fundor të konsumit të energjisë elektrike në 2017 ishte e rregulluar, ky opsion mbetet jashtë objektivave të shpërndarjes për t'u mbështetur në nevojën e saj për financimin e hendekut financiar, përveçse duke marrë në konsideratë një zbatim rigoroz të VKM 519, dt. 13.07.2016 për modelin e tregut të energjisë elektrike dhe duke vazhduar me procesin e derregullimit dhe liberalizimit të tregut fundor të energjisë elektrike. Rregullimi dhe aplikimi i standardeve ndërkombëtare të qeverisjes së korporatave në të tre ndërmarrjet e sistemit, do të ishte një mundësi e re për to, për të gjetur financimet e nevojshme në nivel bankash tregëtare, pa patur nevojë për mbështetje me garanci qeveritare.

1.2 Historiku i kërkesës

Kërkesa për energji elektrike në Shqipëri bazuar në natyrën e konsumit përbëhet nga këto segmente:

- i. Segmenti i konsumatorëve familiar, i cili përbëhet nga disa nën grupe konsumatorësh. Në këtë grup mund të dallojmë nënsegmente sipas sasisë së konsumit, sipas numrit të matësve (shtëpi e dytë ose e tretë), sipas frekuencës së konsumit (ata me banim të përkohëshëm në më shumë se një vend) dhe sipas të ardhurave, ku nënsegmenti më i rëndësishëm është ai i konsumatorëve në nevojë. I gjithë segmenti i konsumatorëve familiar është i lidhur në rrjetin e shpërndarjes në tension të ulët, 0.4 KV. Deri në fund të vitit 2013 ky ishte edhe segmenti më i madh

¹¹ Plani i Konsolidimit Financiar të Sektorit Elektro-energjistik, Janar 2019, pp. 24

i konsumit me rreth 58% të tij i shprehur në Kwh. Ndërkaq, edhe bazuar në numrin e konsumatorëve rreth 82% e totalit të abonentëve i përkasin këtij segmenti. Gjithashtu, deri pa filluar sistemi i ri i tarifimit, bazuar në nivelin e konsumit mbi ose nën 300 kwh në muaj për çdo konsumator, totali i energjisë së konsumuar brenda këtij grupi nga konsumatorët në kufirin nën 300 kwh/muaj zinin mbi 76.6% të totalit të këtij segmenti, ndërsa si numër konsumatorësh nga 0-300 kwh/muaj zinin rreth 80%. Është e rëndësishme të theksojmë se segmenti i konsumatorëve nën 100 kwh/muaj, përfshin kryesisht shtëpitë e dyta dhe ata që janë në emigracion. Vetëm konsumatorë me faturim zero kwh janë rreth 100 mijë. Konsumi i tyre nuk është i rregullt dhe nuk ka shumë rëndësi studimi. Nëse do të bënim një abstragim të tillë, pra të shkëpusim nga analiza pjesën e konsumit nga 0-100 kwh/muaj, atëherë situata do të ndërronte në mënyrë të rëndësishme në favor të konsumit mbi 300 kwh/muaj. Efekti i përlllogaritur në lidhje me ndryshimin e tarifës së konsumatorëve familiar pa fashë do të bënte break-even si harxhim total për çdo konsumator në rreth 370 kwh/muaj, duke patur tarifën e re të vendosur prej 9.5 Lek/kwh. Totali i energjisë së konsumuar nga ky segment konsumatorësh, familiarët, është rreth 2.5 Twh/vit (energji e faturuar).

Tabela. 5. Segmentet e konsumatorëve sipas konsumit¹²

Fashat (kwh/muaj)	Konsumi mujor	Konsumi mesatar per abonent kwh/muaj	Nr mesatar i abonentëve	Segmentet e konsumit në % sipas harxhimit
1 - 100	9,262,774	54	171,710	4.9
101 - 200	32,589,368	150	217,393	17
201 - 300	44,263,691	255	173,623	23.3
>301	104,500,913	523	199,952	54.8 ¹³
Total	190,616,746	192	990,408	

¹² Të dhënat i referohen konsumit të konsumatorëve familiar për periudhën shkurt 2013-Maj 2014, burimi OSHEE Group.

¹³ Ky segment ka konsumtë përzierë midis nën 300 kwh/ muaj dhe mbi këtë fashë. Rreth 54 milion kwh janë të konsumuara nën 300 kwh/muaj dhe faturohen me 7.7 lek/kwh, dhe diferenca me 13.5 lek/kwh.

Tabela. 6. Familje në nevojë që përfitojnë mbështetje me subvencion direkt në skemë pensioni për efektet e reformës tarifore të energjisë elektrike

FINACIM 300 kwh/MUAJ DHE SUVENZIONE TE MEPARESHME

Emertimi	Numri	Perfitimi/muaj	Subv.Ekzistues	Subv.Ri
Familje ne ndihme ekonomike	88,094.00	640	676.56	570.85
Kryefamiliar ne pension ose invaliditet	80,000.00	640	614.40	518.40
Familje me persona me aftesi te kufizuara	7,000.00	640	53.76	45.36
Te verber (VKM nr. 404, dt. 20.06.2012	9,016.00	1400	151.47	58.42
Para e tetraplegjike VKM 404, 20.06.2012	10,818.00	2000	259.63	70.10
Totali Ri				1,263.13
Totali	194,928.00		1,755.82	3,018.96

- ii. Segmenti i konsumatorëve jo familiar i përbërë nga dy nënsegmente të mëdha, nga buxhetorë dhe jobuxhetorë (konsumatorë me pronësi shtetërore) dhe privatë (konsumatorë me pronësi jo shtetërore). Të parët ndahen në konsumatorë publikë (institucione publike) dhe jobuxhetorë (ndërmarrje shtetërore dhe organizata jo në varësi të qeverisë pavarësisht nivelit të qeverisjes - spitale, burgje dhe institucione të riedukimit, ndërmarrje dhe shoqëri tregëtare, agjenci dhe institute, universitete, trupi diplomatik në Shqipëri etj). Segmenti i konsumatorëve privatë përfshin të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtaria ekonomike në vend. Ky segment, konsumatorët jo-familiarë zinte rreth 42% të konsumit. Kjo tregon për një konsum eksziv të energjisë elektrike nga segmenti familiar, duke konfirmuar edhe abuzimin dhe vjedhjen e energjisë elektrike në vend, kur mesatarja e rajonit dhe më gjërë në vendet europiane leviz nga 31-37% sipas gjërësisë gjeografike në të cilën ndodhen. Në vendet me gjërësi gjeografike më të madhe, pra më në veri, konsumi është më i ulët, pasi përdoret më pak energji elektrike për kondicionim dhe ngrohje. E kundërta ndodh në vendet më pranë ekuatorit. Kjo tregon gjithashtu për një nivel të ulët automatizimi dhe mekanizimi të industrisë dhe ekonomisë Shqiptare. Energjia përdoret gjërësisht për shërbime jo teknologjike. Pas viti 2017 shohim një ndryshim të rëndësishëm të këtij raporti i cili ka lëvizur ndjeshëm në favor të konsumit të jo-familiarëve. Bën përjashtim viti 2020 i pandemisë i cili ka sjellë përsëri një rritje të konsumit nga ana e familiarëve dhe raporti ka qenë 545 me 46% në favor të familiarëve. Ndryshimi i kësaj structure konsumi ka sjellë të ardhura shtesë në OSHEE Group si pasojë e çmimit më të lartë se ai mesatar që kanë konsumatorët jo-familiarë (12.5/10.7 lek/kwh). Nganjë analizë diskriminuese e elementeve që ndikojnë pozitivisht në fitimin e paplanifikuar të kompanisë është edhe efekti i ndryshimit të strukturës së konsumit i cili, nëse vazhdon të ndjekë këtë trend, mund të sjellë një fitim vjetor të shtuar prej rreth 2.2 miliard lekë në vit. Kërkesa për energji në Shqipëri, duke reflektuar edhe ndryshimet e saj si pasojë e zbatimit të reformës, në 2017 ishte rreth 6.4 Twh për tregun e rregulluar dhe rreth

0.8 Twh për tregun e parregulluar. Ka një ulje të rëndësishme të saj krahasuar më vitin 2014, ku konsumi i rregulluar ishte 7.4 Twh¹⁴. Ulja është rreth 11% dhe ka ndikuar direkt edhe në uljen e humbjeve, pasi pjesa më e madhe e saj i përket abuzimeve me energjinë elektrike. Ky tregues, pra ai i kërkesës totale për energji elektrike është akoma për tû saktësuar nëse do të fillojnë të zbatohen rigorozisht edhe kërkesat e ligjit për eficiencën e ndërtesave në konsumin e energjisë elektrike. Pritet që kursimi për shkak të rritjes së eficiencës të jete 15% deri në vitin 2030, bazuar në një inventar ndërtesash publike prej rreth 7500 ndërtesash në të gjithë vendin, të cilat duhet të restaurohen e të sillen në standardet e përcaktuara nga ligji për performancën e tyre energjitike. Ndërkaq, projektimi i kërkesës për energji elektrike deri në 2030 është rreth 10 TWh/vit.

1.3 Gjendja e sistemit dhe përcaktimi i problemit

Aktualisht sistemi elektro-energjitik shqipëtar është nën një proces të thellë reformimi, i cili ka filluar që në Shtator 2014. Pas një studimi të thellë që iu bë gjendjes deri në atë moment, e cila paraqitej dramatike si lidhur me sigurinë e furnizimit ashtu edhe me cilësinë e furnizimit, por edhe lidhur me performancën ekonomike të tij, e cila ishte në kolaps total, me humbjet mbi 45% dhe arkëtimet korrente rreth 54% në familiar e 78% në jofamiliar në shpërndarje, investimet në nivel pothuajse zero gjithashtu, me një situatë mjaft të vështirë ekonomike në gjenerim, dhe me një sistem transmetimi i cili nuk shlyente dot detyrimet e tij e nuk garantonte mirëmbajtjen e rrjetit, u hartua një plan për rimëkëmbjen e sistemit, ku u përcaktuan masa imediate dhe afatgjata për ndërhyrje si me rregullim ashtu edhe me financim e me reformim ekonomik, me targete të qarta për çdo pozicion të sistemit i cili u miratua në fillim të 2015 me vendim qeverie dhe u bë i detyrueshëm për zbatim nga të gjithë operatorët e sistemit.

Kjo reformë u planifikua si fillim me një etapë të përbërë nga dy programe paralele, reforma ligjore dhe rregullatore, si edhe ajo investuese dhe e ringritjes së sistemit elektro-energjitik shqipëtar. Ajo u hartua në formën e një plani strategjik që shoqërohej me një plan masash për tû realizuar, zbatimi i të cilave do të konkludonte me përmbytjen dhe realizimin e reformës. Ky plan u titullua në Planin i Rimëkëmbjes Financiare të Sektorit të Energjisë (PRFSE) dhe përfshinte një periudhë zbatimi prej 5 vitesh 2014-2019. Pjesë e implementimit të tij, si edhe pjesë e zhvillimit të këtij sektori, si edhe e përafrimit të tij me modelet e sanksionuara në Politikën udhëheqëse të Komunitetit Europian të Energjisë (EnC) ishte edhe ngritja dhe reformimi i kuadrit ligjor dhe rregullator të sektorit të energjisë në përputhje me paketën e tretë të energjisë të këtij Komuniteti.

Reforma tashmë është në zbatim e sipër dhe janë arritur një pjesa më e madhe e objektivave të saj që lidhen me aspektin ligjor dhe rregullator, si edhe me implementimin e vazhdueshëm të ndryshimeve që ka pësuar në kohë paketa e tretë e energjisë e EnC. Po kështu, performanca ekonomike është në nivele mjaft të kënaqëshme krahasuar me gjendjen në të cilën ajo filloi. Vlerësimi i progresit të reformës bëhet vit pas viti.

Në kuadër të zbatimit të masave të reformës, OSHEE arriti në nivelin 26% të humjeve për 2017 dhe me arkëtimet korrente mbi 92%. Të ardhurat nga shitja e energjisë dhe e shërbimeve ndaj tregut arritën një shifër rekord prej rreth 65 miliard lekë. Por po kështu, viti 2017 tregoi se sistemi elektro-energjitik është akoma mjaft vulnerabël. Kjo lidhet si me

¹⁴ Nuk janë përfshirë këtu konsumi i vetë OSHEE dhe ai i OST që zënë rreth 0.3 Twh/vit

performancën e tij akoma me probleme, me procese të papërfunduara akoma si unbundling i sistemit të shpërndarjes nga shitja me pakicë, rritjen e kapaciteteve të transmetimit si ndërkufitare ashtu edhe të brendëshme, kushtet e motit dhe mungesën e investimeve në burime alternative energjie, investimet e pamjaftueshme në të tre nivelet e sistemit, gjenerim, transmetim dhe sidomos shpërndarje, prania akoma e një tregu thellësisht dhe gjërësisht me tarifë të rregulluar, 93% e tij, pra nevoja për një derregullim total të tregut i cili do të ndodhte gradualisht, dhe instalimi i një modeli të ri tregu bazuar në ligjin bazë të sektorit (43/15), krejtësisht i derregulluar përsa i përket tarifave në çdo nivel të sistemit, por dhe i detyrimeve të ndërsjella mes operatorëve të ndryshëm, pa cënuar sigurinë e furnizimit me energji të ekonomisë dhe konsumatorëve familiarë. Studimet e bëra nga operatorët në mënyrë të pavarur, nga ERE por dhe nga MIE dhe institucionet e saj të varësisë, identifikonin se kishte ardhur nevoja për amendim të Planit të Rimëkëmbjes së sektorit, si përsa i përket targeteve, ashtu edhe planit të masave që i mbështesin këto targete. Duhet të investohet smart dhe me një koncept të qartë rikthimi të investimeve në të tre nivelet në mënyrë që të arriheshin targeted e reja të projektuara dhe sistemi të ishte bankable ose i vetëfinancueshëm (pa mbështetjen e çdo forme të buxhetit të shtetit). Derregullimi lidhet gjithashtu edhe me një tjetër arsye themelore, thithjen e sa më shumë investimeve në çdo nivel të sistemit, sidomos atyre private. Kjo mund të ndodhte vetëm nëpërmjet rifillimit tashmë në kushte krejt të shëndosha tregu të një procesi privatizimi të hallkave të ndryshme të tij. Gjenerimi i energjisë elektrike tashmë është pjesërisht i derregulluar¹⁵ dhe ka një prani të theksuar prej rreth 2 miliard Euro kapitale private me një tendencë gjithnjë në rritje sidomos në hidro-energji, por edhe në energjitë alternative, veçanërisht në energjinë diellore.

Niveli i transmetimit ka bërë si ndryshimet e duhura ligjore, ashtu edhe teknike për të garantuar akses të barabartë në rrjet të të gjithë operatorëve pa diferencim, përjashtuar gjeneruesit me kapacitet më të vogël se 2 MW. Shpërndarja ishte akoma pika e nxehtë e sistemit në 2017 dhe duhej të bënte akoma shumë hapa rregullues e menaxherialë për të rritur performancën e saj dhe për të qenë pjesë aktive e tregut në kushtet e modelit të ri të tij i detyrueshëm për zbatim.

Liberalizimi dhe nxjerrja nga sistemi me tarifë të rregulluar i të gjithë konsumatorëve në tension të mesëm, si edhe marrja e masave për investimet e duhura në sistemin e matjes së energjisë për të gjithë konsumatorët (instalimi i sistemit Skada në shpërndarje dhe i matjes inteligjente të konsumit në përdorues fundorë) ishin dhe janë akoma hapa të rëndësishëm për t'u ndërmarrë e për t'u mbështetur me investime për të garantuar një treg sa më të liberalizuar dhe një shëndet sa më të mirë e afat-gjatë të sistemit si i tërë.

Në këto kushte, duke parë edhe efektet shumë inkurajuese të reformës qysh në hapat e parë, rezultoi që në fund të vitit 2018, PRFSE të duhej si ngadalësues ndaj reformës, pasi targetet e vendosura në të në vitin 2014 ishin lehtësisht të arritëshme. Për këtë arsye, në bashkëpunim me BB¹⁶ u hartua n'Plani i Konsolidimit Financiar të Sistemit të Energjisë Elektrike, i cili përfshinte gjithashtu një plan përsëri ambicioz masash, si lidhur me implementimin e Paketës së Tretë të Energjisë dhe ndryshimeve që ajo kishte pësuar, ashtu edhe të targeteve të performancës ekonomike dhe financiare të sistemit, ku si bazë nisje tashmë ishin të dhënat e performancës së vitit 2017.

¹⁵ Ky është termi që përdoret në tregun e energjisë elektrike për hapjen dhe liberalizimin e tregut

¹⁶ Banka Botërore

Sistemi tashmë reagon pozitivisht ndaj kërkesës për energji dhe ka hyrë plotësisht në kushte operimi normale. Ndërkaq, vazhdon thellimi i reformës për ta bërë atë të funksionojë në kushte të tregut të lirë në çdo nivel tensioni dhe për çdo kategori konsumatorësh. Kjo do të realizojë ose bëjë të mundur përmbushjen e reformës dhe objektivave të saj lidhur me sigurinë e plotë të furnizimit me energji elektrike të kërkesës vendëse dhe të tregut rajonal nëpërmjet bashkëpunimit tashmë të nisur duke qenë anëtarë me të drejta të plota në ENTSO-E dhe palë kontraktore në Komunitetin European të Energjisë.

Plani i ri synonte ta ngrinte sistemin në një nivel të ri cilësor, si nga kuadri ligjor dhe rregullator ashtu edhe nga ana e performancës energjitike. Në të u vendosën afate dhe kufij të cilët synonin mbi të gjitha konsolidimin financiar dhe stabilitetin ligjor e ekonomik të sistemit. Të dy këto drejtime do të rrisnin atraksionin për investime, si edhe besueshmërinë financiare të sistemit.

Në këtë situatë në të cilën gjendet sistemi elektro-energjitik, objekti i këtij studimi, disertacioni, është:

Analiza e gjendjes ekzistuese dhe e performancës aktuale të sistemit duke e krahasuar atë me ndryshimet që imponon instalimi i modelit të ri të tregut të energjisë elektrike, duke finalizuar me vërtetimin rezultateve dhe performancës elektro-energjitike dhe financiare të sistemit nën kushtet e modelit të ri të tregut.

Nën këtë objektiv, studimi do t'au përgjigjet disa pyetjeve:

- Cilët kanë qenë shkaqet e dështimit të sistemit nën modelet e mëparëshme të organizimit të tregut dhe hallkave të tij?
- Cfarë prodhoi reforma e deritanishme dhe ndryshimet e bëra në kuadrin e masave të marra?
- Pse duhet të ndryshojë Plani i Rimëkëmbjes së sistemit elektro-energjitik?
- Pse duhet të derregullohet tregu i energjisë elektrike?
- A është energjia mall apo e mirë publike?
- Si janë të organizuar dhe si sillen tregjet e energjisë në rajon dhe në BE?
- A është reformimi i sistemit dhe modelimi ndryshe i tregut të energjisë elektrike një detyrim në axhendën e anëtarësimit në BE, apo një hap drejt një performace më të mirë në çdo dimension i sektorit elektro-energjitik?
- Sa lidhet kjo reformë me pjesën tjetër të tregut të energjisë në përgjithësi?
- Cila është e ardhmja e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike dhe sa do ndikojë ajo në performancën e sistemit?

Analiza e thelluar e elementeve të tregut shqipëtar të energjisë dhe përgjigjet ndaj këtyre pyetjeve do të çojnë, sëbashku me analizën sasiore e cilësore të të dhënave të performancës së sistemit, në vërtetimin e hipotezave bazë të këtij studimi dhe do të japin shumë përgjigje të vlefshme në lidhje me reagimet e ndërsjella të faktorëve të ndryshëm që ndikojnë në performancën elektro-energjitike të sektorit.

Qëllimi i këtij studimi është i dyanshëm: së pari, të ofrojë një pamje të plotë dhe të detajuar të situatës teknike dhe financiare të sektorit të energjisë elektrike, shkaqet kryesore të gjendjes aktuale dhe mësimet e nxjerra deri tani, arsyet e rrijtes së performancës në fazën e parë të reformës, si edhe nëse sistemi është në kushte të qëndrueshme; dhe së dyti, të vlerësojë rrugën e re të zhvillimit të sektorit të zgjedhur nga Qeveria Shqiptare përmes një reforme të thellë që do mund të garantojë një funksionim të sektorit në kushtet e ekonomisë së tregut, duke përmirësuar dy tregues kryesorë të tij, sigurinë e furnizimit me energji

elektrike të ekonomisë dhe standardet e kërkuara të cilësisë, bazuar në standardet më të larta të furnizimit të saj (standardet e aplikuar në Komunitetin Europian të Energjisë dhe të kërkuara e monitoruara nga Sekretariati i këtij komuniteti për të gjithë vendet anëtare dhe palët kontraktore).

Vlerësimi në këtë studim i vendimeve të marra nga ana e Qeverisë synon gjithashtu identifikimin e problemeve të shfaqura gjatë reformës dhe të propozojë ndryshime të mundëshme të cilat do të mund të garantojnë sa thamë më lart, sigurinë e furnizimit dhe cilësinë e tij sipas standardeve të BE. Këtij qëllimi i shërben edhe marrëveshja e Qeverisë me Bankën Gjermane KfW për financimin e nevojës buxhetore për planin buxhetor afatmesëm 2020-2022, e cila ka si parakusht përmbushjen e reformës në sektorin e energjisë elektrike duke kaluar përmes një plani masash me 18 tregues për t'u përmbushur, VKM 742, dt. 12.12.2018. Keto masa konsistojnë në sa më poshtë:

Zbatimi i reformës së sektorit të energjisë elektrike ka në themel të saj liberalizimin e thellë të sektorit, për ta sjellë atë në kushtet e ekonomisë së tregut, me mekanizma vetërregullues të cilët garantojnë një shëndet të plotë financiar të tij, si edhe varësi sa më të ulët nga vendimet politike të qeverive dhe aksioneve të tyre politike, gjithashtu.

Sjellja e këtij sektori në kushtet e zbatimit të reformës për liberalizimin e tij është e shoqëruar me disa masa emergjente nga ana e qeverisë si aktori kryesor aktual, pasi tre ndërmarrjet më të mëdha të sistemit janë akoma publike (100% e aksioneve shtetërore), si edhe nga ana e rregullatorit, ERE. Mund të themi se ky sektor pothuaj preku fundin në vitin 2013, deri në prag të falimentimit të tij total dhe të kolapsit financiar të këtyre tre ndërmarrjeve. Për këtë qëllim ishte e nevojshme marrja e masave të tilla si:

Masave të vazhdueshme të tilla si: përmirësimi i arkëtimeve për faturimet, reduktimi i humbjeve, ristrukturimi i tarifave, racionalizimi i operacioneve të biznesit dhe rritja e performancës së kompanive, veçanërisht në OSHEE, rritja e investimeve kapitale nëpërmjet lëshimit të Garancive Qeveritare për financim të investimeve, ristrukturimi i overdraft-eve dhe forcimi i zbatimit të disiplineve të pagesave mes kompanive të sektorit¹⁷ dhe nga institucionet shtetërore; dhe

Masave që merren për here te pare të tilla si pastrim dhe sistemim të llogarive mes ndërmarrjeve me njera-tjetrën, si edhe të tyre me palët e treta, shuarje me kompensim të detyrimeve të institucioneve buxhetore dhe jo-buxhetore (netting-off), reforma në strukturën e modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, pastrimi i detyrimeve të prapambetura ndaj PPE/Ashta dhe injektive të mundshme në kapitalin e vet, si edhe rivlerësim i asteteve për të tre ndërmarrjet, sigurim i pavarësisë së rregullatorit dhe harmonizim i legjislacionit vendës me atë europian duke transpozuar të gjitha direktivat e komunitetit të energjisë në legjislacionin kombëtar të sektorit.

Kjo kërkon gjithashtu një menaxhim të vazhdueshëm të riskut të sektorit në tre aspekte: raporti i borxhit total me vlerën totale të asetëve (leva financiare), i cili duhet të vijë duke u ulur për të rritur shëndetin financiar të tyre dhe për t'u bërë ato komerciale në tregun financiar pa qenë nevoja e mbulimit me garanci qeveritare, varësia nga ndryshueshmëria e motit e cila e ekspozon gjenerimin e energjisë vazhdimisht në pamundësi prodhimi dhe rrezik të çenimit të sigurtisë së furnizimit me energji elektrike të ekonomisë dhe risku i

¹⁷ Plani i Rimëkëmbjes Financiare të Sektorit të Energjisë , shkurt 2015

zbatimit të planeve për të tre kompanitë, i cili lidhet me mënyrën akoma shumë politike të drejtimit të tyre dhe të marrjes së vendimeve menaxheriale.

Duke marrë në konsideratë këto risqe Qeveria vendosi të marrë disa masa të rëndësishme politike sektoriale:

- a. të fuqizojë menaxhimin e OSHEE nëpërmjet një kontrate menaxhimi të bazuar në rezultate, sikurse është përshkruar dhe mbështetur nëpërmjet Projektit të Rimëkëmbjes së Energjisë të financuar nga Banka Botërore për të siguruar që kostot, përmirësimi i humbjeve dhe objektivat e arkëtimit të monitorohen dhe të jenë të arritëshme, gjë që përbënte dhe kyçin e suksesit të planit të rimëkëmbjes;
- b. të kthejë në shoqëri të vërteta tregtare të pavarura kompanitë shtetërore dhe të përmirësojë mirëqeverisjen dhe menaxhimin, jasht ndërhyrjes politike¹⁸ duke:
 - fuqizuar përgjegjësinë e këshillave mbikëqyrës, në përputhje me përcaktimet e bëra në statute,
 - fuqizuar llogaridhënien e shoqërive dhe rritur transparencën e tyre ndaj tregut dhe publikut,
 - përfshirje në këshillat mbikëqyrës të specialistëve të pavarur nga tregu i energjisë, por dhe ai financiar për të ndihmuar kompanitë të formulojnë politika zhvillimi dhe monitorojnë performancën e drejtimit, sidomos në aspektin teknik dhe financiar;
 - përshtatur praktika tregtare (si psh. maksimizimin e vlerës së kapitalit) në përputhje me kuadrin rregullator.
- c. të kryejë ndarjen formale dhe funksionale të OSHEE Group, duke veçuar funksionin e shpërndarjes (rrjeti shpërndarës) nga furnizimi, sikurse parashikohet në Ligjin bazë të Sektorit të Energjisë Elektrike 43/15 i amenduar në maj 2020, dhe duke e transferuar përgjegjësinë për mbështetjen e prodhuesve të pavarur të energjisë elektrike (IPP - Independent Power Producers) nga FTL (Furnizuesi i Tregut të Lire) pjesë e OSHEE Group, tek një entitet i ri, Operatori i Energjisë së Rinovueshme (OER) krejtësisht i pavarur nga OSHEE Group. Kjo e fundit do ta hedhë këtë energji në tregun e parregulluar nëpërmjet Tregut të Ditës në Avancë ose Bursës Shqiptare të Energjisë (ALPEX) nëpërmjet një mekanizmi kompensimi të diferencave që rezultojnë mes çmimit të energjisë të vendosur në treg dhe asaj që këta prodhues kanë në kontratat e tyre më shtetin me tarifa të favorizuara;
- d. thellimin e ndarjes së sektorit, me një ndarje të mëtejshme të OSHEE - midis shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë tek konsumatori fundor, dhe rritjen e pavarësisë menaxheriale në respekt të ligjit bazë të sektorit të energjisë elektrike, gjë e cila është arritur sëfundmi dhe pret certifikimin nga ana e Sekretariatit të EnC; dhe
- e. Të pregatisë një sektor të strukturuar për të lejuar pjesëmarrjen e kapitalit privat sapo të rivendoset fitimi dhe bilancet financiare të jenë kthyer në gjendje të shëndoshe financiare, dhe të jetë vendosur një sistem të dhënash për të siguruar një


¹⁸ Kërkesë e vazhdueshme e Sekretariatit të Komunitetit Europian të Energjisë. në të njëjtën terminologji theksohet edhe në direktivën europiane dhe në një nga komponentët kryesorë të Planit Strategjik të Masave për Reformimin e Sektorit të Energjisë, VKM 742, dt. 12.12.2018. Shmangia e këtij problemi, theksohet në në ligjin 43/15 në nenet 10-17 të ligjit.

veprimtari operacionale efçente dhe transparente në sektor. Ky sistem të dhënash do të arrihet dhe bëhet i vlefshëm përmes të vetmit instrument të modelit të ri të tregut, që është ALPEX, i cili do të garantojë akses të të gjithë operatorëve në treg.

1.4 Zhvillimi i kapaciteteve gjeneruese

Shqipëria është një vend i cili prodhon energji elektrike 100% të pastër, bazuar në përdorimin e burimeve hidro, të energjisë së diellit, të erës dhe asaj gjeotermike. Prodhimi i saj bazohet kryesisht në prodhimin e KESH, dhe prodhuesit privatë me kapacitete të mëdha, të mesme, të vogla të cilët prodhojnë rreth 25% të të gjithë prodhimit në vend.

Figura 3. Prodhimi historik i energjisë elektrike në vend 2009-2019¹⁹



Fuqia e instaluar e energjisë elektrike në vend është rreth 2.3 GW, nga të cilat rreth 2.275 GW janë energji bazuar në hidro, dhe rreth 22 MW energji diellore²⁰. Janë në punë gjithsej 201 impiante gjenerimi hidro, në pronësi të 140 subjekteve juridike. Vetëm katër impiante gjenerimi (HEC-e) janë me pronësi shtetërore, të zotëruara nga kompania KESH (3) dhe një nga Bashkia Tiranë. Prodhimi i tyre në vitin 2019 ishte rreth 5.206 Twh, rreth 11% më i ulët se mesatarja historike e dhjetë viteve të fundit (Fig.3).

KESH gjithashtu ka në pronësi edhe një TEC (central që prodhon energji elektrike me fosile - diesel) me kapacitet të instaluar rreth 100 MW, por për arsye të një difekti në instalim dhe për arsye të çmimit të lartë të prodhimit të saj bazuar në këtë teknologji, nuk është vendosur asnjëherë në punë. Një zhvillim i ardhshëm në sistemin e gjenerimit të energjisë elektrike në vend është edhe projektimi dhe marrja e vendimit për ndërtimin e HEC Skavica në pjesën e sipërme të lumit Drin, në pjesën veri-lindore të vendit. Kjo vepër pritet të rrisë akoma më shumë eficiencën e prodhimit të energjisë elektrike në kaskadën e Drinit, si edhe do të rrisë në standard mjaft të larta sigurinë e saj dhe mbrojtjen për zonën

¹⁹ Raporti vjetor ERE 2019

²⁰ Raporti vjetor ERE 2019, pp. 30

e deltës së Drinit nga përmytjet. Bazuar në deficiencën neto të sektorit të prodhimit të energjisë elektrike në vend i cili deri tani nuk e ka plotësuar asnjëherë këtë kërkesë, si edhe në varësinë e lartë të tij nga burimet hidrike dhe kushtet klimaterike (aktualisht 99.6% bazohet në hidro), qeveria Shqiptare ka vendosur si prioritet të saj në të ardhmen diversifikimin e burimeve të prodhimit të energjisë elektrike duke u bazuar kryesisht në burime të rinovueshme si edhe në prodhim nga TEC-e por që përdorin gaz natyror i cili konsiderohet midis burimeve fosile si një burim i pastër relativisht dhe akoma i mbështetshëm si lëndë djegëse. Burimet kryesore në të cilat Shqipëria ka vendosur të mbështetet për prodhimin e energjisë elektrike janë ato të diellit, erës, gjeotermike apo energji blu (energji nga dallget e detit). Qeveria Shqiptare ka vendosur të mbështesë me çmim favorizues energjinë e prodhuar nga këto burime, si edhe me kontrata të tipit Contract for Difference, të cilat përfitohen përmes një procesi gare të hapur. Janë miratuar deri tani ndërtimi i impianteve të mëdha fotovoltaike me fuqi totale të instaluar prej 240 MW, nga e cila 50% është e lidhur me kontratë për diferencë. Çmimet e arritura përmes garave të zhvilluara janë 24.86 Euro/Mwh dhe 29.89 Euro/Mwh, që të dyja të fituara nga kompania Volitalia (franceze) dhe për t'u ndërtuar në harkun e 24 muajve. Akoma qeveria duhet të shpallë garë për ndërtimin edhe të 260 MW fuqi të instaluar me mbështetje përmes së njëjtës formula për energjinë e diellit. Duke iu referuar strategjisë së energjisë së Shqipërisë, totali i potencialit fotovoltaike për prodhim të energjisë elektrike është rreth 2 GW fuqi të instaluar dhe ai i bazuar në energjinë e erës është rreth 3 GW. Të tjera projekte bazuar në investime dhe iniciativë private janë në fazë projektimi dhe zbatimi në kapacitete nën dhe mbi 2 MW fuqi të instaluar për energjinë e diellit dhe nën e mbi 3 MW për energjinë e erës. Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator i sektorit në pjesën e prodhimit të energjisë elektrike i ka dhënë një impuls të ri interesit të investitorëve të ndryshëm për të instaluar kapacitete të reja në prodhim të energjisë elektrike. Projektioni i Shqipërisë për vitin 2030 është të dyfishojë prodhimin e sotëm.

Bazuar në të ardhmen e zhvillimit të sektorit të gazit si burim i rëndësishëm energjie në vend në të ardhmen, sipas Masterplanit Kombëtar të Gazit për Shqipërinë janë të parashikuara edhe instalimi i 1000 MW fuqi të instaluar TEC-e të shpërndara në pika të ndryshme të territorit, kryesisht pranë burimeve të gazit (TAP, IAP, LNG dhe prodhim vendës i gazit), të cilat e kthejnë përfundimisht Shqipërinë në eksportues neto të energjisë elektrike brenda vitit 2030.

Zhvillimi akoma më i lartë i teknologjive të mësipërme, si edhe ulja e kostove të prodhimit dhe instalimit të tyre në nivel ndërkombëtar, do të bëjnë të mundur edhe uljen e mëtejshme të kostove të gjenerimit të energjisë elektrike në vend dhe do të rrisin konkurrueshmërinë e këtyre burimeve edhe me forma të pafavorizuara me çmim, sidomos në tregun rajonal dhe atë ndërkombëtar.

1.5 Zhvillimi i rrjetit të transmetimit

Shqipëria ka një rrjet transmetimi i cili përbëhet nga rrjeta të tensionit të lartë 110/220/400 KV i cili ka një mbulim të gjerë territoriale dhe gjithashtu garanton hyrjen e energjisë elektrike nga tregu rajonal dhe më gjërë përmes korridoreve të interkoneksionit në këtë rrjet. Kapaciteti total i interkoneksionit të Shqipërisë me zonat e tjera ofertuese dhe rregulluese (jashtë kufijve kombëtarë) është, nën një protokoll sigurie të lartë, rreth 1200

MW, e mjaftueshme për të përballuar nevojën vendase për konsum edhe në rast të rënies totale të gjenerimit të energjisë elektrike në vend. Ky rrjet i shtrirë në të gjithë territorin e vendit, si edhe me mbulim të gjërë ndërlidhës ndërkufitar, është projektuar si për të mbështetur një siguri të lartë furnizimi të tregut vendës, porë dhe për të mbështetur instalimin e burimeve të reja në vend dhe të përthithjes së tyre jo vetëm për tregun vendës por dhe për atë ndërkombëtar. Zhvillimi i politikave të integruara me Kosovën dhe gjithashtu me Italinë dhe Malin e Zi për rritjen e kapaciteteve të transmetimit, ka bërë të mundur edhe integrimin e gjerë dhe gjithnjë në rritje të këtyre tregjeve. Aktualisht, Shqipëria alokon kapacitetet e saj të transmetimit të energjisë elektrike më tregun ndërkombëtar dhe atë rajonal nëpërmjet CAO SEE e vendosur në Podgoricë të Malit të Zi. Sistemi i transmetimit në Shqipëri është i gjithi i autokomanduar me sistem SCADA qysh nga 2016. OST si pronare e rrjetit të transmetimit në vend është përgjegjëse për shërbime të rezervës sekondare dhe terciare, si edhe për shërbimet e balancimit të tregut në kërkesë dhe ofertë të energjisë elektrike.

Gjatë periudhës 2011-2019 në rrjetin e transmetimit janë kryer mbi 250 milion Euro investime, dhe në vitin 2022 pritet të mbarojë ndërtimi edhe i linjës së interkoneksionit me Maqedoninë e Veriut, Bitola-Elbasan-Fier 400 KV me një investim prej rreth 80 milion Euro. Në projektet afat-mesëm OST është duke planifikuar të ndërtojë edhe dy linja të tjera interkoneksioni me Malin e Zi dhe me Greqinë, secila në nivelin 400 KV, duke arritur një fuqi maksimale transmetimi nga tregu i jashtëm prej rreth 1.8 GW. Kjo do të garantojë plotësisht nevojën e brendëshme dhe një siguri furnizimi 100% të ekonomisë kombëtare më energji elektrike.

Gjithashtu, duke iu referuar edhe New Policy Guidelines të Komunitetit Europian të Energjisë lidhur me Transit Energy, pra me nxitjen dhe mbështetjen e energjisë së pastër, oferta për energji do të jetë më e shtrejtë të paktën për 10 vitet e ardhëshme. Për këtë arsye, rritja e kapaciteteve të transmetimit ndërkufitar do të ndihmojë në mbajtjen akoma në nivele të ulta të furnizimit me energji në vend, pasi do të kemi më shumë akses në tregun ndërkombëtar, por edhe do të kemi më shumë kapacitete për të ofruar për transmetimin e saj brenda dhe jashtë vendit.

1.6 Zhvillimi i rrjetit të shpërndarjes

Shpërndarja është sektori i cili është dëmtuar më shumë nga politikat e ndjekura në sektor në Shqipëri. Pas ndarjes së madhe gjenerim, transmetim dhe shpërndarje në fund të vitit 2007, hapi tjetër i radhës ishte privatizimi i shpërndarjes. Privatizimi ndodhi në fund të vitit 2008 dhe u zhbë në shkurt 2013 pas një kolapsi total të Cez Albania. Ky privatizim përfundoi në mënyrë të ekzagjeruar i dështuar deri në falimentim dhe heqje të licensës së operimit në treg të Cez Albania nga ana e ERE. Kompania e shpërndarjes kaloi nën administrim dhe mbikqyrje të entit rregullator. Ky falimentim prodhoi disa rezultate shumë negative:

- i. Humbjet e shpërndarjes arritën në mesatarisht 45% në 2013, ndërsa ato panë maksimumin e tyre negativ në Dhjetor 2013 me 53%²¹
- ii. Arkëtimet në total arritën 78% dhe arkëtimet korrente arritën në 48%

²¹ Burimi i të Dhënave OSHEE Group dhe Raporti Vjetor i ERE 2013

- iii. Pagesa mesatare e faturës korrente të Cez ndaj KESH për energjinë e ofruar ishte më pak se 40% në 2012 dhe 2013
- iv. Detyrimet ndaj të tretëve për Fatura dhe shërbime të papaguara (përfshirë shpenzimet financiare dhe borxhin) ishin mbi 110 miliard lekë (ndaj KESH, ndaj Ministrisë së Financave për kredi të pa shërbyer, ndaj tatime dhe taksave, ndaj OST etj)
- v. Ndërprerjet ditore të energjisë elektrike për konsumatorët ishin nga 7 deri 12 orë
- vi. Investimet në rrjetin e shpërndarjes për katër vite ishin zero lekë
- vii. Detyrimet e konsumatorëve për energji të papaguar për më shumë se 6 këste mujore ishin mbi 130 miliard lekë
- viii. Vlera e kapitalit të shpërndarjes ishte -78 miliard dhe inventari i aseteve vleresohej rreth 26 miliard lekë
- ix. Ujësjetllësat dhe institucione të tjera buxhetore edhe jo buxhetore kishin maturuar një borxh prej më shumë se 48 miliard lekë për energji të pa paguar
- x. Rrjeti i shpërndarjes ishte mjaft i amortizuar dhe mbi 80% i tij nuk ishin ri-investuar prej 36 deri 40 vjetësh
- xi. Gjendja dhe situata me standardet e përdorura për instalimet në rrjet dhe sidomos në fidera dhe nënstacione ishte mjaft kaotike dhe e lënë kryesisht pa mirëmbajtje.
- xii. Kompania e re e krijuar OSHEE dhe shteti shqipëtar ishin në arbitrazh me Cez për shtetëzimin e shpërndarjes dhe adresimin e humbjeve të saj. Arbitrazhi përfundoi me marrjen e 100% të aksioneve nga shteti shqipëtar dhe, ndërkaq, shteti shqipëtar morri përsipar të shlyente një linjë kredie të marrë nga Cez Albania pak para se të ndodhte falimenti prej një shume totale 96 milion Euro bashkë me interesa.
- xiii. Ujësjetllës e kanalizime paguajnë jo më shumë se 26% të faturës korrente. Borxhi i tyre deri në 31 Dhjetor 2020 ishte 25.6 miliard lekë, duke filluar nga 1 Janar 2015 etj.

Të gjithë këto probleme, por edhe të tjera të parenditura si ndërhyrjet abusive në rrjet, familje/shtëpi me më shumë se një sahat, matësa të dëmtuar ose manipuluar, rreth 12% e konsumatorëve pa matës, lidhje të reja të parregullta, shërbim klientësh jo efektiv dhe jo eficient, skemë drejtimi e kompanisë që nuk ka asgjë të përbashkët me një korporatë, punësime aspak profesionale, sistem pagash jo adekuat etj, kërkonin një reformim dhe ristrukturim rrënjësor të shpërndarjes. U ndërmorën mjaft masa reformuese nën asistencë të partnerëve ndarkombëtarë të cilat synonin së pari, rritjen e performancës menaxheriale të kompanisë, keshillit mbikqyrës dhe asamblesë së oratakëve, së dyti, vendosjen e auditit të brendëshëm të kompanisë nën varësinë e keshillit mbikqyrës, u standardizua sipas kërkesave aktuale të zhvillimit të korporatave në nivel ndarkombëtar statute dhe akte të tjera ligjore që rregullonin veprimtarinë e OSHEE. U vendos që krahas planifikimit vjetor i cili niste që në muajin shkurt për vitin pasardhës, të hartoheshin dhe aprovoheshin dhe planet afatmesme (3-vjeçare) dhe afat-gjatë (5-vjeçare), së treti, u miratua struktura e re e funksionimit të ndërmarrjes me bazë sektoriale, shpërndarje (tension i lartë dhe i mesëm-i ulët), furnizim dhe departamenti i tregëtisë, së katërti, u morën masa organizative të cilat rrisnin prezencën e punonjësve të OSHEE në terren, atje ku konsumohet energjia elektrike për të evituar sa më shumë vjedhjen e saj dhe abuzimet, së pesti, u ndryshua sistemi i tarifimit nga me bazë sektorësh ekonomie, në me bazë tensioni, pra aksesit në rrjet (me bazë kostoje furnizimi dhe aksesit në rrjet të shpërndarjes), së gjashti, u sistemuan sistemet e shërbimit të borxhit (borxhet për energjinë dhe shërbimet e papaguara u transformuan në

kredi afat gjata), së shtati u instalua një sistem i ri billing dhe u pajisën me matësa të gjithë konsumatorët dhe klientët etj, dhe shumë masa të tjera të cilat e paraqesin OSHEE Group si një korporate të standardeve më të larta ndërkombëtare.

Më tej, me hyrjen në fuqi të VKM 742, dt 12.12.2018 në Planin strategjik i masave për reformimin e sektorit të energjisë elektrike, një plan i përbërë nga 18 masa të ndara për t'u implementuar në dy faza, OSHEE u transformua në OSHEE Group thelloi procesin e reformimit të saj nëpërmjet një ndarje (unbundling) të plotë të shpërndarjes nga furnizimi dhe funksionet tregëtare. Ajo u nda në tre kompani bija; OSSH (Operatori i Sistemit të Shpërndarjes), FSHU (Furnizuesi i Shërbimit Universal) dhe FTL (Furnizuesi i Tregut të Lirë). FSHU ishte edhe furnizuesi i cili shërbente ndaj konsumatorëve në tregun e rregulluar, subject shërbimit publik, ndërsa FTL shërbente në tregun me shumicë për sigurimin e energjisë së nevojshme për humbjet e shpërndarjes por edhe për nevojat shtesë të FSHU, si edhe për të furnizuar me energji konsumatorët dhe klientët në tregun e parregulluar. Në mënyrë që grupi të ketë sa më pak konflikte brenda tij, u vendos Oficeri i përputhshmërisë dhe programi i përputhshmërisë. (kërkesë e Traktatit të Energjisë për ndërmarrje të integruara vertikalisht nën një pronësi). Ky proces i ndarjes tashmë ka mbaruar dhe është çertifikuar nga ERE dhe nga partnerët tanë në projektin e përbashkët për zbatimin e VKM 742. Pritet vetëm çertifikimi i tij nga ana e Sekretariatit të EnC. Ky proces kryhet përmes aplikimit të arritjeve ndaj çdo detyrimi në një matricë dhe më tej fillon verifikimi i arritjeve, monitorimi i funksionimit real dhe çertifikimi. Ndarja ose unbundling duhet të jetë e plotë në lidhje me pronësinë, administrimin dhe funksionimin, emërtimin dhe adresën elektronike dhe atë të vend ndodhjes.

1.7 Proceset e detyruara nga përafrimi i legjislacionit shqipëtar me atë europian

Siç edhe përmenda më lart, ky proces ka nisur me zbatimin e paketës së tretë të energjisë 2009/72/EC dhe është zgjeruar e zhvilluar më tej nëpërmjet modifikimeve që ka pësuar kjo paketë lidhur me disa parime të rëndësishme si mbrojtja e mjedisit, mbrojtja e konsumatorëve, parimet e transparencës me publikun (sidomos në investimet e reja në gjenerim), vendosja e targeteve për përdorimin e energjisë së pastër (targeti i Shqipërisë është 38% e konsumit duhet të vijë nga burime të rinovueshme), ndryshimet e ndryshme në policy guidelines të Komunitetit Europian të Energjisë (EnC) si edhe direktivës europiane (e gjithë paketa e dokumenteve të saj) për sektorin e energjisë dhe objektivat e saj për t'u zbatuar nga vendet anëtare dhe palët kontraktore (Shqipëria është palë kontraktore dhe themeluese e EnC). Në Shkurt 2019, në Podgoricë, u firmos deklarata e përbashkët e të gjithë vendeve të EnC sëbashku me EU për Transit Energy në hapësirën e BE (e detyrueshme për zbatim) dhe në zonat e asociuara me të për programe të ndryshme zhvillimi dhe asistence ekonomike. Në këtë deklaratë u vendos që për çdo zonë ekonomike zhvillimi të orientohej nga energjitë e pastra, duke minimizuar në maksimum, sipas targeteve për çdo zonë të emisionit të karbonit dhe gazrave të tjerë ndotës. Kjo deklaratë iu referua parimeve bazë të sanksionuara në deklaratën e Parisit për një mjedis të pastër dhe modifikoi politikat udhëheqëse të EnC për zhvillimin energjistik, duke bërë të detyrueshme hartimin e planeve kombëtare për dekarbonizimin dhe nxitjen e investimeve në energji të pastra. Shqipëria është nga të paktat vende në Europë me standard mjaft të larta lidhur me prodhimin dhe konsumin e energjisë nga fosilet. Praktikisht e gjithë energjia

elektrike e prodhuar në vend është energji e pastër. Nuk mund të themi se energjia e importuar ka të njëjtat standarde.

1.7.1 Paketa e tretë e energjisë dhe përafrimi i legjislacionit shqiptar të energjisë

Kërkesat kryesore të kësaj pakete, 2009/72/EC, janë ndarja e prodhimit të energjisë elektrike nga transmetimi i saj dhe nga shpërndarja, ndarja e shpërndarjes nga furnizimi, zbatimi i standardeve të kësaj pakete dhe i kërkesave të traktatit europian të energjisë për kompletimin e këtyre proceseve, liberalizimi i tregut fundor të energjisë, sigurimi i pavarësisë së rregullatorit (ERE), garantimi i sigurisë së furnizimit si e mirë publike në treg etj. Kjo paketë mbetet në themel të reformimit të sektorëve të energjisë brenda EU, por veçanërisht në të gjithë palët kontraktore që i janë bashkuar EnC dhe tregut EU të energjisë, pavarësisht ndryshimeve që ka pësuar lidhur me sanksionimin e kritereve të qëndrueshmërisë dhe të mbrojtjes së mjedisit e komuniteteve konsumatore. Ajo gjithashtu garanton te drejta të barabarta në konsum për të gjithë konsumatorët, duke garantuar nëpërmjet mekanizmash të diferencimit pozitiv, grupet në nevojë. Edhe Shqipëria e ka garantuar këtë të drejtë nëpërmjet VKM Nr. 8, dt 14.01.2015.

1.8 Ndarja (Unbundling) e sistemit në ndërmarrje të pavarura

Siç përmendëm edhe më lart, procesi i unbundling ka filluar qysh në vitin 2004, me ndarjen nga KESH (Korporata Elektro-energjitike Shqiptare) të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST), dhe më tej të ndarjes më vete të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), ku pronësia e OST kaloi nën Ministrinë e Ekonomisë dhe dy të tjerat nën ministrinë që mbulonte sektorin e energjisë elektrike në fushën e saj të mbulimit. Kjo ndarje presupozonte se do të rriste shëndetin e tyre, por edhe do të nxiste krijimin e tregut me shumicë të energjisë elektrike duke stimuluar si segmentin e tregëtarëve të energjisë elektrike edhe atë të gjeneruesve privatë, dhe që të gjithëve iu garantohej akses i barabartë në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes nga OST dhe OSSH. I ndjekur në 2008 nga privatizimi i OSSH zhvillimi i sektorit public të energjisë elektrike, u mendua se unbundling si proces tashmë ishte kompletuar (bazuar në paketën e dytë të energjisë, e cila u shfuqizua në 2009 dhe u zëvendësua me paketën e re të tretë të energjisë 2009/72/EC). Ky privatizim, për shumë arsye (politike, menxheriale, financiare, kulturore etj) rezultoi i dështuar dhe Shqipëria rezultoi me një direktivë europiane (paketa e tretë) të pa zbatuar dhe të pa harmonizuar në ligj. Proces i zbatimit të saj filloi me hartimin dhe miratimin e ligjit të ri të sektorit të energjisë elektrike 43/2015, ligjin për performance e ndërtesave dhe eficiencën energjitike 116/2016, ligji për mbështetjen e prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme 07/2017, akteve ligjore dhe nënligjore në mbështetje të tyre, reformimin strukturor dhe rregullator të sistemit elektro-energjitik, miratimin e strategjisë së energjisë (VKM 480, dt. 31.07.2018), përfundimin e ndarjes së OSHEE në tri ndërmarrje bija - OSSH (Operator i Sistemit të Shpërndarjes), FSHU (Furnizuesi i Shërbimit Universal) dhe FTL (Furnizuesi i Tregut të Lirë), krijimin e bursës Shqiptare të energjisë elektrike ALPEX dt. 13.10.2020 dhe bërjen aktive të saj në fillim të 2022, krijimin e Operatorit të Energjive të Rinovueshme i cili do të mbështesë zhvillimin e këtyre burimeve duke iu garantuar atyre

mbështetjen shtetërore, aplikimin e Kontratës për Diferencë për nxitjen e zhvillimit të këtyre burimeve në kushtet e liberalizimit më të thellë të tregut të energjisë elektrike, aplikimin e rregullave të balancimit të këtij tregu etj.

1.9 Modeli i tregut pas ndarjes së shpërndarjes nga furnizimi

Modeli i ri i tregut i sanksionuar në ligjin e sektorit të energjisë elektrike 43/2015 përcakton se duhet të thellohet derregullimi dhe të përfundojë ndarja e OSSH nga FSHU dhe FTL, duke garantuar kështu akses të barabartë edhe në rrjetin e shpërndarjes të të gjithë aktorëve në treg, qofshin këta gjenerues të vegjël, apo konsumatorë fundorë të lidhur në çdo nivel tensioni. Kjo ndarje dhe pavarësi e shpërndarjes kërkon edhe përcaktimin e qartë të tarifave të aksesit në rrjetin e shpërndarjes, të cilat nuk duhet të garantojnë favorizim për asnjë përdorues të tij. Në shërbim të këtij detyrimi ka dalë edhe VKM 519, dt. 13.07.2016 për miratimin e modelit të ri të tregut të energjisë elektrike, e amenduar me urdhërin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 28, dt. 18.01.2021, për pjesën e aneksit 4 të saj lidhur me kalendarin e derregullimit të shprehur në kapacitete energjitke. Zbatimi i plotë i këtij modeli parashikon edhe liberalizim të plotë të tregut dhe mbarimin e aplikimit të tarifave të rregulluara.

Ky model do të bëhet plotësisht i zbatueshëm nëpërmjet instrumentit të tregut të ditës në avancë ose bursës së energjisë elektrike, e cila tashmë është e krijuar qysh nga Tetori i 2020. Integrimi i tregjeve të energjisë elektrike me Kosovën dhe të gjithë hapat e marrë për krijimin e një tregu të përbashkët, rrisin akoma më shumë mundësinë e zbatimit të plotë të kësaj kërkesë të ligjit 43/15, duke mundësuar rritjen e volumeve të energjisë elektrike të tregëtuara në të.

Modeli i ri i tregut kërkon gjithashtu që të jenë të sistemuara detyrimet e ndërsjella të operatorëve kryesor në treg dhe të ketë mjaftueshëm likuiditete në të. Mekanizmi i përcaktuar për zbatim në treg është pozicionimi i aktorëve një ditë përpara për ofertën dhe kërkesën e tyre dhe aplikimi i ofertës si nëpërmjet pozicioneve të lira direkt, ashtu edhe nëpërmjet grupimit në grupe ofertuese, ose tregëtim me mekanizmin e kontratës për diferencë. Algoritmi i ofertave të ndryshme përmes *service provider* të bursës do të bëjë të mundur përcaktimin e çmimit të tregut dhe respektimin e kontratave mbështetëse për prodhuesit e favorizuar/prioritarë me modelin e kontratës për diferencë. Pjesa e mbështetjes do të garantohet nga sistemi publik përmes Operatorit të Energjive të Rinovueshme i cili do të tregëtojë dhe kompensojë të gjitha diferencat negative që do të rezultojnë nga pjesëmarrja e prodhuesve prioritarë në këtë treg.

Struktura e aktorëve në bursë mund të përbëhet nga këto subjekte:

- i. Operatorë të tjerë të sistemit të transmetimit (më poshtë referuar si TSO) të themeluar dhe që operojnë në Bashkimin Evropian ose në vendet anëtare të Komunitetit të Energjisë;
- ii. Operatorët me aktivitete ndërkombëtare, me eksperiencë në operimin/menaxhimin e tregjeve të shkëmbimit të energjisë elektrike të themeluar dhe që operojnë në Bashkimin Evropian ose në vendet anëtare të

Komunitetit të Energjisë në përputhje me rregullat dhe modelin e tregut të energjisë elektrike në Shqipëri (me poshtë referuar si ËOperatorët me Eksperiencë Ndërkombëtareò ose OEN);

- iii. Subjekte pjesëmarrëse në tregun e energjisë elektrike, me përvojë në tregtimin e energjisë elektrike në Bashkimin Europian ose në vendet anëtare të Komunitetit të Energjisë (me poshtë referuar si ËPjesëmarrësit e Tregut të Energjisëò ose PTE); dhe/ose
- iv. Institucione financiare ndërkombëtare (me poshtë referuar si IFN)²².

Struktura e aksionerëve që zotërojnë kapitalin, sipas pikës 3, të këtij vendimi, do të jetë:

- i. TSO, duke përfshirë këtu edhe OST Sh.a, do të kenë të paktën 55,5 % të kapitalit;
- ii. OEN mund të kenë jo më shumë se 24,5 % të kapitalit;
- iii. PTE mund të kenë jo më shumë se 10 % të kapitalit;
- iv. IFN mund të kenë jo më shumë se 10 % të kapitalit.

Gjithashtu janë përcaktuar me VKM 609, dt. 11.09.2019 edhe procedurat e krijimit të bursës së energjisë emri i të cilës është nominuar ALPEX.

Pas plotësimit të të gjithë procedurave, ALPEX është tashmë e krijuar me pronësi të OST Albania 57% dhe KOST 43%. Tashmë ALPEX është në fazën e kontraktimit të *service provider* dhe pritet që volumet e para të lëvrohen në janar 2022.

ALPEX është i vetmi instrument që ligji bazë i sektorit të energjisë 43/15 përcakton për instalimin dhe zbatimin e modelit të ri të tregut të energjisë elektrike. Në të do të akomodohen të gjithë volumet e kërkesës vendëse për energji elektrike, por edhe burimet dhe ofertuesit e saj. Rritja e gjenerimit të energjisë elektrike në vend, si edhe e kapaciteteve të transmetimit dhe shpërndarjes, do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike të tregut vendës. Integrimi rajonal i këtij tregu në vendet e ballkanit perëndimor, por edhe më gjërë do të nxisë gjithashtu edhe rritjen e instalimeve të reja të prodhimit të energjisë elektrike në vend. Kjo do të bëhet si duke mbështetur projektet e bazuara në tarifa favorizuese me PPA (Purchasing Power Agreement), ashtu edhe në investime të cilat me prodhimin e tyre synojnë tregun e lirë. Pas zgjedhjes së service provider (proces në vazhdim), do të vazhdohet edhe me instalimin e platformës së tregëtimit dhe konfigurimin e metodologjisë së funksionimit dhe algoritmimit të saj në funksion të ofertës dhe kërkesës ditore të ditës në avancë (day-ahead-market pricing). Parashikohet që në tremujorin e dytë të 2022 të bëhet dhe testi i thatë i operimit në bursë. Në këto kushte, pritet që ALPEX të lëvrojë volumet e para të energjisë elektrike në gjashtëmujorin e dytë të 2022.

²² VKM 322, dt. 18.05.2019, Për krijimin dhe përcaktimin e formës ligjore dhe strukturës së pronësisë së kapitalit të operatorit të tregut.

Procesi i instalimit të modelit të ri të tregut do të shoqërohet me një integrim të plotë të tregjeve midis Shqipërisë dhe Kosovës, si edhe me përmbylljen plotësisht të procesit të liberalizimit dhe derregullimit të tregut fundor të energjisë elektrike. Sa më afër konkurrencës perfekte të jemi në këtë treg, aq edhe më të ulëta do të jenë kostot e energjisë elektrike. Kjo do të përmirësontë shumë edhe situatën në treg lidhur me sigurinë e furnizimit, kur kemi parasysh edhe levizjet shumë kaotike të tregut të energjisë elektrike kudo në rajon e më gjërë, nëpër botë.

Aktualisht BE dhe e tërë bota janë në një situatë kaotike sa i takon furnizimit me energji elektrike. Çmimet e saj nëpër të gjitha bursat janë rritur me disa herë. Disa nga arësyet e identifikuara dhe të analizuara janë:

1. Procesi i dekarbonizimit të energjisë (transit energy) që ka nisur tashmë në të gjithë BE dhe më gjërë dhe synon të reduktojë maksimalisht përdorimin e burimeve të energjisë me bazë karboni për prodhimin e energjisë elektrike. Bazuar në *new policy guidelines* të Komunitetit Europian të Energjisë, kjo është kostoja që të gjithë vendet duhet të përballojnë për të ruajtur mjedisin dhe për përmirësimin e tij tani dhe në të ardhmen.
2. Në kuadrin e procesit të dekarbonizimit janë mbyllur mjaft prodhues të energjisë elektrike. Kjo ka sjellë që kërkesa me ofertën për energji elektrike të prehen/piqen me shume vështirësi. Kemi një situatë *adverse supply* të saj në treg. Kjo ka bërë që çmimet e energjisë elektrike të rriten shumë (disa herë në krahësim me çmimet e ndeshura gjatë vitit 2020 dhe deri në Gusht 2021, çmime që levizin midis 200-300 Euro/Mwh). Shqipëria është një vend importues neto (net deficit country) i energjisë elektrike, kryesisht prej varësisë që prodhimi i saj në vend ka nga kushtet e motit (100% e prodhimit është nga burime të rinovueshme). Në këto kushte, çmimet e tregut ndërkombëtar të energjisë elektrike kanë ndikim direkt dhe indirekt në çmimet e saj në tregun vendës (kosto me tendencë të lartë rritje).
3. Situata e mësipërme në tregun ndërkombëtar, *adverse supply* e energjisë elektrike, ka vështirësuar edhe ulur njëkohësisht edhe efektivitetin dhe eficiencën e përdorimit të rrjeteve të transmetimit dhe shpërndarjes së saj në tregun vendës. Vështirësia në gjetjen e saj dhe ofrimin e saj ndaj kërkesës, ka rritur ndjeshëm edhe kostot e sigurimit të kapaciteteve të transmetimit të energjisë nga burimet e gjenerimit tek tregjet e kërkesës.
4. Procesi i dekarbonizimit ose *transit energy* bazuar edhe në *new policy guidelines of EnC* ka vendosur për herë të parë edhe taksën e karbonit duke synuar të reduktojë emisionin e gazit karbonik dhe gazrave të tjerë ndotës në industrinë e prodhimit të energjisë elektrike. Kjo taksë ka ndikuar direkt në rritjen e çmimeve të energjisë elektrike në treg. Edhe rajoni ynë i Ballkanit Perëndimor është pothuaj në të njejtat kushte kur më shumë se gjysma e prodhimit të energjisë elektrike bazohet në djegien e fosileve të ngurta ose të lëngëshme, ose të gazit natyror. Ky i fundit konsiderohet akoma si burim i pastër energjie.
5. Rritja e konsumit të energjisë elektrike për qëllime transporti dhe zëvendësimin e mjeteve me konsum tradicional të fosileve të lëngëta, në mjete me gaz natyror të lëngëshëm, ose energji elektrike, ose hidrogjen, ka rritur gjithashtu kërkesën

për burime të reja të energjisë së rinovueshme të cilat kanë kosto shumë më të lartë prodhime se burimet tradicionale.

6. Nxjerrja gjithashtu nga puna e centraleve berthamore për prodhimin e energjisë elektrike në një numër të konsiderueshëm, proces i cili do të thellohet, ka dhënë gjithashtu një ndikim të konsiderueshëm në thellimin e fenomenit të *adverse supply* dhe në rritjen e çmimeve të energjisë elektrike në të gjithë tregjet ndërkombëtare.

E ndodhur në këto kushte edhe Shqipëria është duke marrë masa së pari, për garantimin e plotë të sigurisë së furnizimit me energji elektrike të të gjithë tregut vendës, së dyti, menaxhimin më të mirë të rezervës energjitike në kaskadën e Drinit nëpërmjet proceseve të optimizimit të rezervës, depozitimit dhe shkëmbimit sezonal dhe orar të prodhimit, duke balancuar mbulimin për një kohë sa më të gjatë të kërkesës së rrezikuar nga sezonaliteti i prodhimit në vend, si edhe përmes realizimit të marrëveshjeve kuadër me prodhues të mëdhenj që garantojnë prodhim në mënyrë të vazhdueshme. Një tjetër rrugë që po ndiqet është instalimi i kapaciteteve të reja për prodhim energjie në vend nga burime të diversifikuara, si edhe përdorimi i gazit natyror si një burim për prodhimin e energjisë elektrike përmes projektesh moderne me eficiencë të lartë. Periudha e parashikuar dhe vlerësuar si kritike për Shqipërinë është vlerësuar të jetë 2-3 vite në afat të mesëm me objektivin e zgjidhjes afat-gjatë të saj. Rritja e kapaciteteve të transmetimit të saj me vendet fqinje është vlerësuar gjithashtu si një hap strategjik për rritjen e sigurisë së furnizimit duke e integruar gjerësisht tregun në të katër drejtimet, V-J-L-P.

1.9.1 Detyrimi për shërbim publik në furnizim me energji elektrike

Detyrimi për shërbimin publik të furnizimit me energji elektrike përfshin të gjithë prodhuesit në vend, edhe KESH, si edhe FSHU në nivel furnizimi për konsumatorët fundorë. të gjithë prodhuesit e energjisë elektrike në vend janë subject i shërbimit publik për sigurimin e energjisë elektrike, por për subjektet privatë ai zbatohet sipas kushteve të vendosura në kontratat konçesionare, ndërsa për KESH dhe FSHU ai rregullohet me VKM 244, dt. 30.03.2016 e amenduar në maj 2020. Ky detyrim detyron KESH të furnizojë FSHU për pjesën e tregut të rregulluar me energji sipas një kontrate bilaterale ku palët vendosin nëpërmjet negociatave çmimin dhe sasinë e energjisë në kushte tregu të parregulluar. Gjithnjë detyrimi mbetet për sasinë dhe jo për çmimin e energjisë. VKM nuk përcakton më volume, por vetëm detyrimin që KESH të mbështesë, sipas mundësisë së prodhimit, FSHU me energji. Detyrimet e ndërsjella janë të bazuara plotësisht në të drejtën tregëtare, lidhur me termat ekonomike dhe financiare.

1.10 ERE - roli i saj rregullator

ERE është një organizëm i pavarur i cili rregullohet me ligj dhe akte nën ligjorë të dala në funksion të ligjit 43/15 i ndryshuar. Ajo vetëfinancohet nëpërmjet fee-ve që iu merr aktorëve në treg. Kryetari dhe komisionerët e ERE zgjidhen nga parlamenti në një proces dhe procedurë gjithashtu të përcaktuar në ligjin 43/15. ERE është organi më i rëndësishëm i cili rregullon të gjithë organizmin e sektorit të energjisë. Ajo merr vendime lidhur me funksionimin e sistemit dhe në veçanti të tregut të energjisë, çertifikon operatorët në treg up-to-down stream, verifikon respektimin e standardeve sipas ligjit dhe dokumenteve të tjerë rregullatorë, aprovon tarifat e shitjes së energjisë për tregun e rregulluar, si edhe për FTL për shitjet që kjo e fundit bën në tregun e parregulluar, aprovon ose jo kontratat e lidhura me investitorët për ndërtimin e burimeve të rinovueshme të energjisë të cilat marrin statusin e prodhuesit prioritar, aprovon metodologjinë e tarifimit të energjisë elektrike në çdo nivel, nga prodhimi deri në konsum për pjesën e kërkesës së tregut të rregulluar, aprovon bilancet e ndërmarrjeve publike në sektorin elektro-energjitik, dhe si rrjedhojë edhe tarifat e operimit të tyre, organizon dëgjesa në nivele të ndryshme brenda sistemit, por ajo që ka më shumë rëndësi më konsumatorët në nivele të ndryshme, me tregëtarët e energjisë, me prodhuesit e saj etj. ERE shqyrton dhe merr masa për të gjithë ankimimet që vijnë në adresë të operatorëve të tregut në çdo nivel. Vendimet e saj janë të detyrueshme për zbatim. ERE ka autoritetin e certifikimit të reformave në sektor por edhe të rezultateve të ardhura prej tyre. ERE vërteton që siguri e furnizimit me energji elektrike të jetë e drejtë për çdo individ dhe operator në treg, dhe sidomos kujdeset për plotësimin e të drejtave të grupeve të konsumatorëve në nevojë. ERE raporton zyrtarisht me një raport të plotë para kuvendit çdo vit, si edhe harton raporte të herëpashërshme lidhur me veprimtarinë e sistemit elektro-energjitik.

1.10.1 Sistemi i tarifimit me fashë

Sistemi i tarifimit para fillimit të reformës, i miratuar nga ERE dhe i përdorur nga Cez Albania, OST dhe KESH ka qenë një sistem i cili bazohej në përcaktimin e të ardhurave të domosdoshme për mbulimin e kostove të këtyre operatoreve. Me rëndësi në këtë sistem, paraqitet edhe zgjedhja e bërë në metodologjinë e tarifimit para vitit 2015 e cila zë fill qysh nga viti 2008, kur çmimet e energjisë elektrike për konsumatorët familiar u strukturuan me dy nivele, çmimi i energjisë elektrike për konsumet më të ulëta se sasia e përcaktuar në fashën e parë të konsumit mujor (në fillim 200 kwh/muaj dhe më pas, nga 2009 u bë 300 kwh/muaj) dhe çmimi i energjisë mbi limitin e sipërm të fashës së konsumit. Në të gjithë rastet janë reflektuar në skemën e pensionit ndryshimet dhe ngarkesat negative të çmimeve të energjisë elektrike. Sistemi i fundit me fashë të favorizuar në çmim ka qenë ai me 300 kwh/muaj, ku çmimi ishte 7.7 lekë/kwh për consume më të vogla se ky limit dhe 13.5 Lekë/kwh për consume mbi këtë limit. Kur u vendos ky sistem tarifimi, struktura e konsumit në tregun familiar ishte 63% e energjisë faturohej me 7.7 lekë/kwh dhe pjesa tjetër me 13.5 lekë/kwh. Ky sistem prodhoi manipulime dhe deformime shumë të rëndësishme. Pavarësisht rritjes së konsumit të energjisë elektrike për çdo konsumator, si edhe e rritjes së të ardhurave të tyre ndër vite, kjo strukturë në fund të vitit 2013 ishte 78% me 22%. Kishte ndërtesa të cilat kishin më shumë se një kontratë energjie dhe paguanin me tarifën e ulët për të gjithë energjinë që konsumonin. Nga ana tjetër konsumatorët jo-

famllarë kishin tarifa sektoriale pavarësisht kostove të aksesit në rrjet. Në këto kushte, duke marrë në konsideratë të gjitha problemet e krijuara nga ky sistem tarifimi, qeveria vendosi të ndryshojë sistemin në sistem me tarifa të vendosura sipas kostos së aksesit në rrjet dhe energji. Ky veprim u shoqërua edhe më një fushatë të gjërë komunikimi me publikun për të gjithë efektet që sistemi i ri do shaktonte, përfshirë edhe skemat e mbështetjes për grupet në nevojë për këto efekte, drejtpërdrejtë në skemën e pensioneve dhe shpërblimeve mujore. Kjo metodologji uli interesin e konsumatorëve për manipulimin e sistemit përmes matësave dhe korrupsionit me punonjësit përgjegjës të shpërndarjes për leximin e matësave dhe faturimin. Sistemi i ri prodhoi një të ardhur shtesë qysh vitin e parë të aplikimit të reformës prej rreth 4.7 miliard lekë.²³ Kjo masë kishte në themel barazinë e të gjithë konsumatorëve në konsum të energjisë, si edhe uljen në maksimum të abuzimeve menërgjinë elektrike. Tarifat e reja për çdo nivel tensioni janë si më poshtë:

Tabela. 7. Tarifat e reja të energjisë elektrike me bazë tensioni

Tarifat e shërbimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për vitin 2015		
Niveli i Tensionit	Cmimi (lekë/kwh)	Cmimi Pik (lekë/kwh)
Konsumatorë në 35 kV	9.5	10.93
Konsumatorë në 20/10/6 kV	11	12.65
Furra buke dhe prodhim mielli në 20/10/6 kV	7.1	8.17
Konsumatorë në 0.4 kV	14	16.1
Furra buke dhe prodhim mielli në 0.4 kV	7.6	8.74
Familjare	9.5	
Tarifa për ambjentet e përbashketa në banesa koletive	9.5	
Tarife fikse e shërbimit për leximin ñzeroò (lekë/muaj)	340	

1.11 Reforma e vitit 2014

Reforma në sektorin elektro-energjitik e iniciuar nga Qeveria në Maj të vitit 2014, synonte në nxirrtë sistemin nga kolapsi në të cilin ishte përfshirë dhe konsistoi në disa masa urgjente por edhe afatmesme e afatgjata:

- Mbështetjen emergjente financiare të sistemit në të tre nivelet, gjenerim, transmetim dhe shpërndarje. Kjo u realizua me mbështetje direkte nga buxheti shtetit por edhe me kredi të buta të garantuara me garanci qeveritare sovraane.
- Sistemim i borxheve të krijuara në sistem dhe jasht tij nëpërmjet rialokimit të borxheve në formë kredish afat-gjata ose përmes pastrimit të bilanceve nga llogari debitoare totalisht pasive, kryesisht me institucionet publike dhe shtetërore. U sistemuan disa detyrime të ndërsjella me marrëveshje borxhi (CEZ, Ministria e

²³ Burimi OSHEE, Janar 2016

Financave, KESH-OST-OSHEE, pushteti vendor dhe ndërmarrjet e tij, ujësjellësa etj), dhe u vendos të merreshin masa për mos gjenerim borxhi të ri. Kjo arriti sukses, përveçse në raport me ujësjellësat me të cilat problemi mbetet i hapur dhe aktualisht ata kanë maturuar një detyrim prej me shumë se 26 miliard lekë (deri në fund të tremujorit të parë 2021)

- Shlyerja e detyrimeve të prapambetura ndaj tatime, taksa e dogana.
- Ndërhyrje në rrjet në nivelin e shpërndarjes dhe transmetimit.
- Kompletimi i të gjithë konsumatorëve me matësa.
- Pastrimi i rrjetit të shpërndarjes nga ndërhyrjet e paligjëshme.
- Ndërhyrja me rregullime mbështetëse në kodin e procedurës penale për të ashpërsuar masat e marra ndaj përfituesve të paligjëshëm.
- Kompletimi i kuadrit ligjor dhe rregullator të sistemit duke e përafruar atë me paketën e tretë të energjisë dhe direktivën europiane.
- Fillimi i kompletimit të reformës në sistemin elektro-energjitik publik.
- Ngritja e kapaciteteve menaxheriale dhe të kontrollit të performancës në të gjitha ndërmarrjet dhe institucionet shtetërore e publike të sistemit elektro-energjitik.
- Luftë pa kompromis ndaj informalitetit dhe lidhjeve të paligjëshme, duke përfshirë të gjithë institucionet garantuuese të sigurisë së pronës publike dhe të rendit publik.
- Hartimi i startegjisë së sektorit të energjisë që do të reflektonte të gjitha ndryshimet e reja dhe te pritëshme në sektorin e energjisë.
- Kompletimi i kuadrit ligjor dhe rregullator në përputhje dhe harmoni me direktivën europiane për zhvillimin e sektorit energjitik, paketën e tretë të saj 2009/72/EC.
- Ristrukturimi i ndërmarrjeve të mëdha publike të sektorit elektro-energjitik duke i sjellë ato sipas standardeve më të larta ndërkombëtare të organizimit të korporatave.
- Vendosja e standardeve korporative në planifikim për këto korporata.
- Rishikimi dhe hartimi marrëveshjeve të reja të shërbimit mes tre ndërmarrjeve të mëdha të sistemit elektro-energjitik.
- Rishikimi dhe vendosja mbi baza plotësisht ligjore e marrëdhënieve të këtyre ndërmarrjeve dhe e Qeverisë, me palët e treta në sistem, sidomos prodhuesit e pavarur privatë të energjisë elektrike.
- Ndryshimi i metodologjisë së tarifimit dhe i sistemit të tarifimit të energjisë elektrike në çdo nivel të sistemit.
- Përcaktimi i një raporti të drejtë mes investimeve dhe shërbimit të borxhit në çdo njërin nga tre ndërmarrjet publike të sistemit elektro-energjitik.
- Krijimi i një fondi garancie për zbutjen e volatilitetit të motit, duke patur parasysh që kërkesa për energji elektrike në vend është mjaftueshëm më e lartë se aftësitë prodhuese të energjisë elektrike në vend, si edhe shumë e varur nga kushtet e motit dhe reshjeve në vend.
- Përmirësim i rrjetit të transmetimit me linja të reja dhe po ashtu të shpërndarjes me investime në rrjet për të kaluar sa më parë në të gjithë rrjetin në sistemin 110/20/0.4 kV.
- Zgjidhje përfundimtare e konfliktit me Cez në shpërndarje dhe krijimi i kompanisë së re shtetërore të shpërndarjes OSHEE si shoqëri tregëtare aksionere me aksione të zotëruara plotësisht nga ministria përgjegjëse për energjinë në qeverinë Shqiptare.

- etj.

Kjo reform u perceptua si një program strategjik zhvillimi e trupëzuar në Planin e Rimëkëmbjes Financiare të sistemit publik elektro-energjitik e miratuar me vendim të qeverisë. Zbatimi i saj do të bëhej nën një mbikqyrje të rrepte të Sekretariatit të Komunitetit European të Energjisë dhe partnerëve tanë ndërkombëtarë FMN, WB, EBRD, USAID, KFW etj.

1.11.1 Kreditë e mëdha dhe implikimet e ndikuara prej tyre (Kredia e Bankës Botërore dhe kredia nga EBRD)

Në kuadrin e reformës së viti 2014 u zgjodhën si partnerë financiarë për të garantuar mbështetjen e plotë të saj WB dhe EBRD. Plani i rimëkëmbjes Financiare të sektorit do të mbështetej plotësisht nga WB si me masa të buta, ligjore, rregullatore dhe organizative për ngritje kapacitetesh me komponentin 4 të saj me rreth 6.7 milion US\$, ashtu edhe me masa të forta, investime direkt në rrjetin e shpërndarjes rreth 88 milion US\$ dhe në rrjetin e transmetimit (nënstacionë dhe matje bilanci energjie) me rreth 25.3 milion US\$, si edhe investim financiar lidhur me sigurinë e furnizimit për shkak të paqëndrueshmërisë së motit dhe për pasojë luhatjeve të prodhimit të energjisë elektrike në KESH me 30 milion US\$, me një kredi afat-gjatë më terma shumë të buta prej 150 milion US\$ në total, e gjitha e garantuar me garanci sovraane nga ana e qeverisë përmes ministrisë përgjegjëse për financat. Kjo kredi u miratua nga parlamenti shqipëtar në shkurt të 2015 dhe sëbashku me paketën shoqëruese rregullatore të saj u bë akti i parë ligjor detyrues për zbatimin e reformës në sektorin elektro-energjitik në vend.

Gjithashtu, pjesë e rëndësishme e kësaj reforme ishte edhe nxjerrja nga kolapsi e KESH i cili kishte maturuar një nivel total borxhi prej rreth 74 miliard lekë, ku 36.5 miliard prej tij ishin overdraft (OD) me kushte shumë të pafavorëshme të linjëzuara me rreth 11 banka në 15 linja OD. Kosto mesatare e tyre në terma financiarë ishte rreth 5.1% në vit. Kosto e shërbimit të borxhit në KESH vetëm për OD ishte rreth 2.2 miliard leke (vetëm interesa dhe kamata për vonesë në ripërtëritje). Nga totali i OD 26.5 miliard lekë ishin të mbuluara me garanci sovraane. Në këto kushte u ndërmorën disa hapa:

- Rifinancimi i OD me mbulim me garanci sovraane me një kredi të butë afat-gjatë nga EBRD për një total prej 218 milion Euro, e ndarë në dy këste për disbursim, kësti i parë 100 milion Euro dhe kësti i dytë 118 milion Euro. Disbursimi i tyre ishte i lidhur me një aneks masash të përfshira në marrëveshje të cilat detyronin hapa reformues sidomos ekonomikë dhe financiarë për OSHEE dhe OST përveç KESH. KESH duhet të formatohej dhe të funksiononte si një korporatë ndërkombëtare me standard mjaft të larta të qeverisjes së korporatave (u miratua një CGAP - Corporate Governance Action Plan), zbatimi i të cilit duhej të fillonte menjëherë si kusht për levrimin e kështit të parë të kredisë. KESH dhe OSHEE duhej të transformonin në formën e një kredie afat-gjate detyrimet e vjetra të OSHEE ndaj KESH me të njëjtat kushte financiare dhe të shërbimit të kredisë si ajo mes EBRD dhe KESH. Datat e shlyerjes së kredisë së re nga OSHEE për KESH duhej të ishin të tilla që të garantojnë totalisht shërbimin e borxhit të EBRD. KESH duhej të përmirësonte tarifën e saj të shitjes së energjisë ndaj OSHEE në kuadrin e detyrimit për shërbimin publik për furnizimin e tregut të rregulluar. KESH do të

administronte në diskrecionin e tij të plotë rezervën energjitike në kaskadë. KESH duhet të vazhdojë investimet në programin e rehabilitimit dhe sigurisë së digave duke rritur kështu edhe eficiencën në përdorimin e rezervës ujore për prodhimin e energjisë elektrike. KESH dhe OSHEE do të shkëmbejnë tepricat e energjisë së prodhuar përtej sasisë së detyruara në kuadrin e detyrimit të shërbimit publik me çmim HUPX. Nga ana tjetër aneksë i reformës parashikonte si kushte për lëvrimin e kështit të dytë, kompletimin e të gjithë masave të reformës të parashikuara në Planin e Rimëkëmbjes Financiare të sektorit elektro-energjitik. Tashmë, këto kushte janë plotësuar dhe kredia e EBRD është totalisht e lëvruar. Situata ekonomiko-financiare e KESH është mjaft e konsoliduar dhe e shëndoshë dhe ajo është një korporatë bankable e cila vazhdon të marrë vlerësime pozitive nga audituesit ndërkombëtarë dhe vendës.

1.11.2 Investimet e kryera në sistem dhe nevojat për amendim të Planit të Rimëkëmbjes Financiare të Sektorit të Energjisë Elektrike

Zbatimi me forcë dhe rigorozitet i reformës së nisur në 2014 dhe i Planit të rimëkëmbjes financiare të sektorit elektro-energjitik, prodhoi përtej çdo pritëshmërie rezultate shumë të larta në çdo aspekt. U kompletua pothuajse i gjithë kuadri ligjor dhe rregullator brenda vitit 2017, u arritën targetet financiare, ekonomike dhe të performancës së sektorit, u sistemuan dhe u ul ndjeshëm borxhi dhe detyrimet e tjera të sektorit midis vetë operatorëve dhe ndaj palëve të treta, U ulën përtej targeteve dhe parashikimit humbjet në shpërndarje dhe arkëtimet korrente tejkaluan nivelet e parashikuara në plan, shpërndarja paguante 100% faturën korrente ndaj KESH dhe më shumë se 110% faturën korrente të OST duke zvogëluar kështu edhe detyrimet e prapambetura, u likujduan brenda Korrikut 2015 të gjitha faturat e prapambetura ndaj prodhuesve privatë të energjisë elektrike, u konsoliduan investimet në dyfishin e atyre të planifikuara pa kompromentuar situatën financiare të ndërmarrjeve, u rriten kapacitetet dhe aftësitë organizative dhe financiare duke i shndërruar të tre ndërmarrjet e mëdha publike të sistemit në promotorë të rritjes ekonomike në nivel kombëtar, u rrit përtej objektivave treguesi i sigurisë së furnizimit me energji elektrike të ekonomisë dhe konsumatorëve, u rrit në nivele rekord shpejtësia e reagimit ndaj difekteve në rrjet si dhe u përmirësua përtej çdo pritëshmërie efektiviteti dhe efienca në komunikim me konsumatorët dhe me publikun etj.

Në këto kushte, të arritjes lehtësisht tashmë të targeteve të vendosura në planin e 2014, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, vendosi të amendojë këtë plan dhe të hartojë dhe miratojë në janar 2019 Planin e Konsolidimit Financiar të Sektorit Publik të Energjisë Elektrike. Në këtë plan u vendosën disa piketa të rëndësishme.

Qëllimi i këtij Plani për Konsolidimin Financiar të Sektorit të Energjisë ishte që; i) të projektojë zhvillimin e ardhshëm të sektorit elektro-energjitik tashmë duke u bazuar në arritjet e fazës së parë të reformës 2014-2017, dhe ii) të propozojë një set të ri objektivash për rimëkëmbjen financiare të sektorit deri në vitin 2022. Plani bazohet në gjendjen financiare të audituar të shoqërive për vitin 2017 dhe supozimet dhe parashikimet

financiare respektive për periudhën 2018-2022 të përfshirë në Planet²⁴ 5-vjeçare të miratuara të Biznesit për çdo ndërmarrje publike në sektor, si edhe bazuar në një planifikim financiar të integruar të të gjithë sistemit si i tërë.

Vlerësimi evidenton ndikimin financiar të veprimeve të ndërmarra deri tani nga qeveria dhe rekomandon masa specifike që përfshijnë një kombinim të veprimeve të vazhdueshme dhe masave të një-hershme të kërkuara gjatë periudhës së mbuluar nga kjo plan.

Veprimet e ndërmarra nga Qeveria Shqiptare, të parashikuara në Planin e Rimëkëmbjes për periudhën 2015-2017, përmirësuan ndjeshëm likuiditetin, pozicionin financiar, borxhin bruto, përgjegjshmërinë dhe ndërgjegjësimin e klientit, cilësinë e shërbimit dhe reduktimin e humbjeve të rrjetit të shpërndarjes. Kjo u arrit me një bashkëpunim të fortë institucional, me përfshirjen e agjencive të zbatimit të ligjit dhe me mbështetjen e fortë politike dhe hapi rrugën drejt planit të propozuar e të rishikuar të sektorit financiar të paraqitur këtu²⁵.

Ndryshime të rëndësishme legjislative dhe rregullatore kanë ndodhur gjatë ekzekutimit të planit të rimëkëmbjes 2015-2018, me miratimin e Ligjit të ri 43/2015 për Sektorin e Energjisë Elektrike 2015, i cili nxiti transparencën dhe llogaridhënien e sektorit, ndarjen e aktiviteteve të OSHEE, ndarjen e llogarive, pavarësinë e rregullatorit, identifikimin dhe parashikimet e konsumatorëve në nevojë dhe liberalizimin e mëtejshëm të tregut.

Si pasojë, për të arritur këto objektiva strategjike, Qeveria propozoi:

- a) Kontrollin e kujdesshëm të të gjitha shpenzimeve të ardhshme kapitale për të kursyer paratë, për të garantuar investimet e kërkuara dhe për të garantuar shërbimin e borxhit të sistemit nga të gjithë operatorët publikë.
- b) Zbatimin e skemës së ristrukturimit financiar dhe fiskal në kompanitë e sektorit publik të sektorit të elektro-energjetik, duke reduktuar akoma më shumë detyrimet e prapambetura e duke mos krijuar detyrime të reja;
- c) Përmirësimin e një kornize rregullatore për promovimin e një metodologjie të shëndoshë për caktimin e tarifave për të përmbushur të ardhurat e kërkuara të aktiviteteve të transmetimit dhe shpërndarjes dhe promovimin e masave për liberalizimin e tregut, duke garantuar në të njëjtën kohë edhe pavarësinë e ERE si garant për mbarëvajtjen dhe organizimin pa konflikte të sistemit elektro-energjetik; dhe
- d) Përqendrimin në veprime specifike të konsolidimit financiar për të rritur performancën e kompanive të sektorit dhe për të përmirësuar likuiditetin e sektorit, për të reduktuar në mënyrë progresive kapitalin negativ në periudhën afatmesme si dhe për të zvogëluar ndikimin e përdorimit të tepruar të borxhit për të financuar aktivet shtesë (leva financiare), si edhe për të krijuar sa më shumë qëndrueshmëri të trendit të rritjes së kësaj performance në kuadrin edhe të zhvillimeve të reja të sektorit.

²⁴ Bazuar në Statutin e Shoqërive, Bordet Mbikëqyrëse dhe Mbledhja e Aksionarëve janë përgjegjëse për miratimin e Planit të Biznesit të Shoqërive dhe rishikimet e tyre.

²⁵ Plani i Konsolidimit Financiar të Sektorit të Energjisë Elektrike, 2019.

Përveç kësaj, për të përcaktuar objektivat thelbësore që duhet të merren si prioritet për shoqëritë publike, qeveria gjithashtu propozoi:

- f. Të inkurajojë drejtuesit e OSHEE-së përmes një kontrate menaxhimi të bazuar në rezultate të përshkruara dhe parashikuar në kuadër të Projektit të Konsolidimit Financiar të Sektorit të Energjisë të Bankës Botërore për të siguruar që kostot, Konsolidimi Financiar dhe Objektivat e mbledhjes se të ardhurave, të monitorohen duke siguruar që të gjitha keto, janë çelësi i suksesit të Planit të Konsolidimit;
- g. Të zbatojë dhe finalizojë procesin e ndarjes së aktiviteteve të OSHEE deri në fund të vitit 2019, në përputhje me Direktivat e BE dhe të Sekretariatit të Energjisë;
- h. Të sigurojë financimin e investimit nga një palë e tretë ose të kërkojë ngritjen nga një palë e tretë të investimeve kapitale, sipas planit 5 vjeçar duke konsideruar faktin se investimi është i nevojshëm dhe mund të financohet pa penguar funksionimin normal të rrjetit;
- i. Të përgatisë OSHEE-në e ristrukturuar për pjesëmarrjen e kapitalit privat kur, të jetë vendosur situata e shëndoshë financiare, të jenë strukturuar dhe zgjidhur problemet e mbartura në pasqyrat financiare dhe të jetë krijuar një bazë të dhënash për operacione efikase dhe transparente në këtë shoqëri;
- j. Të sigurojë përmirësimin e vazhdueshëm dhe zbatimin e qeverisjes korporative dhe performancës menaxheriale, me anë të:
 - Rritjes së kompetencave të Këshillit Mbikëqyrës në përputhje me statutet në fuqi,
 - Futjes së drejtorëve të pavarur jo ekzekutivë për forcimin e Këshillit Mbikëqyrës dhe formulimin e politikave dhe monitorimin e performancës së menaxhimit, veçanërisht në fushat teknike dhe financiare; dhe
 - Zbatimit të llogaridhënies dhe transparencës së operacioneve financiare,
 - Miratimit të praktikave tregtare (p.sh. efikasiteti dhe efektiviteti të investimeve) brenda kriteve të kuadrit rregullator ekzistues;
 - Rritjes së ndërgjegjësimit publik/privat,
- k. Të prezantojë dhe vendosë tregun e energjisë të ditës në avancë të organizuar dhe të balancuar;
- l. Të promovojë liberalizimin e tregut me anë të krijimit të kushteve që konsumatorët të ndërrojnë shoqëritë shërbim-ofruese, duke thelluar derregullimin me target daljen në treg të parregulluar të të gjithë konsumatorëve të lidhur në rrjet në tension të lartë 35 KV dhe të mesëm 20/10/6 KV,
- m. Vendosjes së metodologjisë së tarifave që reflekton rimëkëmbjen e plotë të kostove të shërbimit për prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen,
- n. Identifikimin e alternativave të qeverisë për mbështetjen e kategorive vulnerabël (shtresave në nevojë) ndaj impaktit të tarifave,
- o. Marrjes së masave të përshtatshme për zbutjen e riskut për zbutjen e ngjarjeve ekstreme të klimës.

- p. Plotësimin përfundimtar të procesit të reformimit të sektorit elektro-energjitik në përputhje me kërkesat e Traktatit të Enenergjisë dhe të direktivës europiane bashkë me ndryshimet e pësuara prej saj në kohë

Për të arritur këtë në një mënyrë të hapur dhe konkurruese në përputhje me direktivat e BE-së, Qeveria planifikoi të zbatojë modelin e tregut dhe rregullat e saj shoqëruese gjatë tre viteve të ardhshme, 2020-2022. Megjithatë, shtrirja dhe shkalla e fazës së fundit të liberalizimit ka të ngjarë të ndikojë dukshëm në OSHEE dhe familjet, si pjesë e tregut të rregulluar. Për këtë, qeveria propozoi të ndërmarrë një vlerësim të pavarur të ndikimit financiar, ekonomik dhe politik të procesit, duke marrë parasysh rikuperimin e kostove të konsiderueshme të bllokuara në sektorin rezidencial, si dhe mundësinë afatshkurtër dhe afatmesme të familjeve për të paguar tarifat. Objektivi afat-gjatë i qeverisë mbeti akoma mbështetja e konsumatorëve familiar dhe ekonomisë kombëtare me mosrritje të tarifave të energjisë në konsumatorin fundor.

Kombinimi i këtyre masave financiare, të shoqërive dhe të tregut do të: a) shërbejë si parandalim, në mënyrë që sistemi elektro-energjetik të mos përbëjë rrezik fiskal serioz dhe të sigurojë që të bëhet i vetë-qëndrueshëm përtej vitit 2020; ii) të tërheqë investimet e sektorit privat në sektorin e energjisë elektrike në një mjedis konkurrues, efikas dhe të favorshëm; dhe iii) të rrisë sigurinë e rrjetit dhe furnizimin me energji elektrike nëpërmjet përdorimit të burimeve alternative të prodhimit të energjisë, p.sh. gaz natyror ose burime të tjera të energjisë siç përcaktohet në Strategjinë Kombëtare të Energjisë 2018-2030.

1.12. Situata dhe zbatimi i reformës në vendet e Ballkanit Perëndimor

Sa i takon vendeve të rajonit, të cilat janë ashtu si edhe Shqipëria palë kontraktore të Komunitetit European të Energjisë, por si edhe Shqipëria me të drejta të plota dhe anëtare me të drejtë vote të Këshillit të Ministrave të Komunitetit të Energjisë, situata lidhur me zbatimin e reformës në sektorin e energjisë dhe e implementimit të saj në vendet respective është e ndryshme. Të ndryshme janë edhe objektivat e implementimit. Ato e kane nisur atë në momente të ndryshme dhe progresi i tyre vlerësohet pikërisht mbi këto targete. Siç edhe kam trajtuar në këtë studim, afati i transpozimit në legjislacionin kombëtar dhe në kuadrin rregullator të sektorit të energjisë elektrike ka qenë Dhjetor 2020. Tashmë të gjithë vendet e EnC janë duke levizur në drejtim të Paketës për Energjinë e Pastër. Ato janë të gjitha të angazhuara në hartimin e NECP - National Energy and Climate Plans (Planeve Kombëtare të Energjisë dhe Klimës), ku, bazuar në Politikat e Reja Udhëheqëse në fuqi në EnC dhe BE, objektivi kryesor është të Transiti Energy, kalimi drejt investimeve për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme dhe të pastra, me zero emission karboni. Duke përjashtuar Shqipërinë, të gjitha vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor prodhojnë energji nga burime me bazë karboni, qymyr ose fosile të lëngëshme. Në këtë aspekt detyrimet e tyre për reduktimin e ndotjes nga karboni dhe gazrat serë janë shumë ambicioze. Aktualisht, Shqipëria prodhon vetëm energji të pastër dhe është duke vazhduar të mbështesë rritjen e kapaciteteve gjeneruese bazuar gjithnjë në burime të pastra - hidro, diell dhe erë. Kjo theksohet edhe në rëportin e zbatimit të paketës për 2020 (Implementation Report 2020) të Sekretariatit të EnC ku citohet "Edhe pse pa targete të reja për të energjitë e rinovueshme, zhvillimi i energjisë së gjelbërt është rritur në shumë palë kontraktore. Duke ilustruar këtë prirje positive, disa palë kontraktore si Shqipëria,

Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi ia dolën që të arrijnë rezultate të dukëshme duke tenderuar skemat e tyre mbështetëse, ose edhe duke vepruar pa skema mbështetëse.²⁶ Duhet të përmendim, gjithashtu, se jo të gjithë vendet e Ballkanit Perëndimor kanë të njëjtat burime natyrore për të mbështetur një zhvillim dhe politikë të tilla. Shqipëria ka një balancim të natyrshëm të burimeve të rinovueshme për t'u mbështetur midis ujit, diellit dhe erës. Për këtë arsye edhe targeted janë shumë më ambicioze në krahasim me Maqedoninë e Veriut, apo Serbinë. Ndërkaq, Mali i Zi dhe Bosnia e Hercegovina kanë avantazh më shumë në burimet hidrike.

Edhe lidhur me aspektet e hapjes së tregut dhe kompletimit të reformës bazuar në Paketën e Tretë të Energjisë, angazhimet dhe progresi i vendeve është i ndryshëm. Disa vende kanë hyrë në këtë proces më vonë se të tjerat. Shqipëria e ka nisur procesin në vitin 2015 dhe tashmë është në fundin e tij në pjesën që lidhet me energjinë elektrike. Mbetet akoma për t'u kompletuar pjesa që lidhet me sektorin e hidrokarbureve ku progresi ka ecur disi ngadale këto tre vitet e fundit, duke ulur edhe rezultatet e progresit të përgjithshëm. Në 2020, edhe pse një vit i ndikuar shumë nga pandemia e Covid-19, progresi i Shqipërisë ka qenë pozitiv dhe premt për mbyllje të plotë të reformës brenda vitit 2022. Rezultatet e zbatimit të reformës për Shqipërinë në 2020 kanë qenë 58%, më një rritje të rëndësishme krahasuar me 2019 (50%) prej 8%. Të gjithë vendet e rajonit në progresin e tyre paraqiten si në grafikun e mëposhtëm²⁷.


Nga vendet e rajonit, dallojnë për regres në reforma Mali i Zi dhe Serbia. Ndërkaq, Shqipëria dhe Kosova kanë përmirësimin më të lartë në krahasim me 2019. Megjithatë, e theksoj se ky progress matet mbi planet dhe programet e reformave të secilit vend në mënyrë specifike. Vendi që është më pas se të gjithë të tjerët është Bosnja dhe Hercegovina e cila i ka filluar reformat shumë më vonë se të tjerët, duke patur një ndërprerje dhe ngrirje të gjatë prej disa vitesh të marëdhënieve me EnC, duke rinisur me procesin vetëm në 2018.

Kanë themeluar tregun e ditës në avancë Shqipëria, Serbia, Maqedonia dhe Mali i Zi. Nga këto, të gjitha janë në fazën e testit të thatë, pra pa energji për tregim, kurse Shqipëria është në fazën e kontraktimit të service providerit.

²⁶ Implementation Report 2020, Energy Community, 2021

²⁷ Implementation Report 2020, Energy Community, 2021

Figura 4: Palët kontraktore në rajon dhe ALPEX



Volumet e para në ALPEX do të lëvrohen në Janar 2022. ALPEX pritet të jetë dhe bursa më e rëndësishme e këtij rajoni, pasi përfshin zyrtarisht dy tregje, Shqipërinë edhe Kosoven, të cilat, pas marrjes së statusit të zonës së pavarur rregulluese të Kosovës në Qershor 2020, janë tashmë një zonë ofertuese energjie elektrike (bidding zone). Në të ardhën, hapja dhe zgjerimi i këtyre tregjeve drejt një integrimi të gjërë të të gjithë vendeve të Ballkanit Perëndimor, do të mundësojë një treg energjie elektrike më fluid, me më shumë volume energjie, me konkurrencë më të lartë dhe me mundësi më të mëdha për secilin prej tyre për të rritur sigurinë e furnizimit me energji elektrike dhe për të patur kosto më të ulëta të saj për ekonomitë e tyre.

KAPITULLI I DYTË

Rishikimi i literaturës, modeli i tregut dhe diskutime rreth ndërtimit dhe funksionimit të tij

2.1 Vështrim kritik i literaturës

Literatura që do të përdoret për të krijuar konceptin teorik kërkimor gjatë këtij studimi do të bazohet në studime, udhëzime dhe analiza të publikuara nga institucione ndërkombëtare si: Banka Botërore, Komiteti Energjitik në Vienë, faqet zyrtare të tyre të internetit, artikuj shkencorë të bërë në fushën e zhvillimit të tregut energjitik në Shqipëri dhe Rajon, Ministrinë përkatëse dhe entet përkatëse si ERE, OST etj. Njëkohësisht literatura do të përfshijë edhe legjislacionet në fuqi në Shqipëri dhe në vende të zhvilluara, të cilat kanë përjasje dhe propozime kundrejt modelimit të tregut energjitik në vendin tonë.

Tregu i energjisë elektrike ka një sjellje specifike krahasuar me tregjet e mallrave dhe shërbimeve të tjera. Ai kufizohet dhe rregullohet në nivele dhe dimensione të ndryshme të tij. Edhe pse mall, energjia elektrike shpesh perceptohet si një e mirë publike. Kjo sanksionohet nëpërmjet treguesit të sigurisë së furnizimit, çka nënkupton se të gjithë përdoruesit fundor duhet të kenë akses në të, të gjithë prodhuesit e liçensuar duhet të kenë akses të garantuar në rrjet, pavarësisht se për këtë akses ata paguajnë tarifa aksesit dhe përdorimi të rrjeteve, të gjithë aktorët e tjerë të rrjetit të liçensuar për veprimtarinë e tyre në këtë treg duhet të garantohen për të drejtën e tyre të aksesit të barabartë në rrjete. Kur ka mungesë kapacitetesh të mjaftueshme, funksionon parimi në drejta i jepet të parit që paraqitet. Në këtë kuadër, pavarësisht detyrimit të shërbimit publik ndaj aktorëve të ndryshëm në këtë treg, çdo gjë rregullohet në mënyrë detyruese dhe garantohet nga entet rregullatore nacionale dhe nga ACER.

Dy dokumentet kryesore që shërbejnë si referencë për kuadrin rregullator të sistemit dhe që janë edhe detyruese për trupëzim në kuadret ligjore lokale, bazuar edhe në aderimin e vendeve në komunitetet respektive, EnC dhe IEC, janë Traktati i Energjisë dhe Karta Ndërkombëtare e Energjisë. Mbi bazën e tyre ose duke iu referuar këtyre dokumenteve dhe gjithnjë në linjë me to dalin të gjitha paketat ligjore dhe rregullatore për menaxhimin e tregjeve të energjisë në hapësirën europiane (vendet e EnC) dhe atë ndërkombëtare (IEC - International Energy Charter).

Nga këndvështrimi menaxherial, gjithashtu, tregjet e energjisë elektrike kane specifikat e tyre. Nga aspekti tregëtar mund të dallojmë në një sistem elektro-energjitik tregun e energjisë si e tillë, tregun e shërbimeve shoqëruese dhe tregun e transmetimit²⁸. I pari, është në mjaft raste i rregulluar ose i liberalizuar up-to-down stream, ose në pjesë të zinxhrit të vlerës së tij, gjenerim, transmetim, shpërndarje dhe furnizim. Mbi bazën e tyre janë të segmentuar edhe aktorët në këto segmente. Sa i takon shërbimeve mbështetëse, i referohemi aksesit në rrjet nga përdoruesit fundorë, shërbimet sekondare dhe terciare që kanë të bëjnë me sigurinë e furnizimit, ku futet edhe tregu i balancimit dhe ofrohen në të dy nivelet, transmetim dhe shpërndarje. Këto shërbime paguhen veçmas. Nëse rrjetat janë

²⁸ M. Shahidepour, H. Yamin and Z. Li, Market operations in electric power systems - Forecasting, scheduling and risk-management, 2002, pp. 9

të monopolizuara nga shteti, këto shërbime kanë treg shumë të rregulluar dhe janë gjithnjë subjekt i miratimit nga rregullatori. Ndërkaq, tregu i transmetimit paraprin tregun e energjisë dhe lidhet me shitjen dhe tregëtimin e kapaciteteve të transmetimit pa të cilat nuk mund të lëvrohet energjia. Është i ngjashëm me tregun e transportit të mallarave. Shpesh linjat e transmetimit konsiderohen si korridore të transportit të energjisë. Ato mund të tregëtohen në treg të lirë ose nëpërmjet platformave rajonale, ose individualisht përmes platformave individuale të çdo operatori transmetimi. Shqipëria i tregëton kapacitetet e saj transmetuese përmes CAO SEE në Podgoricë. KESH ka akses pa limit në përdorimin e rrjetit të transmetimit për shkak të pozicionit që ka si zbatues kryesor i detyrimit të shërbimit publik.

Në tregun e energjisë, që është edhe themelori i sistemit dallojmë sic përmenda më lart tregje të rregulluara, ku çdo gjë përcaktohet nga rregullatori nëpërmjet një procesi transparent dhe çmimi i energjisë elektrike përcaktohet sipas një metodologjie të propozuar nga qeveria dhe të miratuar prej saj me ligj ose VKM. Kryesisht këto metodologji bazohen në të ardhurat e kërkuara për mbulimin e kostove të domosdoshme për furnizimin e energjisë tek përdoruesi fundor. Ose, tregjet mund të jenë të derregulluara, ku rregullatori përcakton dhe vërojt për barazi dhe akses të lirë në energji, por nuk përcakton çmimin e saj në fundor. Tek kjo e dyta dallojmë tregjet e ditës në avancë (modeli i ri i tregut të energjisë elektrike në Shqipëri sipas ligjit 43/15). Në këtë model çmimet e energjisë bazohen në një algoritëm ditor që regjistron kuotimet orare (tashmë çdo 15 minuta) të energjisë elektrike qysh një ditë përpara për ditën e nesërme dhe çmimi i vendosur në fund të ditës është edhe çmimi i ditës së nesërme. Dallojmë gjithashtu edhe tregjet reale (Real Time Market), ose tregjet e balancimit të cilët bëjnë krahasimin e energjisë së prodhuar realisht me programimin e saj të një dite më parë. Diferencat pozitive ose negative, shpesh ose në më të shumtën e rasteve me marxh shumë të lartë gabimi në parashikim kuotohen në çast dhe kostot janë shumë të parashikueshme.

Me rëndësi në të dy rastet është përcaktimi profileve bazë të ngarkesës si për ofertuesit ashtu edhe për përdoruesit fundorë. Element shumë i rëndësishëm për funksionimin e këtyre tregjeve është edhe zbatimi i drejtë i kodit të matjes duke përcaktuar qartë pikën e aksesit në rrjete. Ajo që plotëson krejt panoramën në programi është parashikimi i sasive dhe garantimi kapaciteteve, në afta të shkurtër dhe në afat të gjatë. Për të gjithë operatorët në treg, ekziston mundësia e optimizimit ose e korrektimit edhe përmes palëve të treta duke shfrytëzuar kështu rezervat energjitike të pahedhura në treg.

Siç edhe shihet nga spjegimi drejtimi i një sipërmarrje biznesi në secilin prej niveleve dhe tregjeve brenda sistemit up-todown stream është i ndryshëm nga ajo që mund të arrihet në tregjet e mallrave të zakonshëm. Ai kalon përmes rregullimeve dhe kufizimeve të ndryshme të cilat shpesh janë të kushtëzuara edhe nga protokollet e vendosura me operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes. Pjesa më e lehtë për t'u menaxhuar dhe privatizuar në këtë zinxhir është gjenerimi. Më pas vjen ndërmjetësimi dhe tregëtimi i energjisë dhe në fund vjen furnizimi ose retail i energjisë elektrike i cili ka në focus direkt marrëdhënien me përdoruesin fundor. Në vendin tonë është krejtësisht i derregulluar niveli i gjenerimit dhe tregëtimi me shumicë i energjisë elektrike. Ndërsa furnizimi është rreth 80% i rregulluar. Për këtë arsye është e nevojshme të vazhdojë reforma në sektorin e energjisë elektrike dhe kompletimi i saj për të garantuar një treg energjie të hapur në të gjithë gjatësinë e zinxhirit të vlerës, duke mbajtur si të mirë publike vetëm sigurinë e furnizimit dhe jo energjinë vetë si produkt apo mall.

2.1.1 Legjislacioni i ri që rregullon sektorin e energjisë elektrike

Reforma kishte si pjesë mjaft të rëndësishme të sajën edhe përgatitjen dhe plotësimi e kuadrit ligjor rregullator të sistemit elektro-energjitik. Elementë të rëndësishëm që u plotësuan në kuadrin e saj janë:

- i. Ligji bazë i sektorit të energjisë elektrike i miratuar në Shkur 2015, ligji 43/15, i amenduar së fundmi për t'iu sjellë plotësisht i përafuar me direktivat europiane për energjinë në maj 2020.
- ii. Ligji Për nxitjen e prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme, Ligji. Nr. 7/2017. Ky ligj është hartuar bazuar në ligjin e mëparshëm të miratuar në vitin 2013, por që nuk gjeti asnjëherë zbatim. Tashmë ai është në listën e ligjeve për t'iu amenduar në kuadrin e ndryshimeve në legjislacionin europian të ndodhura pas viti 2017.
- iii. Ligji për performancën e energjisë në ndërtesa 116/2016 i cili promovon dhe stimulon rritjen e eficiencës në konsumin e energjisë, veçanërisht në ndërtesa.
- iv. Vendime qeverie dhe të tjera akte të cilat plotësojnë dhe bëjnë të zbatueshme kudrin ligjor dhe rregullator në lidhje me funksionimin, detyrimet e palevë, të drejtat dhe rolin e rregullatorit, krijimin e modelit të ri të tregut të energjisë elektrike dhe të themelimit të bursës së energjisë si instrument i vetëm për zbatimin e këtij modeli, derregullimin e tregut up-to-down stream, përfundimin e procesit të unbundling të shpërndarjes duke garantuar pavarësinë e plotë të operatorit të sistemit të shpërndarjes, nxitjen e investimeve në burime të reja dhe diversifikimin e prodhimit të energjisë etj.

2.1.1.1 Ligji bazë i sektorit të energjisë elektrike

Ky ligj u hartua me asistencë teknike nga USAID nga ana e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë. Ai është rregullatori bazë i gjithë sektorit për të gjithë nivelet dhe funksionet e tij. Ai parashikon detyrime lidhur me organizimin e prodhimit të energjisë elektrike në vend duke përcaktuar edhe format e mundshme të mbështetjes shtetërore për këtë nivel të zinxhirit të vlerës së sektorit. Ai përcakton si totalisht të liberalizuar prodhimin e energjisë elektrike në vend dhe përcakton gjithashtu detyrimin e qeverisë për përcaktimin e të gjitha rregullave të cilat bëjnë të mundur nxitjen dhe mbështetjen administrative të krijimit të burimeve të reja të energjisë. I përcakton procedurat e përgjithëshme të licensimit për krijimin e burimeve të reja me ose pa mbështetje dhe incentivim shtetëror. Ai garanton gjithashtu barazinë e të gjithë prodhuesve para ligjit bazuar në marrëveshjet e firmosura mes palëve.

Një vend të veçantë në ligj ze pjesa e transmetimit, i cili është krejtësisht i pavarur nga prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike. Ai detyron që pavarësia të garantohet edhe përmes mekanizimit të pronësise. Ligji garanton të drejta dhe kompetenca për operatorin e sistemit të transmetimit lidhur me organizimin dhe zhvillimin e tregut me shumicë të energjisë elektrike në vend. Ky ligj përcakton edhe modelin e ri të tregut të energjisë elektrike në vend për të cilin duhet të dalin akte të veçanta nën ligjore që e bëjnë të mundur zbatimin e tij. Operatori i sistemit të transmetimit është përgjegjës për themelimin e bursës Shqiptare të energjisë, ose sic quhet në ligj, tregu i ditës në avancë. Në të përcaktohen edhe

pikat kryesore se si duhet të organizohen ndërmarrjet ose operatorët e mëdha të sektorit të energjisë elektrike, si edhe detyrimet që ato kanë për të garantuar si një funksionim efektiv dhe eficient të tyre ashtu edhe ndaj palëve të treta në treg, duke iu garantuar atyre barazi në operimi dhe po kështu detyrime dhe rregulla bazë për t'u respektuar të cilat garantojnë mos cënimin e sigurisë së furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve dhe klientëve në cdo nivel.

Një pjesë e rëndësishme e ligjit është organizimi i sektorit të shpërndarjes. Në ligj përcaktohet detyrimi për derregullimin dhe liberalizimin e tregut, ndarjen e shpërndarjes nga furnizimi dhe sigurimin e garantuar të konsumatorëve për të pasur akses të plotë në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike. Ligji përcakton se operatori i shpërndarjes duhet të drejtohet me profesionalizëm, kompetencë dhe integritet të lartë për vetë rëndësinë që kjo hallkë ka në sistem dhe si hallka që garanton likuiditetin e plotë të të gjithë sistemit për vetë pozicionin monopol që ka në furnizimin e tregut me energji elektrike. Ligji ka të përcaktuara qartë edhe afatet lidhur me përfundimin e procesit të ndarjes së shpërndarjes si edhe liberalizimin e tregut fundor të konsumit.

Pjesë e rëndësishme në ligj është edhe organizimi i shërbimeve të balancimit të tregut. Operatori përgjegjës për këtë rregullim është operatori i transmetimit, ndërsa detyrimi për të respektuar rregullat e balancimit qëndron për të gjithë operatorët e tregut pa përjashtim. Pjesë e rëndësishme e këtij ligji është siguria e furnizimit me energji elektrike e cila duhet të jetë e garantuar si për konsumatorët në treg të rregulluar ashtu edhe për ata në treg të lirë. Për këtë qëllim ligji ka parashikuar si operator furnizues të mundësisë së fundit FSHU. Ndërkaq, ligji përcakton të gjithë subjektet në treg si subjekt i detyrimit të shërbimit civil. Efektet e këtij detyrimi rregullohen me akte nënligjore.

Pjesë e rëndësishme e ligjit është edhe pjesa që rregullon veprimtarinë e rregullatorit, ERE. Në të përcaktohen ëartë procedurat e përzgjedhjes së komisionerëve, të kryetarit të enetit rregullator dhe të krijimit të funksionimit të përgjithshëm të këtij institucioni. ERE përcaktohet si institucioni më i rëndësishëm i sektorit të energjisë. Drejtuesi i saj zgjidhet nga parlamenti. Ligji, neni 11.1 i tij, garanton pavarësi të plotë të ERE nga të gjithë institucionet e tjera publike ose jo.

ERE ushtron aktivitetin e saj me qëllim garantimin e përmbushjes së detyrimeve të pjestarëve të tregut për furnizimin me energji, me cilësi dhe me kosto sa më të ulët të klientëve. ERE, duke marrë në konsideratë interesat dhe të drejtat e klientëve, sigurinë dhe cilësinë e shërbimit të furnizimit me energji elektrike dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit, kryen licencimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në sektor, monitoron tregun e energjisë elektrike, harton kuadrin rregullator, shqyrton në përputhje me metodologjitë respektive aplikimet e tarifave dhe çmimeve, e nëpërmjet autoritetit vendimmarrës të saj, dhe në zbatim të ligjit, vepron rast pas rasti duke e shprehur vullnetin nëpërmjet vendimeve të Bordit.²⁹

2.1.1.2 Ligji për energjitë e rinovueshme

Ky ligj vjen në mbështetje të ligjit 43/15 dhe synon të mbështesë veçanërisht krijimin e burimeve të energjisë mbështetur në burime të rinovueshme si uji, era, dielli, gjeotermia, energjia blu etj. Në të përcaktohen procedurat e licencimit, të lidhjes së kontratës, të përzgjedhjes së fituesve për ndërtimin e gjeneratorëve të energjisë së rinovueshme, të drejta

²⁹ Raporti vjetor 2019, ERE, pp 24

dhe detyrime të tyre në raport me tregun e energjisë elektrike. Ky ligj siguron mbështetje të këtyre prodhuesve bazuar në kapacitetet prodhuese, duke i ndarë në të vegjel ose jo, duke përdorur si limit fuqinë e instaluar nën 2 MW për ujë dhe diell dhe nën 3 MW për erën. Këto burime janë të incentivuara me ligj deri në 2020 me tarifa feed-in (favorizuese). Ndërkaq ligji përcakton se për burimet e reja që do të ndërtohen pas hyrjes në fuqi të ligjit, jo prodhues të vegjël, forma e mbështetjes do të jetë më garë për të fituar mbështetje me kontratë për diferencë. Ligji është në proces amendimi. Rregullimet e reja që pritet të sjellë janë: një qartësim i procedurave të mbështetjes duke i bërë ato konkruese, përcaktime për vetë prodhuesit, përcaktime për kontratën për diferencë dhe mbështetjen shtetërore për nxitjen e këtyre burimeve (përcaktimi për operatorin e energjisë së rinovueshme) etj.

2.1.1.3 Ligji për eficiencën e ndërtesave në konsum energjie

Ky ligj është plotësisht në linjë me direktivën eurpoianë për dekarbonizimi dhe për kursimin e energjisë elektrike duke bërë të mundur rritjen e eficiencës në përdorimin e saj, sidomos në ndërtesa dhe konsum të brendëshëm. Ai përcakton ngritjen e agjencisë së eficiencës së energjisë dhe detyrimin e saj për certifikimin e audituesve të energjisë dhe auditimin e të gjithë ndërtesave të reja, si edhe të atyre që rikonstruktohen në më shumë se 25% të volumit të tyre. Target i vendosur në ligj për kursimin e energjisë është 15.5% deri në vitin 2030. Në të është përcaktuar se do të rikonstruktohen në kushte efience në konsumin e energjisë elektrike rreth 2% e ndërtesave publike çdo vit.

2.2. Dokumente të rëndësishme të fazës së dytë të reformës

Një nga dokumentet bazë udhëheqës të reformës është edhe plani i konsolidimit financiar të sektorit bulik të energjisë elektrike. Ky plan bazohet në një analizë të gjërë të fazës së parë të kësaj reforme, 2015-2017. Analiza e kësaj faze bëri të mundur të verifikohet se Plan i Rimëkëmbjes Financiare të sistemit nuk ishte më adekuat dhe nuk nxiste apo impononte ritme të larta të avancimit të reformës.

Qëllimi i këtij Plan për Konsolidimin Financiar të Sektorit të Energjisë është të i) japë një vështrim të përgjithshëm të përditësuar të gjendjes financiare të Sektorit të Energjisë në Shqipëri dhe të mësimave të nxjerra, duke marrë në konsideratë rezultatet faktike për periudhën 2015-2017; dhe ii) të propozojë një plan për rimëkëmbjen financiare për 5 vitet e ardhshme si dhe planin e veprimit të tij. Plan bazohet në gjendjen financiare të audituar të shoqërive për vitin 2017 dhe supozimet dhe parashikimet financiare respektive për periudhën 2018-2022 të përfshirë në Planet³⁰ e miratuara të Biznesit.

Të ardhurat e realizuara në vitet 2015 dhe 2016 treguan që sistemi është akoma i brishtë, pasi ato nuk siguruan trend të qëndrueshëm për 2017 e më pas. U vunë re se meritat kryesore të suksesit lidheshin me masat e forta shtrënguese të qeverisë si edhe në disa aksione financiare pastruese të llogarive të vjetra të ministrisë së financave se sa për shkak të performancës së rritur të vetë sistemit.

Veprimet e ndërmarra nga Qeveria Shqiptare, të parashikuara në Planin e Rimëkëmbjes për periudhën 2015-2017, përmirësuan ndjeshëm likuiditetin, pozicionin financiar, borxhin

³⁰ Bazuar në Statutin e Shoqërive, Bordet Mbikëqyrëse dhe Mbledhja e Aksionarëve janë përgjegjëse për miratimin e Planit të Biznesit të Shoqërive dhe rishikimet e tyre.

bruto, përgjegjshmërinë dhe ndërgjegjësimin e klientit, cilësinë e shërbimit dhe reduktimin e humbjeve të rrjetit të shpërndarjes. Kjo u arrit me një bashkëpunim të fortë institucional, me përfshirjen e agjencive të zbatimit të ligjit dhe me mbështetjen e fortë politike dhe hapi rrugën drejt planit të propozuar e të rishikuar të sektorit financiar të paraqitur këtu.

Ndryshime të rëndësishme legjislative dhe rregullatore ndodhën gjatë ekzekutimit të planit të rimëkëmbjes 2015-2018, me miratimin e Ligjit të ri 43/2015 për Sektorin e Energjisë Elektrike 2015, i cili nxiti transparencën dhe llogaridhënien e sektorit, ndarjen e aktiviteteve të OSHEE, ndarjen e llogarive, pavarësinë e rregullatorit, identifikimin dhe parashikimet e konsumatorëve në nevojë dhe liberalizimin e mëtejshëm të tregut.

Reforma kishte për qëllim reduktimin e humbjeve të energjisë, ristrukturimin e pasqyrave financiare të sektorit, liberalizimin e konsumatorëve të kualifikuar deri në nivelin e mesëm të tensionit (35 KV, 20/10/6 KV), dhe *mbajtjen e tarifave për familjet sa më të perballueshme që të jetë e mundur*. Kjo kërkon dhe përfshin:

- Amendimin dhe zbatimin e Ligjit të ri për Energjinë në vitin 2015, duke e sjellë atë në përputhje me direktivë europiane të energjisë të ndryshuar në shkurt 2019 lidhur me respektimin e mjedisit dhe komuniteteve lokale dhe procesin e dekarbinizimit;
- Ndarjen o operatorit të shëprndarjes nga furnizimi dhe për pasojë përfundimin e procesit të unbundling të OSHEE brenda Dhjetorit 2019;
- Zbatimin e një programi për reduktimin e humbjeve dhe asistencës teknike të menaxhimit në kuadër të programit të rimëkëmbjes së sektorit të energjisë nga Banka Botërore;
- Rifinancimin e overdrafteve të sektorit (KESH-it) me mbështetjen e financimit afatgjatë të BERZH-it me kushte të buta;
- Përmirësimin e “*gatishmërisë për të paguar*” dhe arkëtimeve cash nëpërmjet faturimit të drejtë, shërbimit më të mirë për klientët, stimujve, fushatave të ndërgjegjësimit të sponsorizuara nga shteti, kompensimeve ndërmjet kompanive të pagesave të prapambetura, dhe zbatimit rigoroz të rregullave ekzistuese;
- Ristrukturimin financiar të borxhit të sektorit për të reduktuar kostot e shërbimit të borxhit dhe presionin që rezulton në ngritjen e tarifave të rregulluara; dhe
- Rishikimin dhe zbatimin e një shkëmbimi të brendshëm të energjisë përtej volumeve të kontraktuar në respekt të detyrimit për shërbimin publik me kushte tregu.

Pavarësisht ketyre masave, presione fiskale janë shfaqur, sidomos gjatë periudhave të mungesës të rreshjeve të përsëriura në vitin 2012 dhe 2017, kur qeverisë iu desh të ndërhynte për të mbështetur shoqërinë e prodhimit të energjisë elektrike KESH me ofrimin e garancive financiare për importet, tolerancën për tatimet dhe shërbimin e borxhit të prapambetur.

Dokument tjetër i rëndësishëm, i vlerësuar me rëndësi strategjike është dhe Plani strategjik i masave për reformimin e sektorit të energjisë, i hartuar me ndihmë në KfW dhe qeverisë gjermane dhe i miratuar me vkm nr 742, dt 12.12.2018. Ku plan përcaktonte një proces realizimi të 18 komponentëve për kompletimin e reformës në sektorin e energjisë elektrike, duke e lidhur atë si kusht themelor për mbështetjen nga qeveria gjermane të buxhetit të shtetit me një financim të butë afat-gjatë prej 250 milion Euro në bashkëpunim edhe me AFD (homologia franceze e KfW).

Plani strategjik paraqet një reformë të gjerë për sektorin e energjisë. Reforma shënjestron kanale të shumëfishta, si: strukturore, operationale dhe financiare. Për më tepër, duhet të theksohet se plani strategjik shqyrton dhe zbaton angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë, veçanërisht në lidhje me procesin e anëtarësimit në Komunitetin e Energjisë dhe në BE.

Si e tillë, reforma e sugjeruar e përfshirë në planin strategjik përfshin një listë gjithëpërfshirëse të masave (PRE). Zbatimi këtyre reformave, duhet të krijojë një treg të organizuar në modelin e BE-së, i cili udhëhiqet nga parimet e të qenit transparent, jodiskriminues dhe i qëndrueshëm në një periudhë të gjatë, bazuar në formimin e çmimit të lirë përmes konkurrencës. Përpjekjet kyçe që përmban kjo reformë mund të përmbledhen gjerësisht si: Ndarja vertikalisht e kompanisë së integruar të shpërndarjes OSHEE, qasja transparente dhe jodiskriminuese (dhe tarifat) për sistemet e transmetimit dhe shpërndarjes, një rregullator i fortë i pavarur, çmime të vendosura në mënyrë të pavarur, konkurruese dhe transparente, si dhe skemave të mbështetjes për kategori vulnerabel të drejta, transparente, jodiskriminuese dhe minimale në mbështetje të tregut për klientët në nevojë të shoqërive dhe për prodhuesit e energjisë së rinovueshme.

Përfitimet e reformës së propozuar mund të përmbledhen si krijimi i një tregu që prodhon, transmeton dhe konsumon energji elektrike në mënyrë efikase, si dhe një treg që ndërmerr investime që realizojnë fitimet më të larta. Shkurtimisht, përfitimi kryesor i reformës është krijimi i një tregu që mundëson vlerën e shtuar më të mirë për paratë publike.

Në këtë proces u identifikuan gjithashtu edhe risqet që mund të sjellë zbatimi i këtij plani strategjik. Rreziku i parë potencial për t'u theksuar është një implementim i paplotë ose i pasaktë i planit strategjik të propozuar. Pasoja do të ishte një treg gjithnjë e më i ndërlikuar dhe kompleks, si dhe një treg që nuk ofron përfitimet e dëshiruara dhe vazhdon të përhumet nga skemat e subvencionimit jotransparent dhe diskriminues, që në afat të gjatë krijojnë kosto të tepërt për tregun. Rreziku i dytë i rëndësishëm për t'u theksuar është përfshirja me bazë të gjerë në reformë, duke filluar me mungesën e pronësisë nga ministria përkatëse e linjës (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë). Kjo do të thotë se, nëse aktorët e brendshëm nuk kanë interes për zbatimin e reformës, si rezultat i mungesës së pronësisë së brendshme, atëherë reforma e propozuar nuk do të zbatohet në tërësi dhe kështu do të rrisë gjasat për rrezikun e parë. Një shembull i kësaj mungese interesi për të zbatuar një reformë, të paktën brenda afatit kohor, është dhënë nga përvoja me deregullimin e përealizuar plotësisht me metodologjinë e çmimeve deri tani, pavarësisht se këto kanë qenë kërkesa ligjore. Është e rëndësishme ta merret seriozisht ky rrezik dhe në përputhje me rrethanat të merren masat e duhura për ta kundërshtuar atë. Së fundi, një sfidë kyçe është komunikimi si me publikun (konsumatorin fundor), ashtu edhe me palët e interesuara. Pra, reforma mund të çonte në çmime më të larta, që mund të rezultojnë në disa shqetësime publike. Për më tepër, reforma, si e tillë, parashikon krijimin e skemave të përkohshme dhe të përhershme mbështetëse për akomodimin e interesave të grupeve në nevojë nga ndikimet negative të reformës dhe Ëvarfërimit nga energjia - e thënë ndryshe Ëfektet që sjell ndryshimi me rritje të çmimit të energjisë elektrike nëse do të mund të ndodhë, si dhe mbështetjen e prodhuesve të energjisë së rinovueshme. Megjithatë, skema të tilla mund dhe duhet të zbatohen vetëm në mjedisin e ri të parashikuar të tregut, pasi të jetë krijuar dhe të ketë funksionuar në mënyrë të mjaftueshme për të shmangur shtrembërimin e

mekanizmit të formimit të çmimeve të tregut, d.m.th. vlerësimin e saj të mallrave në bazë të mungesës, konkurrencës dhe nevojave të investimit.

Më saktësisht, së bashku me afatet e zbatimit, elementet e politikave të reformës përbëjnë planin strategjik. Ato janë të disanjuara në mënyrë të tillë që të formojnë bazën për një PBL (Policy Based Loan) që pritej të zbatohet gjatë periudhës 2018 deri në vitin 2020. PBL-ja do të përbëhet nga dy periudha, zbatimi dhe monitorimi, të cilat jo domosdoshmërisht do të korrespondojnë me vitet kalendarike. aktualisht jemi futur në fazën e dytë të zbatimit të reformës. Faza e parë u mbyll me sukses në Dhjetor 2020. Afatet kohore gjatë të cilave elementet e politikave të reformës duhet të zbatohen përmbledhen si pas planit janë:

- Afati i parë i zbatimit
 - Numri i elementeve të politikave të reformës: 11
 - Kohëzgjatja: afërsisht 10 muaj.
 - Afati kohor: viti 2019
- Afati i dytë i zbatimit
 - Numri i elementeve të politikave të reformës: 7
 - Kohëzgjatja: 12 muaj.
 - Afati kohor: viti 2020

Për arësye të situatës së tërmetit si edhe për arësye të pandemisë, por pa lënë mënjanë këtu edhe funksionimin jo perfekt të institucioneve Shqiptare të përfshira në reformë, ajo është një vit me vonesë.

Shumica e elementeve të politikave të reformës janë në afatin e parë të zbatimit pasi ato janë të disanjuara për të promovuar elementet kryesore të reformave të cilat duken të realizueshme në vitin e parë dhe të cilat janë thelbësore të zbatohen përpara se të ndërmerren hapa të mëvonshëm. Zbatimi është realist dhe bazohet në kushtin që ka vullnet të mjaftueshëm politik pas zbatimit të reformës.

Sa i përket përmbajtjes së elementëve të politikave të reformës, ata janë, sipas projektimit, duke u fokusuar në elementet e reformës së nivelit të lartë të cilat janë vendimtare për një ristrukturim të suksesshëm të sektorit. Këto elemente të politikave të reformës do të realizojnë përmirësime institucionale në sistem, masat e bazuara në treg dhe zbatimin e praktikave të drejta dhe transparente në të gjithë zinxhirin e vlerës në sistemin e energjisë elektrike. Të gjitha këto elemente të politikave të reformës janë të domosdoshme për tregun relativisht të vogël shqiptar për të ofruar rezultatet e dëshiruara, veçanërisht në lidhje me formimin e çmimeve konkurruese në tregun e shitjes me shumicë dhe pakicë, likuiditetin e tregut, mbikëqyrjen rregullatore, interesat e ndara, pavarësinë politike të ERE-s, si autoriteti kombëtar i energjisë elektrike, dhe qëndrueshmërinë afatgjatë.

Shumë nga elementet e politikave të reformës varen nga njëra-tjetra, sidomos përgjatë dy afateve të zbatimit. Etiketimi numerik i elementeve të politikave të reformës nuk përbën një kusht në lidhje me zbatimin e elementeve të politikave të reformës brenda çdo afati të zbatimit, as nuk përcakton prioritetet e elementeve të politikave të reformës.

Zbatimi i elementëve të politikave të reformës për çdo afat përbën kushtin për disbursimin e elementit financiar të PBL-së. Pra, plani strategjik nuk bën asnjë supozim apo përjashtim

në radhën e ndodhjes të elementeve të politikave të reformës. Më saktësisht, elementet e politikave të reformës që janë duke u zbatuar ende përfshihen në bazë të rëndësisë së tyre për suksesin e përgjithshëm të përpjekjeve të reformës. Sidoqoftë, edhe pse elementet e politikave të reformës janë aktualisht duke u zbatuar, ato janë pjesë e kushteve për disbursim. Monitorimi i elementeve të politikave të reformës do të përfshijë vlerësimin që përcakton nëse sektori ka përmbushur kushtet dhe, për këtë arsye, kualifikohet për disbursim.

Tabela. 8. Pasqyra e elementeve të politikave të reformës të propozuara për fazën e parë.

Nr.	Emri	Përshkrimi	Subjekti Ekzekutues
1	Marrëveshja mbi vonesat dhe përmirësimi i pagesave nga subjektet publike	Gjetja e një zgjidhjeje për detyrimet e të papaguara në mes të subjekteve të ndryshme shtetërore	KM, MIE, MFE
2	Ndarja dhe ristrukturimi i OSHEE	Ristrukturimi i OSHEE-së në përputhje me kërkesat ligjore dhe funksionale të ndarjes dhe përgatitja për ofertë publike	KM, OSHEE, MIE, MFE
3	Miratimi i një procesi matjeje dhe parashikimi	Krijimi i një procesi dhe metodologjie të koordinuar të parashikimit, si dhe kërkesat teknike për hapjen e tregut dhe deregullimin e çmimeve	OSHEE, OST, KESH, ERE
4	Zbatimi i hapjes së tregut dhe deregullimit të çmimeve	Zbatimi i vendimeve lidhur me hapat që duhen ndërmarrë për hapjen e tregut dhe deregullimin e çmimeve, si dhe zbatimin e kontratës universale të furnizimit ndërmjet OSHEE dhe KESH (siç është përcaktuar në shtojcën 1 të Modelit të Tregut të PX-së, i miratuar me VKM	ERE, KM, MIE
5	Krijimi i një tregu shkëmbimi të energjisë	Vendosja ligjore dhe funksionale e shkëmbimit të energjisë në Shqipëri (APEX) në përputhje me Modelin e Tregut të miratuar dhe Rregullat e	OST, MIE
6	Zbatimi i mekanizmit dhe rregullave të balancimit të tregut	Zbatimi i mekanizmit të balancimit të tregut, me prokurim të hapur, transparent dhe jodiskriminues për rezervat balancuese	OST, ERE
7	Krijimi i Operatorit RES dhe transformimi i Feed-in-Tariffs	Krijimi i kuadrit institucional dhe rregullator për marketingun e drejtë, transparent dhe jodiskriminues të energjisë së rinovueshme.	ERE, MIE

8	Ofertimi konkurrues për kapacitetin e prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme	Zbatimi i ankandit të parë konkurrues dhe jodiskriminues për kapacitetet e reja të rinovueshme të prodhimit.	KM, MIE
9	Miratimi dhe zbatimi i skemës mbështetëse për konsumatorët në nevojë	Sigurimi që hapja e tregut dhe deregullimi i çmimeve të kenë ndikim minimal negativ ekonomik ndaj konsumatorëve në nevojë dhe familjeve që vuajnë nga liberalizimi i çmimit të energjisë elektrike. Përcaktimi i skemës	KM, MIE
10	Finalizimi i akteve nënligjore në përputhje me EnC <i>acquis</i> (Akt i Komunitetit të Energjisë)	Krijimi i kuadrit rregullator përmes akteve nënligjore që janë në përputhje me aktin e Komunitetit të Energjisë dhe ligjet e aplikueshme shqiptare.	ERE
11	Rritja e kompetencave dhe pavarësia e ERE-s	Forcimi i një rregullatori të pavarur i cili është në përputhje me Direktivën e BE 2009/72/KE	ERE, MIE

Tabela. 9. Pasqyra e elementeve të politikave të reformës, të propozuara për afatin e dytë kohor të zbatimit të reformës.

Nr.	Emri	Përshkrimi	Subjekti ekzekutues
12	Skema e re tarifore	Miratimi i skemës(ave) më transparente, jodiskriminuese dhe të drejta të tarifave që janë të duhura dhe të përshtatshme për një treg të lirë e të organizuar, ku çmimi i energjisë elektrike bazohet në kërkesën për të dhe investimet e nevojshme.	ERE
13	Bashkim i tregut të ditës në avancë me tregjet e tjera	Bashkimi i tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë me tregjet fqinje	ERE, APEX,
14	Miratimi i një perspektive të qartë strategjike për KESH-in	Përcaktimi i rolit në treg në të ardhmen i KESH-it, si gjatë periudhës së tranzicionit ashtu edhe në periudhën afatgjatë	OST MIE, KESH
15	Plani Kombëtar 10-vjeçar Zhvillimor i Rrjetit	Miratimi nga OST i një Plani Kombëtar 10-vjeçar Zhvillimor të Rrjetit (TYNDP), në varësi të miratimit të ERE-s	OST, ERE

16	Prokurimi i integruar i të gjitha humbjeve	Krijimi nga OST-ja (ose më mirë nëse është e zbatueshme të përgatisë dhe të propozojë për miratim në ERE) i një procesi të vetëm për prokurimin e energjisë për humbjet e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes në APEX	OST, ERE
17	ERE arrin statusin e vëzhguesit në ACER	ERE të bëhet një vëzhgues në Organizatën Pan-Evropiane për Rregullatorët (ACER-Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë)	ERE, MIE
18	Miratimi i një perspektive të qartë strategjike për OSHEE-në	Përkufizimi i rolit të ardhshëm të OSHEE-së (në veçanti elementit të DSO) në treg si gjatë një periudhe tranzicioni dhe afatgjatë	MIE, OSHEE

Zbatimi i të gjithë PRE kontrollohet përmes një sistemi pikëzimi i cili bën të mundur monitorimin e reformës dhe përmbushjen e kushteve të saj që siç e thashë përbejnë kusht për disbursimin e PBL-ve.

Plani është në zbatim e sipër dhe përbën aktualisht instrumentin kryesor dhe më të rëndësishëm të përmbushjes së reformës.

Të dy këto dokumente të rëndësishëm janë të miratura ose kanë edhe pëlqimin e Sekretariatit të EnC. Është ky i fundit që çertifikon të gjithë këto procese.

2.3. Paketa e tretë e energjisë

Paketa e tretë e energjisë ka si objektiv përmirësimin e funksionimit të tregjeve të brendëshme të energjisë dhe në zgjidhjen e problemeve strukturore bazuar në direktivën europiane të energjisë. Ajo hyri në fuqi në Shtator 2009. Direktiva për energjinë elektrike 2009/72/EC do të ishte në fuqi deri në Dhjetor 2020, kur edhe pjesa e fundit e rregullave të reja të tregut të energjisë elektrike do të zbatohet. Kjo vlen vetëm për tregun e energjisë elektrike pasi për gazin natyror kjo paketë është ende në fuqi. Që të dy këto tregje, energjia elektrike dhe gazi natyror janë nën kuadrin rregullator të politikave të Clean Energy dhe Transit Energy që qysh nga Shkurti i 2019. Paketa e tretë e energjisë përfshin këto fusha: ndarjen e plotë të operatorit të sistemit të shpërndarjes nga furnizimi dhe prodhimi (unbundling), pavarësi e plotë e enteve rregullatore, ACER, kooperimin ndërkufitar (cross border) dhe tregje të hapura dhe të drejta (fair - të parregulluara).

1. Unbundling është ndarja e furnizimit të energjisë dhe prodhimit të saj nga operatorët e sistemeve të transmetimit dhe të shpërndarjes. Operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes duhet të garantojnë akses të barabartë ndaj të gjithë përdoruesve të rrjeteve. Nëse kjo ndarje nuk do të ndodhte, pra ato do të ishin sëbashku me gjenerimin në të njëjtën kompani, kjo do të krijonte mundësi për diskriminim ndaj përdoruesve apo gjeneruesve të tjerë jasht këtij bashkimi, duke shtrembëruar edhe konkurrencën e lirë pra parimin e pestë të paketës, atë të tregjeve të hapura e të drejta. Gjithashtu, kjo situatë monopol mund të sillte edhe çmime më

të larta për konsumatorët fundorë. Unbundling mund të bëhet në tre mënyra, në varësi nga kushtet dhe rrethanat që secili vend mund të ketë veçanërisht³¹:

- a) Ndarje mbi pronësinë - kjo kërkon që operatori i transmetimit duhet të jetë juridikisht por dhe nga ana e pronësisë i pavarur nga furnizimi dhe prodhimi. Kjo vlen edhe për rrjetet e shpërndarjes së energjisë.
- b) Operatorë sistemesh të pavarur - kjo dmth që kompanitë e furnizimit me energji elektrike mund të jenë pronare të rrjeteve të transmetimit dhe shpërndarjes, por duhet të mos i operojnë ato. Në këtë rast operimi, mirëmbajtja dhe investimet në rrjet duhet të bëhen nga kompani juridikisht dhe nga pikëpamja e pronësisë të pavarura.
- c) Operatorë të sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes të pavarur - mund të jenë nën një pronësi me furnizuesit e energjisë, pra të kenë integrim vertikal, por mund ta bëjnë aktivitetin e tyre të pavarur si kompani bja nën një program përputhshmërie dhe nën mbikqyrjen e një oficeri përputhshmërie të pavarur.

Këto rregulla janë të sanksionuara edhe në traktatin e energjisë në nenin 96 të tij. BE dhe Komuniteti European i Energjisë e kontrollojnë këtë proces lidhur me zbatimin e tij në të gjithë vendet anëtare ose palët kontraktore duke kërkuar certifikimin e të gjithë operatorëve nga entet kombëtare rregullatore të energjisë. Procesi i certifikimit duhet të jetë gjithashtu nën një vlerësim pozitiv (kalues) nga ana e Komisionit European. Këto opinione bëhen vazhdimisht transparente për publikun.

2. Ente rregullatore të pavarur. Një treg i brendëshëm energjie që garanton dhe bazohet në konkureshmëri, nuk mund të garantojë objektivitet dhe konkureshmëri objektive pa një rregullator të pavarur i cili garanton zbatimin e të njejtave rregulla për të gjithë. Rregullatorët duhet :
 - a) Të jenë të pavarur si nga industria ashtu edhe nga politika ose qeveritë. Ata duhet të jenë autonomë si ligjërish ashtu edhe nga ana financiare, edhe pse financimi i tyre mund të vijë nga shteti.
 - b) Të mund të lëshojnë vendime detyruese për kompanitë dhe operatorët e tregut të energjisë dhe të marrin masa shtrënguese ose dënojnë ata që nuk respektojnë detyrimet e tyre të bazuara në ligjet e sektorit apo të tjera që zbatohen edhe në sektorin e energjisë.
 - c) të gjithë operatorët në treg janë të detyruar t'ia sigurojnë cdo informacion dhe të dhënë rregullatorit.
 - d) Të koepërojnë me ente të tjera rregullatore europiane për të provuar konkurrencë të lirë e të ndershme, hapje të plotë të tregut, dhe sisteme energjie të sigurtë dhe eficientë.
3. ACER - Agjencia për Kooperimin e Rregullatorëve të Energjisë. Aderimi në këtë organizëm është i detyrueshëm. Ky organizëm është i pavarur nga Komisioni European, qeveritë dhe kompanitë e energjisë. Funksionimi i ACER përfshin:
 - a) Hartimin e udhëzuesve për operimin ndërkufitar të rrjeteve kombëtare.
 - b) Monitorimin dhe rishikimin e zbatimit të planeve të zhvillimit të rrjeteve në të gjithë vendet anëtare dhe palët kontraktore.

³¹ Paketa e Tretë e energjisë, direktiva e BE 2009/72/EC.

- c) Të japin vendime lidhur me çështë ndarkufitare, në rast se rregullatorët kombëtarë nuk dakordësohen për zgjidhjen e tyre ose kur këta të fundit kërkojnë ndërhyrjen e ACER si arbitër.
 - d) Monitorimi i funksionimit të tregjeve të brendëshme duke përfshirë çmimet e furnizimit, aksesin në rrjete të prodhuesve të energjive të rinovueshme dhe të të drejtave të konsumatorëve fundorë.
4. Kooperimi ndarkufitar. Për këtë pjesë janë përgjegjës operatorët e sistemit të transmetimit kombëtarë, të cilët mundësojnë transmetimin efektiv të energjisë përmes rrjeteve. Rast tregues në nivel rajonal është krijimi i CAO SEE në Podgoricë të Malit të Zi e cila mundëson këtë kooperim në cdo dimension në nivel të Ballkanit Perëndimor. Në nivel European këtë funksion Komuniteti European i Energjisë e realizon përmes ENTSO-E për energjinë elektrike dhe ENTSG për gazin natyror. Këto dy organizma zhvillojnë standarde dhe krijojnë kode të rrjeteve për të rregulluar dhe koordinuar planifikimin e investimeve në rrjete dhe për të monitoruar zhvillimin e kapaciteteve të reja transmetuese.
5. Tregje të hapura dhe të drejta (fair) nënkupton rregulla të projektuara për të garantuar akses na rrjet dhe konsum të energjisë nga konsumatorët dhe për të mbrojtur të drejtat e tyre. Ato përfshijnë të drejta lidhur me zgjedhjen e furnizuesit pa penalti ose ngarkesë detyrimesh financiare, të drejtën e Informimit mbi konsumin e energjisë si edhe zgjithje të lirë dhe të shpejtë të konflikteve.

Këto specifikime janë të shprehura si detyruese ose jo në shumë dokumente të lëshuara nga BE, Komuniteti European i Energjisë ose Sekretariati i tij etj, disa prej të cilave janë:

- Vendimet për përjashtimin kombëtar për infrastrukturën e reja në elektricitet dhe gas (Qershor 2019)
- Lista periodike e njoftimit të certifikimeve (2011-2015)
- Raporti i progresit lidhur me kompletimin dhe instalimin e tregjeve të brendëshme të energjisë COM(2014)634
- Vlerësimi i Komisionit për ACER C(2014)242 final
- Instalimi i tregjeve të brendëshme të energjisë dhe ndërhyrja publike COM(2013)7243
- Ndarja (Unbundling) e pronësisë: vlerësimi i konflikteve të interesit SĚD(2013)177
- Certifikimi i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit për rrjetet e elektricitetit dhe gazit natyror në EU SEC(2011)1095
- Mundësia e vendeve fqinje dhe OST-ve të tyre për të marrë pjesë në ACER dhe në ENTSO-E(G) SEC(2011)546
- Nota interpretuese për autoritetet rregullatore lidhur me direktivën europiane në elektricitet dhe gas natyror (2010)
- Direktiva e Energjisë (2009/72/EC)
- Rregullorja e Energjisë (EC) No 714/2009
- Kushtet për akses në rrjete për shkëmbime ndërkufitare në elektricitet (SEC(2009)642)
- Traktati i energjisë (nën proces amendimi për reflektimin e ndryshimeve në sektorin e energjisë dhe në lidhje me një mjedis më të pastër) etj.

2.4. Paketa e energjisë së pastër për të gjithë europianët

Në 2019 BE ndryshoi thelbësisht qasjen e saj lidhur me zhvillimin e sektorit të energjisë duke vendosur si kusht të këtij zhvillimi kriterin e qëndrueshmërisë. Kjo kërkonte reduktimin e menjëherëshëm të përdorimit të fosileve të lëngëta ose të ngurta për prodhimin e energjisë drejt zhvillimit të energjisë që bazohet në burime të pastra dhe pa emission karboni apo të gazrave serë. Këto koncepte sanksionoheshin përmes Marrëveshjes së Parisit që ishte e para marrëveshje detyruese në nivel global lidhur me ndryshimet klimatike për shkak të zhvillimit global në përgjithësi e dakordësuar në Konferencën e Parisit për Klimën në Dhjetor 2015 (COP21). Kjo marrëveshje vendosi se në themel të zhvillimit strategjik të BE energjinë e pastër. Bazuar në propozimet e Komisionit European në 2016, kjo paketë konsistonte në tetë ligje ta reja lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të energjisë. Kjo marrëveshje u pasua nga disa vendime të rëndësishme politike të Këshillit të BE dhe të Parlamentit European të cilat u finalizuan në Maj të 2019, dhe bënë të mundur hyrjen në forcë të rregullave të ndryshme të reja që udhëheqin zhvillimin e sektorit të energjisë, për të cilat vendet e BE dhe palët kontraktore në Komunitetin European të Energjisë do të kenë 1 deri 2 vjet kohë për t'zbatuar në nivel kombëtar. Kjo do të sjellë përfitime të rëndësishme për konsumatorët fundorë, për mjedisin dhe për ekonominë kombëtare. Këto rregulla janë të përfshira në Politikën e Reja Udhëheqëse të BE dhe EnC dhe janë të lidhura më uljen sa më shumë të fenomenit të ngrohjes globale dhe në neutralitetin e karbonit deri në 2050 (net-zero emissions).³²

Performanca energjitike e ndërtesave dhe efienca energjitike në to është një tjetër target i rëndësishëm në kuadrin erës së re post-paketë e tretë e energjisë. Ndërtesat janë si konsumatore të rëndësishme të energjisë, ashtu edhe emetuese të karbonit dhe gazrave serë gjatë përdorimit të burimeve të ndryshme energjie. Rritja e eficiencës energjitike të këtyre ndërtesave do të kontribuojë në arritjen më të shpejtë të targeteve europiane dhe kombëtare të energjisë dhe klimës. Direktiva europiane për performancën e ndërtesave EU2018/844 përcakton një gjërësi masash që dueht të merren nga vendet veçmas dhe në kooperim midis tyre, sidomos në sektorin e ndërtimit për të arritur objektivat e vendosura nga EnC në Shkurt 2019 në Podgoricë.

Një element i rëndësishëm lidhur me një mjedis global të pastër është edhe diversifikimi i **prodhimit të energjisë nëpërmjet përdorimit të burimeve të rinovueshme** për prodhimin e elektricitetit dhe ngrohjes. Direktiva për Energjitë e Rinovueshme 2018/2001/EU hyri në fuqi në Dhjetor 2018. Nën këtë direktive edhe Shqipëria është duke amenduar Ligjin për mbështetjen e prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme 07/2017 i cili është i planifikuar të ndodhë brenda vitit 2021.

Efienca energjitike është një tjetër drejtim i rëndësishëm i marrëveshjes së Parisit, tashmë një detyrim për të gjithë vendet anëtare dhe palet kontraktore te EnC. Ajo synon të përmirësojë performancën në ndërtim, si edhe performancën në të gjithë proceset industriale ose jo ku energjia është forcë e domosdoshme motorre, duke kursyer energjinë e kërkuar dhe duke reduktuar kështu efektet negative të emisioneve të ndryshme në mjedis.

³² https://ec.europa.eu/energy/topics/energy-strategy/clean-energy-all-europeans_en

Targeti i Shqipërisë deri në 2030 është 15.5% kursim, ndërsa ai i BE është 32.5%. Kjo diferencë mes të dy targeteve lidhet me faktin se Shqipëria konsumon më shumë se 38% energji të pasur në totalin e konsumit energjistik, kur kemi parasysh se e gjithë energjia elektrike e prodhuar në vend është 100% e rinovueshme. Direktiva për eficiencën energjitike EU2018/2002 ka hyrë në fuqi qysh në Dhjetor 2018. Shqipëria e ka transpozuar plotësisht këtë direktivë.

Rregullimet qeveritare në këtë drejtim parashikojnë një sërë masash të rëndësishme që duhen ndërmarrë për arritjen e targeteve të reja në kuadrin e zhvillimit energjistik dhe atij të përmirësimit të vazhdueshëm të mjedisit. Nën këtë detyrim, të gjithë vendet duhet të hartojnë planet e tyre kombëtare të energjisë dhe klimës (NECP) për 2021-2030. Afati për hartimin dhe miratimin e këtij plani për Shqipërinë është Dhjetor 2021. Shqipëria ka tashmë draftin e tij dhe është në fazën e diskutimit të tij me Sekretariatit e Energjisë të EnC. Rregullorja e Qeverisjes për Bashkimin Energjistik dhe Aksionin Klimatik EU2018/1999 ka hyrë në fuqi qysh në Dhjetor 2018.

Projektimi i tregut të energjisë elektrike dhe instalimi i tij është një tjetër kërkesë e post-paketës së tretë. Kjo parashikon rregullime të lidhura me administrimin e mbështetjes qeveritare për zhvillimin e burimeve të rinovueshme për prodhimin e energjisë dhe me një modernizim të tegut dhe instrumenteve të tij për të thithur sa më shume energji të pastër pa krijuar deformime bë treg, dhe pa cënuar konsumatorët fundorë në çmim dhe siguri energjitike. Kjo kërkon edhe një here forcimin e rolit të ACER dhe rregullatorëve të tregut të energjisë lokale.

Procesi i **adoptimit të akteve ligjore** në mbështetje të kësaj pakete tregohet në tabelen e mëposhtme:

Tabela. 10. Energji e pastër për të gjithë konsumatorët europianë - kuadri ligjor dhe rregullator

	Komisioni European propozimi	Ndër- institucional BE negociata	Parlament European adoptim	Këshilli adoptim	Revista Zyrtare publikimi
Performanca energjitike në ndërtesa	30/11/2016	Political agreement	17/04/2018	14/05/2018	19/06/2018 - Directive (EU) 2018/844
Energji e rinovueshme	30/11/2016	Political agreement	13/11/2018	04/12/2008	21/12/2018 - Directive (EU) 2018/2001

Eficienca energjitike	30/11/2016	Political agreement	13/11/2018	04/12/2018	21/12/2018 - Directive (EU) 2018/2002
Qeverisja e bashkimit energjistik	30/11/2016	Political agreement	13/11/2018	04/12/2018	21/12/2018 - Regulation (EU) 2018/1999
Rregullorja e energjisë elektrike	30/11/2016	Political agreement	26/03/2019	22/05/2019	14/06/2019 - Regulation (EU) 2019/943
Direktiva e energjisë elektrike	30/11/2016	Political agreement	26/03/2019	22/05/2019	14/06/2019 - Directive (EU) 2019/944
Evidentimi i risqeve	30/11/2016	Political agreement	26/03/2019	22/05/2019	14/06/2019 - Regulation (EU) 2019/941
ACER	30/11/2016	Political agreement	26/03/2019	22/05/2019	14/06/2019 - Regulation (EU) 2019/942

Këto akte ligjore të sanksionuara dhe detyruese tashmë për të gjithë EnC janë shoqëruar edhe me disa iniciativa dhe aksione jo-ligjore në mbështetje të zbatimit të tyre nga të gjithë vendet anëtare dhe palët kontraktore, midis të cilave mund të rendisim:

- Iniciativa e rajoneve të qymyrit në tranzicion (Coal Regions in Transition)
- Iniciativa e energjisë së pastër për ishujt e BE (Clean Energy for EU Islands)
- Masa për të vlerësuar dhe monitoruar më mirë efektet e reformës lidhur me varfërimin e mundëshëm të konsumatorëve (energy Poverty in Europe)³³

³³ Raportet e Komunitetit European të Energjisë

KAPITULLI I TRETË- Metodologjia

3.1 Metodologjia e kërkimit dhe vlerësimit të të dhënave

Në këtë studim janë të ndërthurur si faktorë teknologjikë e teknikë, ashtu edhe faktorë social dhe ekonomiko-ligjorë, të cilët së bashku paraqesin një ndikim të integruar në performancën e sistemit, e parë kjo si performancë teknike dhe si performancë ekonomike. Si variabël i varur është marrë performanca totale e sistemit, teknike dhe ekonomiko-ligjore, Y_{tot} . Për analizimin e saj aplikuar regresioni i shumëfishtë, ku performanca totale e sistemit matet si mesatare e përbërë nga performanca nën vështrimin dhe perceptimin e tre grupeve të mëdha konsumatore të energjisë elektrike; a) performancës sipas perceptimit të konsumatorëve familjar $Y(fam)$, b) performancës sipas perceptimit të konsumatorëve privatë $Y(pv)$, dhe c) performancës sipas perceptimit të konsumatorëve buxhetorë dhe jo-buxhetorë $Y(bjb)$. Bazuar në sistemin e mëparëshëm të organizimit të sektorit, pa hyrjen në fuqi të ligjit të ri të sektorit të energjisë elektrike, si edhe të ligjeve të tjera me efekt direkt ose indirekt në këtë sektor, në modelin e tregut të zbatuar deri në fund të 2014 (model i cili vazhdon të jetë nën periudhë tranzitore deri në futjen e modelit të ri, 2022), në kushtet kur akoma nuk është kompletuar plotësisht kuadri nënligjor dhe rregullator për zbatimin e ligjit të ri lidhur me modelin e ri të tregut (duhet të vazhdojë procesi i liberalizimit sipas planit të ndryshuar në aneksin 4 të vkm 519, të themelohet operatori i energjiave të rinovueshme si off-taker i të gjithë energjisë së prodhuar nga prodhuesit prioritarë, të miratohet vkm për kontratën për diferencë, të miratohet vkm për shërbimet e balancimit në mënyrë që plotësojnë krejt kuadrin ligjor dhe rregullator). Do të analizojmë të dhëna historike dhe gjetje e fenomene nga studime të kaluara nga studiues dhe ente të ndryshëm publikë ose jo lidhur me variablat e pavarur të identifikuar për çdo nivel performance deri në 31 Dhjetor 2014, si edhe të dhëna të marra nga përgjigjet e intervistuarve ndaj pyetësorëve të hartuar, duke nxjerrë e analizuar edhe rezultatet e këtyre të dhënave (cross section data). Nga ana tjetër, do të marrim në konsideratë një analizë statistikore të treguesve të performancës së sektorit për fazën e parë të realizimit të reformës, 2015-2017 dhe atë në vazhdim 2017-2020 dhe do të analizojmë gjithashtu të dhënat nga procesi i intervistimit nëpërmjet pyetësorëve për tregun dhe sektorin, nën rezultatet e reja aktuale dhe të pritëshme, duke vlerësuar korelacionin që variablat e pavarur kanë me performancën në çdo nivel, si edhe do të bëjmë një analizë krahasuese të rezultateve për të dy periudhat lidhur me performancën totale të sistemit. Çështja është të vlerësohen të gjetjet historike dhe ato cross section lidhur me nevojën për ndryshime jo vetëm në performance ekonomike, organizative e menaxheriale, por edhe të ndryshimeve të rëndësishme strukturore të cilat krijojnë kushte për një performancë të çdo niveli të ndryshuar, përmirësuar, dhe për një sektor *ñbankable* dhe që mund të performojë në mënyrë të suksesshme duke e menaxhuar sektorin pa mbështetjen e shtetit me para nga buxheti, apo me masa detyruese në nivel makro, kombëtar.

Së pari, do të identifikojmë nga pyetësorët dhe nga studimet e mëparëshme të sektorit variablat e pavarur për çdo nivel performance të përmendur më lart, dhe do të shtrojmë regresionet e shumëfishta për secilën performancë. Do të bëjmë testimin e variablave për rëndësi (significance) dhe korelacion, si edhe do të testojmë regresionet respektive për multikolinearitet dhe autokorelacion. Kështu do të bëjmë të mundur pastrimin e regresioneve nga variabla të pavarur që interferojnë me njëri-tjetrin ose me gabimin

standard. Më tej, do të shtrojmë një regresion me variabla të pavarur të përbërë, të përmendur më lart, i cili do të testohet lidhur me korelacionin e tyre (rezultateve të tyre) ndaj performancës totale të sektorit, si variabli integral për tû matur dhe për tû testuar lidhur me ndryshimet e projektuara në sektor dhe për tû zbatuar në vitet në vazhdim. Në të gjitha rastet do të testoj dhe modelet e zgjedhura të shtrimit të regresioneve për të vërtetuar formën e duhur të funksioneve, si edhe lidhur me përfshirje të variablave irrelevantë në funksion.

Gjithashtu, duke bërë një analizë variance të këtyre variablave të përbërë, do të analizoj edhe rëndësinë marxhinale të secilit prej tyre në performancën e përgjithëshme. Kjo ka rëndësi për prioritizimin e masave që i përkasin secilit variabël të pavarur, duke qenë se sistemi është në deficit neto për sa i përket nevojës për mbështetje financiare dhe realizim të secilit prej proceseve. Funksioni i fundit është ai i performancës së përgjithëshme të sektorit të energjisë elektrike i cili përfaqëson një analizë bashkëngjitive statistikore të të tre performacave të perceptuara nga përdoruesit fundorë të secilit segment tregu, përdoruesve familiar, buxhetorë dhe jo-buxhetorë, si edhe përdoruesve privatë. Grupi më homogjen i të intervistuarve, ose përdoruesve fundorë është ai i familiarëve duke qenë se që të gjithë janë të lidhur në tension të ulët dhe kanë të njëjtin cmim dhe kosto shërbimi. Dy grupet e tjera kanë një kufizim për sa i takon saktësisë në përgjigje pasi brenda tyre janë përdorues fundorë të lidhur në nivele të ndryshme tensioni, të lidhur në 04 KV - 6/10/20 KV - 35 KV, të cilët kanë edhe kosto të ndryshme furnizimi pore dhe nivel të ndryshëm shërbimi nga njeri nivel në tjetrin.

Gjithashtu, do të analizohen nga pikëpamja llogjike dhe analizimi cilësor të dhënat dhe gjetjet nga studime të mëparëshme të cilat do të plotësojnë rezultatet statistikore nga analizimi i të dhënave të pyetësorëve.

3.2 Përcaktimi i hipotezave

Punimi për të arritur në rezultatet e supozuara nëpërmjet hipotezave që shtrohen më poshtë do të përfshijë: analize të të dhënave zyrtare ndër vite të publikuara nga Ministria e Energjitikës dhe entet përkatëse të saj si OST, KESH, OSHEE dhe AKBN, si edhe nga ERE (Enti Rregullator i Energjisë) etj, krahasuar këto me implementimin e ndryshimeve të pritëshme për shkak të zbatimit të reformave në sektorin elektro-energjitik.

- **Hipoteza e parë: (H-1)** Reformat e ndërmarra nuk ndikojnë në Performancën e sektorit të energjisë elektrike.
- **Hipoteza e dytë: (H-2)** Performanca e sektorit të energjisë elektrike për ekonominë kombëtare rritet si pasojë e zbatimit të reformës legjislative dhe rregullatore në sektorin elektro-energjitik, rritjes së investimeve në infrastrukturë dhe në kualifikimin e stafit.

Hipotezat e mësipërme mbështeten dhe nga nën hipotezat e mëposhtme:

- H-1-1: Reformat legjislative dhe rregullatore ndikojnë në cilësinë e furnizimit me energji elektrike
- H-1-2: Siguria e fuqisë së instaluar është e ndikuar nga reformat legjislative dhe rregullatore

- H-1-3: Aksesit i konsumatorëve në rrjetin e shpërndarjes varet nga reforma legjislativë dhe rregullatore
- H-1-4: Niveli i investimeve nuk ndikon në rritjen e performancës së sektorit pasi reformat legjislativë dhe rregullatore janë të mjaftueshme.
- H-1-5: Përmirësimi i sistemit tarifor është i mjaftueshëm për rritjen e performancës së sektorit elektro-energjitik
- H-2-1: Reformat legjislativë dhe rregullatore ndikojnë në cilësinë e furnizimit me energji elektrike, por efekti i tyre duhet të amplifikohet edhe me masa të tjera shoqëruese
- H-2-2: Siguria e fuqisë së instaluar rritet me bërjen e investimeve adekuate dhe është e ndikuar nga reformat legjislativë dhe rregullatore.
- H-2-3: Aksesit i konsumatorëve në rrjetin e shpërndarjes varet rritja e investimeve në rrjetin e shpërndarjes dhe nga reforma legjislativë dhe rregullatore.
- H-2-4: Niveli i investimeve të sektorit së bashku me reformat legjislativë dhe rregullatore rrisin ndjeshëm performancën e sektorit.
- H-2-5: Përmirësimi i sistemit tarifor së bashku me rritjen e investimeve, kuasifikimin e personelit dhe reformën legjislativë dhe rregullatore, është i mjaftueshëm për rritjen e performancës së sektoreit elektro-energjitik.

Analiza dhe nxjerrja e rezultateve do të bëhet e ndarë në dy faza:

Së pari, testimi i H.1 për vertetësi, dhe me tej testimi i H.2 për të vërtetuar impaktin pozitiv të faktorëve të përfshirë në operimin e sistemit nën kushtet e modelit të ri të tregut, nëse do të kenë ndikim pozitiv, pra do të ulin kostot totale të sigurimit të energjisë për ekonominë Shqiptare, në kushtet e një përmirësimi Pareto. Në këtë vlerësim do të marrim në konsideratë dy grupe faktorësh, ata që ndikojnë në rritjen e sigurisë së furnizimit dhe ata që lidhen me cilësinë totale të furnizimit.

3.3. Hartimi i pyetësorëve

Për hartimin e pyetësorëve jam bazuar në shqyrtimin dhe analizën e raporteve dhe studimeve të mëparëshme kryesisht nga ERE dhe nga vetë ndërmarrjet e sektorit të energjisë elektrike. Synimi ka qenë identifikimi i variablave më të rëndësishëm dhe testimi i tyre për rëndësi lidhur me variablat e performancës. Në matjen e këtyre pyetjeve është përdorur shkalla likert nga 1 në 5 (shumë keq, keq, mesatar, mirë, shumë mire, nuk e di) duke i bërë rezultatet nga përgjigjet të matëshme nga ana sasiore. Është zgjedhur një grup përfaqësues për secilin prej grupeve (përdorues familjar, jo familjar privat, buxhetorë, jo-buxhetorë) të përdoruesve fundorë të energjisë duke garantuar që zgjedhja e të intervistuarve të jetë e rastit. Pyetësorët janë paraqitur në aneks. Janë bërë pesë grupe pyetjesh të cilat përmajnë dhe nën pyetje, për të intervistuarit sipas përkatësisë së tyre në grupet e përmendura më lart të cilat, në rastin e familiarëve lidhen me pyetja 1) cilësinë e furnizimit me energji elektrike (a)niveli i tensionit, b)niveli i rrymës dhe c)siguria e rrjetit), 2) pyetja e dytë e cila lidhet me sigurinë e furnizimit kam vendosur ta shoqërojë dhe me vlerësime të posacme brënda saj si psh 2/c) A lajmëroheni për ndërprerje të planifikuara të

energjisë elektrike në zonën tuaj? (1=fare; 2=rrallë; 3=një herë në ditë në media lokale; 4=2-3 herë në ditë në media lokale; 5=njoftohemi me siguri në media kombëtare disa herë/ditë ose me njoftim me shkresë nga OSHEE), pyetja 3) nivelin e shërbimit të ofruar për klientët nga operatori i sistemit të shpërndarjes ka të bëjë me procedimin e ankesave nga ana e OSHEE, kompetencën dhe profesionalimin ndaj klientëve, pyetja 4) niveli i shërbimit teknik të shpërndarjes së energjisë elektrike edhe këtu kam vijuar me nënpyetjet ku secila ka shkallën e saj të vleresimit psh: 4/f) Sa është e lidhur performanca e rrjetit me nivelin e investimeve në rrjet? (1=aspak; 2=pak; 3=nuk ndikon; 4=ndikon mjaft; 5=ndikon shumë) dhe pyetja 5) gjykimi i përdoruesve fundorë mbi sistemin e ri tarifor: Si e gjykoni sistemin e ri tarifor të energjisë elektrike në Shqipëri? (1=shumë më të shtrejtë se sistemi i vjetër; 2=më i shtrejtë se sistemi i vjetër; 3=nuk ka ndryshim në efekt fundor; 4=më ekonomik; 5=shumë më ekonomik) etj . Pyetësorët gjithashtu mbledhin edhe të dhëna rreth të ardhurave të tyre dhe sipërfaqes së banimit në pyetjen 6 dhe 7 të tij.

Në rastin e përdoruesve buxhetorë dhe jo-buxhetorë kemi këto grupe pyetjesh, 1) pyetje për cilësinë e furnizimit, 2) në lidhje me sigurinë e furnizimit, 3) shërbimit ndaj klientëve, 4) shërbimin e rrjetit të shpërndarjes dhe 5) lidhur me sistemin e ri tarifor. Po kështu edhe në këtë rast kemi drejtuar edhe pyetje lidhur me strukturën e kapitalit, të ardhurat vejtore të aktivitetit të tyre dhe të dhëna për sipërfaqen totale të aktivitetit të tyre. Pyetjet e para nga 1-5 edhe pse i referohen parametrave pothuaj të njëjtë (edhe për arësye komogjenizimi të rezultateve nga intervistimi) zberthehen në nën-pyetje të cilat trajtojnë përgjigjen ndaj pyetjes kryesore sipas specifikave të qasjes së tyre ndaj energjisë dhe shërbimeve të rrjetit. Në rastin e përdoruesve privatë të energjisë elektrike janë drejtuar përseri pesë grupe kryesore pyetjesh për cilësinë e furnizimit, sigurinë e furnizimit, shërbimin ndaj klientëve, shërbimin e shpërndarjes dhe sistemin tarifor të shoqëruara me pyetje rreth të ardhurave vejtore dhe sipërfaqes totale të aktivitetit të tyre.

Një strukturim i tillë i pyetjeve ka bërë të mundur identifikimin e variablave dhe shtrimin e regresioneve shumë, testimin e tyre për multikolinearitet dhe autokorrelacion, si edhe analizën bashkëngjitëse të tyre për performancë sipas grupeve të përdoruesve dhe performancë totale të të gjithë sistemit.

KAPITULLI I KATËRT. Analiza e të dhënave dhe rezultateve, si edhe testimi i hipotezave.

4.1. Analiza e të dhënave dhe testimi i H.1.

Duke iu referuar H.1, analiza e historikut të sektorit në kapitujt e mësipërm, gjendja e sektorit në vitet 2012-2014, dështimi i privatizmit të shpërndarjes nga Cez, kolapsi financiar i sistemit elektroenergjitik, sidomos pjesë publike të tij tregojnë se ajo është tashmë një alternativë zhvillimi e dështuar dhe e rrëzuar.

Deri në fundin e vitit 2014, ishte testuar tashmë edhe përmirësimi i performancës së sektorit dhe ndërmarrjeve publike të tij pa filluar zbatimin e reformës në sektor dhe përmirësimet ishin të papërfillëshme.

Kuadri ligjor ishte i pa plotë dhe i papërditësuar, duke mos reflektuar aspak ndryshimet në sektorin e energjisë elektrike në BE dhe rajon, si edhe duke mos reflektuar deyrimin për ndryshimin dhe harmonizimin e tij me paketën e tretë të energjisë. Kjo e bënte sektorin shqipëtar të energjisë elektrike të papërputhëshëm dhe me akses shumë të vështirë në tregun rajonal dhe atë europian të energjisë. Shteti shqipëtar kishte disa çështje konflikti të hapura me EnC dhe BE për mënyrën e organizimit të këtij sektori.

Shqipëria nuk kishte akoma një strategji të sektorit të energjisë në përgjithësi dhe të energjisë elektrike në veçanti. Kjo bënte që projektimi i zhvillimit të sektorit të ishte kaotik dhe pa vision për të ardhmen duke kërcënuar seriozisht zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, si edhe sovranitetin kombëtar, gjithashtu.

Performanca ekonomiko financiare e sektorit ishte shumë e dobët dhe, praktikisht, sektori ndodhej përballë një kolapsi të plotë. Sistemi kishte detyrime të pashlyera për taksa dhe tatime, borxhe të krijuara në vite për kredi afatgjata dhe interesa të maturuara e të pashlyera, vonesa në shlyerjen e detyrimeve ndaj taksave dhe tatimeve, borxh të keq tashmë të matruar dhe të provigjionuar 100% ndaj institucioneve, organizatave ose individëve të paidentifikueshëm (të mbyllur juridikisht, ose që kishin mbyllur qysh para reformës kontratat me shpërndarjen duke patur detyrime të mëdha të pashlyera, ose që kosto e mbledhjes së tyre ishte më e lartë se vetë menaxhimi i borxhit). Në tabelën e mëposhtëme jepen të grupuara disa prej detyrimeve negative të sektorit publik të krijuara në vite me gjendjen e tyre përfundimtare në vitet 2013 dhe 2014.

Tabela. 11. Situata detyrimeve financiare e sektorit publik të energjisë elektrike (miliard lekë)

Detyrimet	Vite	
	2013	2014
Humbjet e energjisë (%)	45.00%	40.00%
Humbjet jo teknike (%)	28.00%	24.00%
Defiçiti negativ vetëm nga humbjet	(21,147.26)	(21,898.58)
Faturat e papaguara	(8,114.61)	(6,959.64)
Borxhi i ujës-jellësve ndaj OSHEE	(3,219.37)	(4,585.54)
TVSH e papaguar nga KESH	(5,610.41)	(5,610.41)
TVSH e papaguar nga OSHEE	(4,272.01)	(4,272.01)
Tatim fitimi i papaguar KESH	(734.29)	(4,931.83)
Tatim fitimi i papaguar OSHEE	(4,577.97)	(6,342.94)
Detyrimi ndaj Cez		(1,400.00) ³⁴
Defiçiti negativ në total si detyrim i sistemit ndaj të tretëve	(47,675.91)	(56,000.95)

Niveli i investimeve në sektor ishte i ulët dhe efienca në kryerjen e tyre e dobët. Në sektorin e shpërndarjes ishin bërë vetëm 8 milion Euro investime gjatë periudhës 2009-2013. Kishte mbi 15% të konsumatorëve pa matës, të cilët faturoheshin me tarifë fikse, pavarësisht se sa konsumonin. Nevojiteshin mbi 300 mijë matës për të zëvendësuar matësat e dëmtuar dhe të manipuluar. Situata në rrjet dhe në nënstacione ishte jashtë standarteve dhe kishte nevojë për ndëryrje esenciale teknike. Mbi 80% e rrjetit të shpërndarjes ishte e pa investuar nga 20-40 vjet, pra totalisht e amortizuar.

Të tre operatorët e mëdhenj të sektorit, OST, KESH dhe OSHEE kishin detyrime të papaguara për energji dhe shërbime rrjeti mes tyre prej më shumë se 70 miliard lekë, dhe për kredi të papaguara ndaj të tretëve për rreth 117 miliard lekë, nga të cilat rreth 37 miliard ishin overdraft. Aftësia paguese e tyre me tarifat ekzistuese dhe shifrat e tyre të biznesit ishte më pak se 24% e detyrimit vjetor për këto kredi.

Ndërrhyrja politike në sektor ishte më shumë se evidente dhe kishte thelluar krizën në sektor. Kredibiliteti i sektorit ndaj burimeve të financimit ishte shumë i ulët dhe çdo financim arrihej vetëm me garanci sovraane të shtetit. Norma e suksesit të sektorit publik të energjisë elektrike ishte shumë e ulët 4.75 nga 5 (1 është norma më e lartë dhe 5 është norma më e ulët).

Rregullatori (ERE) ishte i dominuar nga politika si në zgjedhjen e tij, ashtu edhe në vendimet që merrte. Cënimi pavarësisht së tij vinte në diskutim të gjithë performancën e sektorit. Vendimet ishin arbitrare dhe të padrejta, si në dëm të operatorëve, ashtu edhe në dëm të përdoruesve fundorë të energjisë elektrike. Politikat e ndjekura prej tij e kishin vënë në diskutim aderimin e ERE në ACER dhe në konflikt të hapur me EnC.

Të gjithë këto tregues të përmbledhur të performancës dhe shumë të tjerë të renditur më sipër në paraqitjen e gjendjes së sistemit para fillimit të reformës në sektorin elektro-energjitik, tregojnë për dështimin e H1.

³⁴ Detyrimi ndaj Cez vetëm për 2014. Ndërkaq, detyrimi i përgjithshëm ishte 13.440 miliard lekë

4.2. Analiza statistikore e të dhënave nga pyetësorët

Ndërkaq, trajtimi statistikor si edhe i rezultateve të arritura nga sektori në zbatim të reformës së nisur në të deri tani do të vërtetojnë suksesin e H2. Mbështetur në pyetësorët dhe përgjigjet e marra nga ana e të intervistuarve, janë ndërtuar dhe regresionet e shumëfusha për secilën prej kategorive të konsumatorëve të marrë në shqyrtim në këtë punim. Më poshtë janë regresionet e shtruar për çdo kategori sipas secilës rubrikë në pyetësorët respektive:

Familiari

$$1. Y(QSph) = b_0 + b_1*Vh + b_2*Ah + b_3*SFh + v(QSph)$$

$$2. Y(SSh) = b_0 + b_1*EBh + b_2*GAh + b_3*COMh + b_4*ISSh + v(SSh)$$

$$3. Y(CSrh) = b_0 + b_1*CCh + b_2*RQsh + b_3*Eth + b_4*CRCap + b_5*NCnQh + v(CSrh)$$

$$4. Y(DSrh) = b_0 + b_1*DfRph + b_2*OBh + b_3*IllCnh + b_4*ETHh + b_5*GQh + b_6*GPIfh + v(DSrh)$$

$$5. Y(TSysh) = b_0 + b_1*EBdgh + b_2*TDrrh + b_3*EPh + b_4*EComph + v(TSysh)$$

$$Y(fam) = f_0 + f_1*Y(Qsph) + f_2*Y(SSh) + f_3*Y(CSrh) + f_4*y(DSrh) + f_5*Y(TSysh) + v(fam)$$

Sa i takon rezultateve nga vlerësimi i çdo regresioni të shtruar sipas grupeve të përdoruesve, kemi sa më poshtë³⁵:

³⁵ Në vlerësimet statistikore janë marrë të pranueshme dhe të kënaqëshme sinjifikanca në intervalet nga 0.2 në 0.8, pra $0.2 < R < 0.8$, për një interval sigurie $p=0.1$

Konsumatorët familiar:

Pyetja 1 - Y(QSp) i vlerësuar P1h (Cilësia e furnizimit për familiarët)

SUMMARY OUTPUT

<i>Regression Statistics</i>	
Multiple R	0,81373263
R Square	0,6621608
Adjusted R Square	0,64725613
Standard Error	0,43947661
Observations	72

<i>ANOVA</i>					
	<i>df</i>	<i>SS</i>	<i>MS</i>	<i>F</i>	<i>Significance F</i>
Regression	3	25,741501	8,58050034	44,4263957	5,1605E-16
Residual	68	13,133499	0,19313969		
Total	71	38,875			

	<i>Coefficients</i>	<i>Standard Error</i>	<i>t Stat</i>	<i>P-value</i>	<i>Loëer 95%</i>	<i>Upper 95%</i>
Intercept	0,9335152	0,29614907	3,15218007	0,00241104	0,34255893	1,52447148
Vh	0,25028139	0,07387847	3,38774484	0,00117551	0,10285921	0,39770358
Ah	0,19357377	0,06185097	3,12968048	0,00257805	0,07015208	0,31699546
Sfh	0,3845244	0,07258074	5,297885	1,3647E-06	0,23969179	0,52935701

Ekuacioni i regresionit:

$$Y(QSp) = 0,9335152 + 0,25028139 \cdot Vh + 0,19357377 \cdot Ah + 0,3845244 \cdot Sfh$$



Variablat të spjeguar:

Y(QSp) - Quality of supply for the households (Cilësia e furnizimit për familiarët)

Vh - Voltage level (Niveli i tensionit)

Ah - Amper level (Niveli i rrymës)

Sfh - Safety of the instalations (Niveli i sigurisë së instalimeve tuaja)



Sikurse dhe vërehet nga rezultatet e regresionit të shumëfishte, rezulton se R^2 është e barabartë me 0,66 si dhe sinjifikanca $F=5,1605E-16$, çka flet për një model krejtësisht të pranueshëm. Njëkohësisht dhe sa i përket nivelit të konfidencës 95% vihet re një p-value nën 0,05. Sa i përket variablave që ndikonjnë më shumë vihet re se niveli i sigurisë së paisjeve ka një rol të qënësishëm në cilësinë e furnizimit, pasuar nga voltazhi tensionit dhe amperazhi i rrymës.

Pyetja 2 - Y(SS) i vlerësuar P2h (Siguria e furnizimit në zonë)

SUMMARY OUTPUT

<i>Regression Statistics</i>	
Multiple R	0,83347123
R Square	0,6946743
Adjusted R Square	0,6764459
Standard Error	0,70136555
Observations	72

ANOVA					
	<i>df</i>	<i>SS</i>	<i>MS</i>	<i>F</i>	<i>Significance F</i>
Regression	4	74,9862313	18,7465578	38,10945	1,3325E-16
Residual	67	32,9582131	0,49191363		
Total	71	107,944444			

	<i>Coefficients</i>	<i>Standard Error</i>	<i>t Stat</i>	<i>P-value</i>	<i>Loëer 95%</i>	<i>Upper 95%</i>
Intercept	-0,1212003	0,3323497	-0,3646769	0,00716501	-0,7845731	0,54217252
Ebh	0,35227124	0,11511987	3,06003858	0,00318164	0,12249102	0,58205146
Gah	0,46818066	0,07370161	6,35238046	2,1435E-08	0,32107163	0,61528969
COMh	0,21297179	0,09539816	2,23245175	0,02893191	0,02255626	0,40338732
ISSh	0,05786171	0,0961312	0,6019036	0,54926978	-0,134017	0,24974039

Sa i përket pyetjes së dytë e cila trajton cilësinë e furnizimit në zonë nga regresioni vëmë re se modeli është i pranueshëm. Kemi një R^2 prej 0,6946743, dhe sinjifikancë të lartë (1,3325E-16). Sipas testit të Anova, vërejmë se variabli ISSh (Ndikimi investimeve në sigurinë e furnizimit) nuk paraqet ndonjë sinjifikancë në intervalin e konfidencës 95% ndaj dhe ky variabël është përjashtuar dhe modeli është rillogaritur duke rezultuar në vlerat e paraqitura më poshtë. Sipas këtyre rezultateve vërehet se ndikimin më të fortë në cilësinë e furnizimit në zonë, mbështetur në përgjigjet e pyetësorëve, e ka variabli Gah (lehtësia e aksesit në rrjetin e shpërndarjes në zonë), pasuar nga Ebh (Orët e ndërprerjes së energjisë në zonë) dhe më pak ndiki variabli m paraqet variabli COMh (njoftimi për ndërprerjet e planifikuara në zonë). Më poshtë jepën rezultatet e modelit pasi është përjashtuar variabli ISSh.

ANOVA					
	<i>df</i>	<i>SS</i>	<i>MS</i>	<i>F</i>	<i>Significance F</i>
Regression	3	74,8080169	24,9360056	51,1717319	2,0306E-17
Residual	68	33,1364275	0,4873004		
Total	71	107,944444			

	<i>Coefficients</i>	<i>Standard Error</i>	<i>t Stat</i>	<i>P-value</i>	<i>Loëer 95%</i>	<i>Upper 95%</i>
Intercept	-0,0363231	0,299536	-0,1212644	0,00903839	-0,6340378	0,56139172
Ebh	0,37675659	0,10718661	3,51495941	0,00078756	0,16286903	0,59064414
Gah	0,46648815	0,07330179	6,36393899	1,9451E-08	0,3202167	0,6127596
COMh	0,22454046	0,09300275	2,41434211	0,0184602	0,03895636	0,41012456

Ekuacioni i regresionit:

$$Y(SSh) = 0,37675659 * EBh + 0,46648815Gah + 0,22454046COMh - 0,0363231$$

Variablat e spjeguar:


Y(SSh) - Security of supply (SS) level in the area (Siguria e furnizimit në zonë)

EBh - Energy break hours (Orët e ndërprerjes së energjisë në zonë)

GAh - Grid access in the area (Lehtësia e aksesit në rrjetin e shpërndarjes në zonë)

COMh - Communication on the works in the grid (njoftimi për ndërprerjet e planifikuara në zonë)

ISSh - Impact of investments in the grid on SS (Ndikimi investimeve në sigurinë e furnizimit)



Pyetja 3 - Y(CSr) i vlerësuar P3h (Niveli i shërbimit ndaj klientëve)

SUMMARY OUTPUT

<i>Regression Statistics</i>	
Multiple R	0,70734749
R Square	0,50034047
Adjusted R Square	0,46248748
Standard Error	0,51679194
Observations	72

ANOVA					
	<i>df</i>	<i>SS</i>	<i>MS</i>	<i>F</i>	<i>Significance F</i>
Regression	5	17,6509	3,53018001	13,2179892	6,3453E-09
Residual	66	17,6268777	0,26707391		
Total	71	35,2777778			

	<i>Coefficients</i>	<i>Standard Error</i>	<i>t Stat</i>	<i>P-value</i>	<i>Loëer 95%</i>	<i>Upper 95%</i>
Intercept	1,4519433	0,42555833	3,41185496	0,00110603	0,60228868	2,30159792
CCh	-0,0937659	0,12586772	-0,7449557	0,4589431	-0,3450689	0,15753714
RQsh	0,23782832	0,09797147	2,42752645	0,01793799	0,04222198	0,43343467
Eth	0,36101746	0,09572398	3,77144217	0,00034936	0,16989836	0,55213655
CrCaph	-0,0801054	0,10199689	-0,7853709	0,43504649	-0,2837488	0,12353798
NCnQh	0,25749883	0,08808663	2,92324548	0,004741	0,08162821	0,43336945

Edhe në këtë rast modeli i ndërtuar është krejtësisht i pranueshëm pasi $R^2=0,50034047$, dhe faktori i sibnjifikancës është $F = 6,3453E-09$. Duke vërejtur vlerat e p-value, konstatojmë se dy nga variablat nuk bien në diapazonin e intervalit të konfidencës 95% pra p-value $>0,05$. Në këtë rast është rillogaritur regresioni duke hequr variablat e padobishme konkretisht CCh (Lehtësia e regjistrimit të ankesave), dhe CrCaph (Kompetenca dhe profesionalizmi i kujdesit ndaj klientëve). Pas pastrimit të këtyre variablave, rezultati statistikave të rekresionit është si më poshtë:

ANOVA					
	<i>df</i>	<i>SS</i>	<i>MS</i>	<i>F</i>	<i>Significance F</i>
Regression	3	17,0848518	5,69495062	21,2861111	7,8271E-10
Residual	68	18,1929259	0,26754303		
Total	71	35,2777778			

	<i>Coefficients</i>	<i>Standard Error</i>	<i>t Stat</i>	<i>P-value</i>	<i>Loëer 95%</i>	<i>Upper 95%</i>
Intercept	1,23599851	0,39635303	3,11842828	0,00266558	0,44508834	2,02690867
RQsh	0,17942942	0,08830669	2,03188936	0,04607425	0,00321617	0,35564268
Eth	0,3018749	0,08442193	3,57578776	0,00064836	0,13341356	0,47033624
NCnQh	0,25435184	0,08670897	2,93339722	0,00456649	0,08132679	0,42737688

Ekuacioni i regresionit:

$$Y(\text{CSrh}) = 1,23599851 + 0,17942942 * \text{RQsh} + 0,3018749 * \text{Eth} + 0,25435184 * \text{NCnQh}$$

Vihet re se variabli i cili ndiokon më shumë në nivelin e shërbimit ndaj klientëve është Eth (Etika e sjelljes ndaj klientëve) i ndjekur nga NCnQh (Cilësia e shërbimit për lidhjet e reja) dhe në fund RQsh (Shpejtësia dhe saktësia e përgjigjes ndaj ankesave).

Spjegimi i variablave:

Y(CSrh) - Customer service level (Niveli i shërbimit ndaj klientëve)


CCh - Customer care quality (Lehtësia e regjistrimit të ankesave)

RQsh - Reply quality to the customers (Shpejtësia dhe saktësia e përgjigjes ndaj ankesave)

Eth - Ethics level in customer service (Etika e sjelljes ndaj klientëve)

CRCaph - Customer relations competency (Kompetenca dhe profesionalizmi i kujdesit ndaj klientëve)

NCnQh - New connections service quality (Cilësia e shërbimit për lidhjet e reja)



Pyetja 4 - Y(DSr) i vlerësuar P4h (Shërbimi i shpërndarjes)

SUMMARY OUTPUT

<i>Regression Statistics</i>	
Multiple R	0,79396428
R Square	0,63037928
Adjusted R Square	0,6010443
Standard Error	0,50774766
Observations	69

ANOVA					
	<i>df</i>	<i>SS</i>	<i>MS</i>	<i>F</i>	<i>Significance F</i>
Regression	5	27,7001446	5,54002891	21,488998	1,7562E-12
Residual	63	16,2418844	0,25780769		
Total	68	43,942029			

	<i>Coefficients</i>	<i>Standard Error</i>	<i>t Stat</i>	<i>P-value</i>	<i>Loëer 95%</i>	<i>Upper 95%</i>
Intercept	0,01843263	0,46852896	0,03934149	0,00968743	-0,9178478	0,95471304
DfRph	0,07205322	0,09201727	0,7830402	0,04365372	-0,1118286	0,25593505
Obh	0,18074854	0,07118757	2,53904641	0,01359727	0,03849154	0,32300554
IIICnh	0,10728355	0,05063884	2,11860201	0,03807392	0,0060899	0,2084772
ETHh	0,73181207	0,10871772	6,73130437	5,8619E-09	0,51455704	0,9490671
GQh	-0,0902932	0,06931283	-1,3026911	0,19742206	-0,2288038	0,04821743

aksesi në rrjet ka qenë një variabël shumë penalizues në vlerësimet e tyre duke marrë në konsideratë rëndësinë që ky proces ka për jo-familiarët në Shqipëri. Ky grup konsumatorësh vlerësojnë më shumë rëndësi edhe kryerjen e investimeve në rrjetin e shpërndarjes sim jet për rritjen e eficiencës së rrjetit dhe sigurinë e cilësinë e furnizimit me energji elektrike. Nga ana tjetër fuqizimi i rrjetit do të mbështeste më mirë edhe zbatimin e reformave në sektorin e energjisë elektrike, pasi mundëson akoma më shumë zbatimin e modelit të ri të tregut, derregullimin e tij dhe liberalizimin e çmimit të energjisë elektrike. Kjo del akoma më qartë si korelacion në katëgorinë 5 të variblave të performancës, në sistemi tariforë. Një tregues me rëndësi pothuaj të barabartë për të tre grupet e konsumatorëve është variabli i nëshërbimit ndaj klientëve/konsumatorëve. Perceptimi i konsumatorëve në përgjithësi për këtë variabël është i mirë (54.3%) dhe shumë i mirë (34.3%), me ndryshime sinjifikative ndërmjet qarqeve, ($p=0.04$). Ky vlerësim është më i lartë në qarqet Durrës, Elbasan, Tiranë dhe Vlorë. Kjo korrespondon edhe me performancën më të lartë të këtyre zonave elektrike në raport me pjesën tjetër të territorit të vendit edhe bazuar në vlerësimet e performancës të bëra nga ana e vetë OSHEE. Po kështu, shumica e pjesëmarrësve në pyetësor (55.7%) referojnë se ankesat i regjistrojnë lehtësisht, ndërsa (24.3%) e vlerësojnë këtë shërbim si shumë të mirë, por me ndryshime sinjifikante ndërmjet qarqeve më një siguri ($p=0.01$). Numri i të intervistuarve është $n=70$. Nga ana tjetër, nuk perceptohet njësoj shpejtësia dhe saktësia e përgjigjeve. Shumica e pjesëmarrësve (42.9%) e vlerësojnë të mirë shpejtësinë dhe saktësinë e përgjigjes për ankesat e tyre, ndërsa 25.7% e vlerësojnë mesatarisht, pa ndryshim sinjifikant ndërmjet qarqeve ($p=0.1$), F-ratio =1.7. Kjo vlerësohet të ketë këtë devijim nga qëndrimi i mësipërm lidhur me faktin se jo të gjithë janë të kënaqur me përgjigjen e marrë, pra kur vlerësohet se nuk kanë të drejtë në pretendimin e tyre. Në këtë proces komunikimi etika e sjelljes në zyrat e shërbimit ndaj klientëve vlerësohet e mirë nga shumica e pjesëmarrësve (41.4%) dhe shumë e mirë nga 37.1% e tyre, me ndryshim sinjifikant ndërmjet qarqeve ($p=0.01$). Gjithashtu, kompetenca dhe profesionizmi i punonjësve në shërbim ndaj klientëve nga shumica e pjesëmarrësve vlerësohet e mirë (40%) dhe shumë e mirë (38.6%), pa ndryshim sinjifikant ndërmjet qarqeve ($p=0.1$). Sa i takon shërbimit në procesin e lidhjeve të reja nga shumica e pjesëmarrësve vlerësohet i mirë (44.9%) dhe shumë i mirë (13%), me ndryshim sinjifikant ndërmjet qarqeve ($p<0.01$). Standardi teknik për lidhjet e reja nga shumica e pjesëmarrësve vlerësohet i mirë (53.6%) dhe shumë i mirë (11.6%), me ndryshim sinjifikant ndërmjet qarqeve ($p<0.01$).

Sa i takon variablit që lidhet me nëshërbimin e shpërndarjes së energjisë elektrike nga shumica e pjesëmarrësve vlerësohet i mirë (48.6%) dhe shumë i mirë (28.6%), me ndryshim sinjifikant ndërmjet qarqeve ($p=0.04$). Numri i të intervistuarve është $n=70$. Në këtë vlerësim të përgjithëshëm treguesi i riparimit të difekteve nga shumica e pjesëmarrësve vlerësohet i mirë (40%) dhe shumë i mirë (28.6%), me ndryshim sinjifikant ndërmjet qarqeve ($p=0.01$). Saktësia e faturimit nga shumica e pjesëmarrësve vlerësohet e mirë (51.5%) dhe shumë e mirë (19.1%), me ndryshim sinjifikant ndërmjet qarqeve ($p=0.01$). Shumica e pjesëmarrësve referojnë se manipulimi i rrjetit të shpërndarjes është i vështirë, por me ndihmën e një punojësi të korrumpuar të OSHEE (35.7%) mund të manipulohet, dhe i vështirë (27.1%) me ndryshim sinjifikant ndërmjet qarqeve ($p<0.01$). Sa i takon vjedhjes dhe abuzimit me energjinë shumica e pjesëmarrësve referojnë që nuk e dinë nëse vidhet energjia elektrike në zonën e tyre (40%), ndjekur nga nëspakò (18.6%) dhe nëaste sporadikeò (17.1%), me ndryshim sinjifikant ndërmjet qarqeve ($p<0.01$). Këto perceptime lidhen shumë edhe me faktin se shumica e pjesëmarrësve e gjykojnë të mirë

cilësinë e rrjetit dhe protokollet e aksesit në të të një standardi të lartë (51.4%) dhe shume e mirë (32.9%), me ndryshim sinjifikant ndërmjet qarqeve me një sipuri prej $p=0.05$. Perceptimi i shumicës së pjesëmarrësve që referojnë se niveli i investimeve në rrjet ndikon mjaft (41.2%) dhe shumë (36.8%) në performancën e rrjetit, me ndryshim sinjifikant ndërmjet qarqeve ($p=0.02$), tregon se komunikimi i reformës për planet e veprimit për zbatimin e saj dhe implementimi i saj ka rritur vlerësimin e tyre për këtë reform dhe vetëdijen për ndryshimet që ajo do të sjellë.

Sic kemi përmendur edhe më lart, një nga elementët më të rëndësishëm të reformës dhe të vlerësimit të performancës nga ana e konsumatorëve/klientëve është ndryshimi i sistemit të tarifimit në çdo nivel, por veçanërisht në nivel fundor. Shumica e pjesëmarrësve e gjykojnë sistemin e ri tarifor të energjisë elektrike në Shqipëri si më ekonomik (29.4%), ndërsa 25% e tyre referojnë që nuk ka ndryshim në efekt fundor, me ndryshim sinjifikant ndërmjet qarqeve ($p<0.01$). Numri i të intervistuarve është $n=68$. Sistemi i ri tarifor bazuar në aksesin në rrjet me baze tensioni dhe i cili reflekton kostot për ofrimin e energjisë ndaj përdoruesve nga shumica e pjesëmarrësve gjykohet si i drejtë (35.3%) dhe racional (23.5%) me ndryshim sinjifikant ndërmjet rretheve ($p<0.01$). Perceptojnë më mirë këtë sistem konsumatorët/klientët në qarqet e Elbasanit dhe Tiranës, të cilët përbëjnë edhe më shumë se 55% të totalit të konsumatorëve në vend. Gjithashtu, ndryshe nga reagimet konsumatore në të kaluarën ndaj tarifave sektoriale shpesh herë në mënyrë arbitrare të padrejta dhe të pabazuara në kostot për ta patur energjinë, si edhe në shumicën e konsumatorëve familiar të manipulueshme për të mos paguar çmimin e lartë të energjisë elektrike prej 13.5 lek/kËh për konsumet normale dhe të pafavorizuara, të cilat në total prodhuan korrupsion në cdo nivel konsumi si nga përdoruesit ashtu edhe nga përfaqësuesit e sistemit, detyrime të papaguara të cilat aktualisht paraqiten shpesh të papërbalueshme për t'u paguar nëse nuk futen në aktmarrvëshje për shlyrje borxhi me këste pagesash favorizuese, shumica e pjesëmarrësve referojnë që kosto e konsumit të energjisë elektrike është e drejtë dhe e përballueshme (35.3%), ndërsa 26.5% e rëndësishme dhe 20.6% mendojnë se është e ulët dhe e parëndësishme, me ndryshim sinjifikant ndërmjet qarqeve ($p<0.01$). Kjo korrespondon edhe me analizat që unë kam bërë lidhur me rëndësinë e energjisë elektrike si kosto për disa grupe biznesesh të pasqyruara në grafikët e mëposhtëm:


Grafiku. 1. Ndikimi i rritjes së çmimit të energjisë elektrike në kosto në disa sektorë



	Tregeti	Bujqesi	Buxh. Spitale	Buxh. Tjere	Indus.	Rest. Flkok. Spa	Sh. Tjera	Furra buke
Energjia ne strukturen e koston	1%	1%	3%	3%	2%	7%	2%	10%
Rritja e tarifes	0.15	0.15	0.15	0.15	0.15	0.15	0.15	0
Rritja energjise ne kosto	0.0015	0.0015	0.0045	0.0045	0.0033	0.0105	0.00255	0
Rritja energjise ne cdo 100 leke kosto	0.15	0.15	0.45	0.45	0.33	1.05	0.255	0

Grafiku. 2. Ndikimi i rritjes së çmimit të energjisë elektrike disa produkte ose shërbime

Produkte që kushtojnë rreth 100lekë	kafe	10 vezë	buka 0.7kg	150 gr mish	miell	0.5 l vaj	0.5 kg sheqer	0.5kg oriz	5 lit ujë	1 lit ilaç rroba	qumësht
çmimi	60	150	100	110	67	100	90	50	60	200	120
Pesha e rritjes energjisë në kosto	0.005	0.003	0	0.003	0.0066	0.0066	0.0066	0.003	0.0066	0.0066	0.0066
Efekti për rritje çmimi në lek	0.3	0.45	0	0.33	0.4422	0.66	0.594	0.15	0.396	1.32	0.792



Ndërkaq, liberalizimi i tregut dhe i tarifave të energjisë elektrike nga ana e konsumatorëve jo-familiarë shihet nga shumica e pjesëmarrësve si një veprim që do të bëjë që tarifa të jetë më e ulët (52.9%) se aktualisht, ndërsa 22.1% e tyre gjykojnë që tarifa nuk do ndryshojë, me ndryshim sinjifikant ndërmjet qarqeve ($p < 0.01$). Nuk vërehet ndryshim sinjifikant i pikëzimit mesatar në perceptimin e përdoruesve të energjisë elektrike ndërmjet qarqeve, $F\text{-ratio} = 1.9$, kur $p = 0.09$. Po kështu vështirësia për të gjetur furnizues për energji elektrike na rast të derregullimit dhe liberalizimit të tregut të energjisë elektrike nga shumica e pjesëmarrësve shihet si mundësi për rritjen e sigurisë së furnizimit (41.4%) dhe siguri dhe eficiencë e lartë furnizimi (18.6%), me ndryshim sinjifikant ndërmjet rretheve ($p < 0.01$). Nga pikëpamja e eficiencës që mund të sjellë derregullimi shumica e pjesëmarrësve gjykojnë se do të kenë çmime energjie elektrike më të ulta (40%) dhe shumë më të ulëta (18.6%), me ndryshim sinjifikant ndërmjet rretheve ($p < 0.01$). Në lidhje me perceptimin e subjekteve buxhetore dhe jo-buxhetore se sa është e mundur për këta klientë të blejnë energji në tregun e parregulluar në kohë reale nën ligjin aktual të Prokurimeve Publike, duket qartë se ka shumë mos kuptim nga ana e tyre i elementëve të reformës dhe efekteve që ajo mund të sjellë në menaxhimin dhe administrimin e institucioneve të tyre dhe në kostot e ofrimit të shërbimeve dhe të mirave publike nga ana e tyre. Shumica e

pjesëmarrësve gjykojnë që është e mundur, por kërkohen rregullime (20.9%), është e lehtë dhe mund të arrihet sigurim në kohë i energjisë (20.9%) dhe 26.9 janë pa përgjigje dhe krejtësisht në dyshim për efektin e sigurisë së furnizimit me energji elektrike. ($p=0.01$). 53.6% e të intervistuarve nga ky grup mendojnë pa ndonjë arsye ose analizë të kryer lidhur me kostot që energjia elektrike përfaqëson për institucionin e tyre se ajo është e shtrejtë dhe shume e shtrejtë. Kjo konfirmon edhe një herë sa larg reformës janë qëndrimet e konsumatorëve të këtij grupi.

Të dhënat në studim rezultojnë të pranueshme përsa i përket autokorelacionit dhe po kështu multikolinearitetit dhe vërtetojnë që modelet e regresioneve janë zgjedhur drejt dhe po kështu regresioni i cili tregon lidhje të fortë dhe të qëndrueshme të pesë variablave kryesorë me variablin e performancës së sektorit nën efektin e reformës së ndërmarrë me të dy fazat e saj 2015-2017 dhe 2018-2022.

KAPITULLI I PESTË - Konkluzione të studimit

Nga ky studim relativisht i thelluar i situatës së përgjithëshme në sektorin e energjisë elektrike, në veçanti atë në nivelin e shpërndarjes, nëpërmjet një ekranizimi të thellë të elementëve të saj dhe të performancës së tyre në vite, duke u bazuar gjithashtu edhe në rezultatet e pyetësorit të organizuar për tre grupe të mëdha konsumatorësh të përzgjedhur nga gjashtë zona elektrike, përfaqësues, për moshë, gjini dhe punësim. U arritën disa konkluzione. Në tabelën e mëposhtme jepet një përmbledhje e pyetësorëve të grumbulluar sipas rretheve dhe kategorive të përcaktuara në studim.

Tabela. 1. Shpërndarja e të intervistuarve sipas qarqeve

Qarqet	Familiar	Privat	Buxh. & Jobuxh.
(1) DURRËS	19	15	7
(2) ELBASAN	20	13	7
(3) FIER	19	13	7
(4) SHKODËR	20	13	7
(5) TIRANË	100	109	34
(6) VLORE	20	12	8

Çfar mund të rendisim si konstatime nga studimi i materialeve desk dhe gjetje të studimit janë si më poshtë:

- Situata e menaxhimit dhe performanca në sistemin elektro-energjitik para vitit 2014, viti i fundit para fillimit të reformës, gjatë të cilës u ndërmorën disa vlerësime dhe studime ishte shumë e rëndë si nga këndvështrimi ekonomik, ai juridik, ashtu edhe sa i takon gjendjes tekniko-fizike të aseteve të tij.
- Keqmenaxhimi i sektorit, si dhe privatizmi i dështuar i shpërndarjes, bëri që teguesit financiar të përkeqësoheshin deri në atë masë sa sistemi të rrezonte shpalljen e falimentimit. . Borxhi i OSHEE në Dhjetor të 2014 për hua të pa shlyera ishte rreth 25 miliard lekë. Detyrime të pashlyera për shkak të aktivitetit të shpërndarjes ishin afërsisht 90 miliard lekë, kryesisht ndaj KESH, OST dhe Tatime e Taksa. Totali i debisë së përdoruesve të energjisë ndaj OSHEE ishte 130 miliard lekë (rreth 78% e totalit të përdoruesve të energjisë kishin maturuar një detyrim më shumë se gjashtë Fatura pa paguar), vlera e aseteve të kompanisë ishte -78 miliard lekë dhe vlera e inventarit të aseteve fizike të saj ishte rreth 26 miliard lekë. Llogaritë korrente ishin me teprica negative.
- Struktura organizative dhe menaxheriale e OSHEE e cila sapo ishte krijuar në 4 Dhjetor 2014 ishte krejtësisht i papërshtatshëm dhe nuk krijonte premisa për një performancë të mirë të sektorit. Struktura organizative karakterizohej si nga pamjaftueshmëria në staf, por dhe në marrëdhënie të paqarta menaxheriale, duke krijuar në këtë mënyrë vështirësi në menaxhim.

- iv. Struktura organizative e OSHE nuk garantonte menaxhimin e mbulimit total të rrjetit të shpërndarjes me njerëz dhe shërbime dhe po kështu tregun e furnizimit me energji elektrike duke stimuluar një abuzim dhe vjedhje të pazakontë të energjisë elektrike.
- v. Edhe KESH si pasojë e menaxhimit të dobët, ishte gjithashtu në një situatë financiare shumë të vështirë. Totali i borxheve të maturuara në vite nga financime dhe kredi ishte 73 miliard lekë nga të cilat rreth 36.5 miliard lekë ishin overdraft-e me kosto shumë të lartë të financuara nga rreth 15 linja kredie nga 11 banka të nivelit të dytë. Praktikisht mundësia e rifinancimit ishte zero. KESH kishte një total debie të papaguar nga OSHEE dhe OST prej rreth 53 miliard lekë. Situata e organizimit të brendshëm ishte larg së qeni në standard të organizimit të korporatave.
- vi. KESH ishte ngarkuar gjithashtu edhe me rreth 3.3 miliard detyrime financiare të qeverive të mëparëshme për përmbytjet poshtë derdhjes së kaskadës së Drinit, nga të cilat mbetën të paguajtëshme rreth 760 milion lekë. Dëmi i vlerësuar nga privatizimi i shpërndarjes u vlerësua rreth 413 milion Euro për gjithë periudhën e privatizimit.
- vii. Një vështirësi tjetër e KESH ishte dhe menaxhimi për shlyerjen e kredive të marra për ndartimin e TEC Vlora i cili nuk është vënë asnjëherë në punë për arësye difekti qysh në instalim, por edhe për inefficiencë në prodhimin e energjisë me çmime konkurruese.
- viii. Menaxhimi i OST nuk ndryshonte nga ai i OSHE dhe KESH dhe si rrjedhojë gjëndja financiare e kësaj ndërmarrje ndodhej gjithashtu në vështirësi, me një total debie për arketim rreth 10.8 miliard lekë, me një arbitrazh të humbur në nivel ndërkombëtar prej rreth 12 milion Euro, me një borxh të papaguar nga detyrimet e kredive të marra prej rreth 34 miliard lekë, me një status të pakonsoliduar si operator tregu në Shqipëri përshkak të mos certifikimit nga ERE dhe statusit vëshgues në ENTSO-E.
- ix. Kuadri ligjor i funksionimit të sektorit ishte i parregulluar dhe jo përafruar me direktivat e BE. E gjithë paketa ligjore ishte për t'u ribërë për shkak të mospërputhjes pothuaj totale me direktivën europiane për energjinë dhe me paketën e tretë të energjisë, si edhe me mjaft rregullime të tjera ndërkombëtare të lidhura me mbrojtjen e mjedisit dhe të drejtat e konsumatorëve.
- x. Performanca e ERE ishte në një gjendje të amullt dhe e zotëruar politikisht, duke marrë vazhdimisht vendime diskriminuese dhe të paqarta që e kishin futur sistemin në kolaps totale.
- xi. Menaxhimi i ndërtimit të burimeve të reja të rinovueshme të energjisë ishte krejtësisht jashtë kontrolli.
- xii. Detyrime të papaguara për sistemin nga institucionet jasht tij për më shumë se 20 milirad lekë, sidomos ujësjellës e kanalizime, bashki, spitale, institucione të riedukimit etj.
- xiii. Menaxhimi i shitjeve nuk reflekton nevojat e sektorit për të perftuar nga avantazhet e ekonomisë së shkallës. Tarifa e përgjithëshme e shitjes së energjisë elektrike është relativisht e pranuar nga ana e përdoruesve fundorë, megjithë deformimin që ajo ka midis familiarëve dhe jo-familiarëve.

- xiv. Performanca e furnizimit në kuadrin e reformës së zbatuar konsiderohet gjërësisht e mirë nga përdoruesit, sidomos ata jo-buxhetorë.
- xv. Performanca e rrjetit të shpërndarjes e cila lidhet edhe me standardet teknike të furnizimit të saj tek përdoruesit fundorë, nuk konsiderohet shumë e lartë nga përdoruesit familiarë, ndërsa është e mirë dhe shumë e mirë nën vlerësimin e përdoruesve jo-familiarë.
- xvi. Menaxhimi i aksesit në rrjet rregullohet nwpwrmjet rregullores së aksesit në rrjet e cila është shumë e përmirësuar dhe e ngritur në standardet e rajonit dhe shumë pranë atyre europiane.
- xvii. Performanca e sigurisë së furnizimit, është e lartë për të gjithë konsumatorët. Kjo siguri ulet pak kur kemi parasysh shpesh mungesën e komunikimeve publike në rastet e ndërprerjeve të lajmëruara për arësye difektesh ose ndërhyrjesh në rrjetin e shpërndarjes. Në përgjithësi, ndërprerjet e energjisë për shkak të ndërhyrjeve për përmirësimin e rrjetit janë të vogla ose zero, pasi grupi ka marrë masa të përdorë struktura zëvendësuese për të gjithë periudhën e punimeve.
- xviii. Lehtësia e aksesit në rrjet është relativisht e lartë dhe ka përmirësim shumë të madh me periudhën para reformës. Ka gjithashtu një ulje të theksuar të rasteve të ankimeve të përdoruesve për vonesa në aksesin në rrjetin e shpërndarjes.
- xix. Menaxhimi i shërbimit ndaj konsumatorëve, pavarësisht statusit të përdorimit, vlerësohet i mirë dhe shumë i mirë në përgjithësi dhe po kështu edhe niveli i reagimit ndaj ankesave dhe i zgjidhjes së tyre.
- xx. Performanca që ka të bëjë me shpejtësinë dhe cilësinë e nderhyrjes dhe riparimit të difekteve në shpërndarje në çdo nivel tensioni vlerësohet e mirë. Investimet e bëra e kanë bërë mjaft të vështirë abuzimin me energjinë dhe manipulimin e rrjetit.
- xxi. Ka një paqartësi relativisht të lartë lidhur me liberalizimin etregut të energjisë elektrike dhe pasojat që ai mund të sjellë lidhur me kostot e saj dhe me sigurinë e furnizimit. Ndryshon disi perceptimi kur i referohemi përdoruesve jo-familiarë lidhur me një ulje të mundëshme të kostove të furnizimit nëse tregu vazhdon të derregullohet. Në këtë aspekt, rishikimi i VKM 08 dt.14. Janar 2015 për zbutjen e efekteve të reformës në energji elektrike lidhur me varfërimin e konsumatorëve dhe mbrojtjen e tyre është i domosdoshëm.

Nën këto kushte të vështira, ajo që nevojitej ishte reformimi dhe ristrukturimi total i sistemit dhe sektorit publik të energjisë elektrike.

KAPITULLI I GJASHTË - Rekomandime e Përfundime

Mbështetur në studimin e bërë si dhe në konkluzionet e listuara më lart në këtë studim, rekomandoj sa më poshtë:

Në planin organizativ dhe menaxherial do të rekomandonim si më poshtë:

Për një menaxhim më të mirë dhe performanc më të lartë të sektorit, është shumë e rëndësishme të vazhdojë procesi i reformimit të sektorit si dhe masat e parashikuara në dy dokumentet më të rëndësishëm të tij, Plani i Konsolidimit Financiar të Sektorit Publik të Energjisë Elektrike dhe Plani Strategjik i Masave për Reformimin e Sektorit Energjitik.

Performanca e sektorit do të përmirësohet ndjeshëm me përfundimin plotësisht të procesit të ndarjes së OSHEE dhe i konsolidimit nga ana funksionale dhe financiare, por edhe juridike i tre ndërmarrjeve bija të saj; Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Furnizuesi Shtetëror Universal dhe Furnizuesi i Tregut të Lirë. OSHEE Group të garantojë plotësisht ndarjen edhe në realitet duke garantuar funksionimin e pavarur të tyre në një sistem menaxhimi korporate tre tier - bord drejtorësh, këshill administrimi, ortak OSHEE Group, këshilli mbikqyrës i OSHEE Group, dhe asambleja e ortakëve e përfaqësuar nga Ministria përgjegjëse për energjinë.

Për një menaxhim më të mirë të situatave jo të favorshme hidrike rekomandohet garantohet furnizimi me energji elektrike i shpërndarjes dhe furnizimit në periudha të vështira të prodhimit të energjisë elektrike për shkak të thatësisë, duke krijuar një fond të përhershëm kontigjence për këtë qëllim. Kjo është edhe kërkesë e ligjit për miratimin e kredisë së Bankës Botërore të vitit 2015.

Për një performancë më të mirë të furnizimit me energji, rekomandohet dhe diversifikimi i burimeve të furnizimit me energji elektrike në vend nga burime të tjera përveç burimeve hidrike. Qeverija duhet të vazhdojë nxitjen e përdorimit të këtyre burimeve me politika incentivuese dhe me lehtësim procedurash për licensimin e tyre.

Të rriten kapacitetet prodhuese të KESH nëpërmjet ndërtimit të HEC Skavica, vënies në punë me gas natyror të TEC Vlora, si edhe përmes taktikave novative por dhe teknologjive që i mbështesin ato për optimizimin dhe rritjen e prodhimit në kaskadën ekzistuese.

Të vazhdohet me kompletimin e procesit të rehabilitimit dhe ngritjes së eficiencës në kaskadën e lumit Drin nga KESH.

Të vazhdohet me ritem të lartë me programet e investimeve në rrejtin e shpërndarjes duke rritur sigurinë dhe cilësinë e furnizimit me energji elektrike të të gjithë konsumatorëve.

Në nivelin institucional/qeveriës qendrore të rekomandonim si më poshtë:

Të përmirësohet menaxhimi i tregut nëpërmjet implementimit të modelit të ri të tregut i përcaktuar në ligj qysh në 2015 me ligjin 43/15 si edhe në zbatim të vkm të ndryshuar për modelin e ri të tregut, 519/2016, duke thelluar liberalizimin e tregut deri në konsumatorin e fundit. Të bëhet sa më parë funksionale ALPEx, ose tregu i ditës në avancë, duke pajtuar sa më shpejt service provider dhe të filloje dhe përfundojë test ii thatë i saj brenda vitit 2021.

Të amendohet sa më parë ligji për mbështetjen e prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme duke i hapur rrugë akoma më shumë proceseve konkurruese për ndërtimin e impianteve të reja të prodhimit në diell dhe ere në të gjithë kapacitetet.

Përcaktimi i një sistemi mbështetës që nxit konkurrencen dhe orientimin e prodhuesve dhe konsumatoreve drejt tregut të parregulluar (amendimi i VKM 244/2016, 519/2016, 349/2018, 822/2015 etj), si edhe hartimi i VKM-ve për kontratën për diferencë dhe për rregullat e balancimit të tregut të energjisë elektrike.

Të thellohet integrimi i tregjeve të energjisë elektrike me Kosovën drejt bashkimit përfundimtar të tyre. Kjo do të rriste performancën e sektorit dhe do të zgjeronte tregun si dhe do të bënte të mundur uljen e çmimeve të energjisë si edhe plotësim më të diversifikuar të nevojës për energji në të dy vendet.

Të plotësohen të gjithë mospërputhjet ligjore në sektorin e energjisë elektrike me paketën e tretë të energjisë dhe gjithë ndryshimet që ajo ka pësuar sëfundmi.

Të rriten kapacitetet hyrëse të energjisë në vend nëpërmjet zgjerimit të kapaciteteve të transmetimit ndërkufitar por edhe të përmiësimit dhe fuqizimit të rrjetit të brendëshëm të transmetimit me investime të reja.

Të mos krijohen borxhe të reja në sektor si midis operatorëve publike të tregut, ashtu edhe me palët e tyre të treta për shërbime apo detyrime të papaguara në kohë.

Të intensifikohet komunikimi me publikun i të gjitha masave të reformës por dhe i efekteve që ato sjellin.

Të përfundohet procesi i amendimit të skemës së mbështetjes së grupeve vulnerable për efektet që sjell reforma.

Të përpunohet strategjia e zhvillimit të të treja ndërmarrjeve të mëdha publike të sistemit në kuadrin e strategjisë kombëtare së energjisë.

Rekomandimet e mësipërme shërbejnë si një roadmap për sektorin e energjisë elektrike në mënyrë që të përmirësohet menaxhimi dhe performance e kwtij sektori. Një pjesë e këtyre rekomandimeve i shërbejnë dhe politikbërësve në përcaktimin e politikave më të mira

incentivuese të këtij sektori, për një performancë më të mirë dhe integrim më të mirë dhe në rrjetin rajonal të furnizimit të energjisë.

Aneksi

Pyetësi për përdoruesit familjarë

Nr	Pyetja	Shkalla Likert					
		>> Keq	Keq	Mesatar	Mirë	>> Mirë	Nuk e di
		1	2	3	4	5	
1	Si e vlerësoni cilësinë e furnizimit me energji elektrike krahasuar me periudhën para vitit 2014?						
1/a	Si është niveli i tensionit në ndërtesën tuaj?						
1/b	Si është niveli i rrymës elektrike që furnizohet?						
1/c	Sa i sigurtë (safe) është rrjeti i energjisë elektrike i instaluar në ndërtesën tuaj?						
2	Si e gjykoni sigurinë e furnizimit me energji elektrike në zonën tuaj?						
2/a	Si është situata me ndërprerjet e energjisë elektrike në ndërtesën tuaj (1>3orë/ditë; 2=0-3orë/ditë; 3=disa ndërprerje të shkurtra/muaj; 4=ndonjë ndërprerje e lajmëruar në vit; 5=nuk ndërpritet energjia elektrike)						
2/b	Si e gjykoni aksesin në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike në zonën tuaj?						
2/c	A lajmëroheni për ndërprerje të planifikuara të energjisë elektrike në zonën tuaj? (1=fare; 2=rallë; 3=një herë në ditë në media lokale; 4=2-3 herë në ditë në media lokale; 5=njoftohemi me siguri në media kombëtare disa herë/ditë ose me njoftim me shkresë nga OSHEE)						
2/d	Sa ndikon niveli investimeve në sigurinë e furnizimit me energji elektrike? (1=aspak - duhen eliminuar vjedhjet jo të prishen para të tjera; 2=pak - duhet luftuar korrupsioni brenda OSHEE; 3=ndikim normal në uljen e humbjeve)						

	dhe rritjen e sigurisë së furnizimit; 4=ndjeshëm - rrjeti aktual është i amortizuar; 5=shumë - duhet investuar smart që të merret efekti maksimal)						
3	Si e vlerësoni shërbimin e OSHEE ndaj klientëve?						
3/a	Sa lehtësisht i regjistroni ankesat?						
3/b	Si e vlerësoni shpejtësinë dhe saktësinë e përgjigjes për ankesat tuaja?						
3/c	Si është etika e sjelljes në zyrat e shërbimit ndaj klientëve?						
3/d	Si e vlerësoni kompetencën dhe profesionizmin e punonjësve në zyrat e shërbimit ndaj klientëve?						
3/e	Si e vlerësoni cilësinë e shërbimit në procesin e lidhjeve të reja?						
4	Si e vlerësoni shërbimin e shpërndarjes së energjisë elektrike?						
4/a	Riparimi difekteve?						
4/b	Si është saktësia e faturimit?						
4/c	A është e mundur të manipulohet rrjeti i shpërndarjes? (1=lehtësisht po; 2=po; 3=me ndihmën e një elektrikisti; 4=e vështirë por me ndihmën e një punojësi të korruptuar të OSHEE; 5=shumë e vështirë)						
4/d	A vidhet energjia elektrike në zonën tuaj? (1=shumë - ne paguajmë për vjedhësit; 2=vidhet atje ku rrjeti është i amortizuar; 3=kemi dëgjuar që është e mundur; 4=raste sporadike; 5=aspak)						
4/e	Si e gjykon cilësinë e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në zonën tuaj?						
4/f	Sa është e lidhur performanca e rrjetit me nivelin e investimeve në rrjet? (1=aspak; 2=pak; 3=nuk ndikon; 4=ndikon mjaft; 5=ndikon shumë)						

5	Si e gjykoni sistemin e ri tarifor të energjisë elektrike ne Shqipëri? (1=shumë më të shtrejtë se sistemi i vjetër; 2=më i shtrejtë se sistemi i vjetër; 3=nuk ka ndryshim në efekt fundor; 4=më ekonomik; 5=shumë më ekonomik)						
5/a	Sa përqind të buxhetit tuaj familiar zë konsumi i energjisë elektrike? (1=peshë shumë të rëndësishme - mbi 50%; 2=i rëndësishëm - 30-50%; 3=i përballueshëm - 10-30%; 4=i ulët - 5-10%; 5=i parëndësishëm - nën 5%)						
5/b	Si e gjykoni liberalizimin e tarifave të energjisë elektrike? (1=tarifa do të jetë shumë e lartë; 2=tarifa do të jetë pak më e lartë; 3=tarifa nuk do ndryshojë si shifër mesatare vjetore; 4=tarifa do të jetë më e ulët; 5=tarifa do të jetë shumë më e ulët)						
5/c	Si është energjia elektrike ne krahasim me energjitë e tjera? (1=shumë e shtrenjtë; 2=e shtrenjtë; 3=njësoj; 4=e lirë; 5=shumë e lirë)						
5/d	Sa energji elektrike harxhoni mesatarisht cdo muaj? (1=deri 200kËh; 2=200-350kËh; 3=350-400kËh; 4=400-600kËh; 5=mbi 600kËh)						
6	Sa janë të ardhurat tuaja familiare mujore? (mijë lekë)	- 50		- 100		> 100	
7	Sa është sipërfaqja juaj e banimit? (m ²)	-60		-100		> 100	

Pyetësi për përdoruesit jo-familiarë privatë

Nr	Pyetja	Shkalla Likert					
		>> Keq	Keq	Mesatar	Mirë	>> Mirë	Nuk e di
		1	2	3	4	5	
1	Si e vlerësoni cilësinë e furnizimit me energji elektrike krahasuar me periudhën para vitit 2014?						
1/a	Si është niveli i tensionit në ndërtesën tuaj?						
1/b	Si është niveli i rrymës elektrike që furnizohet?						
1/c	Sa i sigurtë (safe) është rrjeti i energjisë elektrike i instaluar në ndërtesën tuaj?						
1/d	Si është ngarkesa e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në fidrin ku furnizoheni? (1=shumë e mbingarkuar; 2=e mbingarkuar-nuk i përgjigjet fuqisë së instaluar në zonë në cdo orë të ditës; 3=brenda parametrave aktualë të rregullores; 4=e pranueshme - garanton funksionim normal të fuqisë së instaluar në zonë; 5=brenda standardeve moderne - garanton një rritje të biznesit në zonë për një afat të gjatë kohor)						
1/e	Si e konsideroni stadin aktual të rregullores dhe standardeve të vendosura për furnizimin me energji elektrike?						
2	Si e gjykoni sigurinë e furnizimit me energji elektrike në zonën tuaj?						
2/a	Si është situata me ndërprerjet e energjisë elektrike në ndërtesën tuaj (1 > 3orë/ditë; 2 = 0-3orë/ditë; 3 = disa ndërprerje të shkurtra/muaj; 4 = ndonjë ndërprerje e lajmëruar në vit; 5 = nuk ndërpritet energjia elektrike)						
2/b	Si e gjykoni aksesin në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike në zonën tuaj?						

2/c	A lajmëroheni për ndërprerje të planifikuara të energjisë elektrike në zonën tuaj? (1=fare; 2=rrallë; 3=një herë në ditë në media lokale; 4=2-3 herë në ditë në media lokale; 5=njoftohemi me siguri në media kombëtare disa herë/ditë ose me njoftim me shkresë nga OSHEE)						
2/d	Sa ndikon niveli investimeve në sigurinë e furnizimit me energji elektrike? (1=aspak - duhen eliminuar vjedhjet jo të prishen para të tjera; 2=pak - duhet luftuar korrupsioni brenda OSHEE; 3=ndikim normal në uljen e humbjeve dhe rritjen e sigurisë së furnizimit; 4=ndjeshëm - rrjeti aktual është i amortizuar; 5=shumë - duhet investuar smart që të merret efekti maksimal)						
3	Si e vlerësoni shërbimin e OSHEE ndaj klientëve?						
3/a	Sa lehtësisht i regjistroni ankesat?						
3/b	Si e vlerësoni shpejtësinë dhe saktësinë e përgjigjes për ankesat tuaja?						
3/c	Si është etika e sjelljes në zyrat e shërbimit ndaj klientëve?						
3/d	Si e vlerësoni kompetencën dhe profesionizmin e punonjësve në shërbim ndaj klientëve jo-familiarë privatë?						
3/e	Si e vlerësoni shërbimin në procesin e lidhjeve të reja?						
3/f	Si e vlerësoni standardin teknik për lidhjet e reja?						
4	Si e vlerësoni shërbimin e shpërndarjes së energjisë elektrike?						
4/a	Riparimi difekteve?						
4/b	Si është saktësia e faturimit?						
4/c	A është e mundur të manipulohet rrjeti i shpërndarjes? (1=lehtësisht po; 2=po; 3=me ndihmën e një elektrikisti; 4=e vështirë por me ndihmën e një punojësi të korruptuar të OSHEE; 5=shumë e vështirë)						

4/d	A vidhet energjia elektrike në zonën tuaj? (1=shumë - ne paguajmë për vjedhësit; 2=vidhet atje ku rrjeti është i amortizuar; 3=kemi dëgjuar që është e mundur; 4=raste sporadike; 5=aspak)						
4/e	Si e gjykoni cilësinë e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në zonën tuaj?						
4/f	Sa është e lidhur performanca e rrjetit me nivelin e investimeve në rrjet? (1=aspak; 2=pak; 3=nuk ndikon; 4=ndikon mjaft; 5=ndikon shumë)						
5	Si e gjykoni sistemin e ri tarifor të energjisë elektrike në Shqipëri? (1=shumë më të shtrejtë se sistemi i vjetër; 2=më i shtrejtë se sistemi i vjetër; 3=nuk ka ndryshim në efekt fundor; 4=më ekonomik; 5=shumë më ekonomik)						
5/a	Si e gjykoni sistemin e ri tarifor të përlogaritur në bazë të aksesit për nivel tensioni në krahasim më sistemin e tarifimit me baze sektori? (1=i padrejtë; 2=nuk ka sjellë ndryshim; 3=racional; 4=i drejtë; 5=shumë i saktë)						
5/a1	Sa përqind të kostove tuaja të biznesit zë konsumi i energjisë elektrike? (1=peshë shumë të rëndësishme - deri 15%; 2=i rëndësishëm - 7-15%; 3=i përballueshëm - 5-7%; 4=i ulët - 3-5%; 5=i parëndësishëm - nën 3%)						
5/b	Si e gjykoni liberalizimin e tarifave të energjisë elektrike? (1=tarifa do të jetë shumë e lartë; 2=tarifa do të jetë pak më e lartë; 3=tarifa nuk do ndryshojë si shifër mesatare vjetore; 4=tarifa do të jetë më e ulët; 5=tarifa do të jetë shumë më e ulët)						
5/c	Si e konsideroni liberalizimin e tregut të energjisë elektrike? (1=vështirësi shumë e lartë për t'u furnizuar me energji elektrike; 2=e vështirë për t'u furnizuar të sigurtë; 3=nuk kërcënon sigurimin e furnizimit - ka një furnizues të mundësisë së fundit; 4=mundësi për rritjen e sigurisë së furnizimit; 5=siguri dhe eficiencë e lartë furnizimi me energji elektrike)						
5/d	Si e konsideroni liberalizimin e tregut të energjisë elektrike nga pikepamja e eficiencës? (1=aspak eficient -						

	kosto shumë më të larta furnizimi; 2=do të rrisë kostot e furnizimit me energji elektrike të fundorëve; 3=kushte ekonomike të furnizimit të njehta dhe pavarësi në zgjedhjen e furnizuesit; 4=cmime energjie elektrike më të ulta; 5=cmime energjie elektrike, por edhe të energjive alternative shumë më të ulta në treg)						
5/e	Si është energjia elektrike në krahasim me energjitë e tjera? (1=shumë e shtrenjtë; 2=e shtrenjtë; 3=njësor; 4=e lirë; 5=shumë e lirë)						
5/f	Sa është struktura juaj e kapitalit (kapital qarkullues/mjete themelore)	1/1 -1/2	1/3-1/5	1/5-1/10	1/10-1/20	> 1/20	
6	Sa janë të ardhurat vjetore të biznesit tuaj? (milion lekë)	- 5	5-8	8-40	40-80	80-150	< 150
7	Sa është sipërfaqja prodhuese/shërbyese e biznesit tuaj? (m ²)	-100	100-200	200-300	300-500	500-1000	> 1000

Pyetësi për përdoruesit jo-familiarë buxhetorë dhe jo-buxhetorë

Nr	Pyetja	Shkalla Likert					
		>> Keq	Keq	Mesatar	Mirë	>> Mirë	Nuk e di
		1	2	3	4	5	
1	Si e vlerësoni cilësinë e furnizimit me energji elektrike krahasuar me periudhën para vitit 2014?						
1/a	Si është niveli i tensionit në ndërtesën tuaj?						
1/b	Si është niveli i rrymës elektrike që furnizohet?						
1/c	Sa i sigurtë (safe) është rrjeti i energjisë elektrike i instaluar në ndërtesën tuaj?						

1/d	Si është ngarkesa e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në fidrin ku furnizoheni? (1=shumë e mbingarkuar; 2=e mbingarkuar-nuk i përgjigjet fuqisë së instaluar në zonë në cdo orë të ditës; 3=brenda parametrave aktualë të rregullores; 4=e pranueshme - garanton funksionim normal të fuqisë së instaluar në zonë; 5=brenda standardeve moderne - garanton një rritje të biznesit në zonë për një afat të gjatë kohor)						
1/e	Si e konsideroni stadin aktual të rregullores dhe standardeve të vendosura për furnizimin me energji elektrike?						
2	Si e gjykoni sigurinë e furnizimit me energji elektrike në zonën tuaj?						
2/a	Si është situata me ndërprerjet e energjisë elektrike në ndërtesën tuaj (1 > 3orë/ditë; 2 = 0-3orë/ditë; 3 = disa ndërprerje të shkurtra/muaj; 4 = ndonjë ndërprerje e lajmëruar në vit; 5 = nuk ndërpritet energjia elektrike)						
2/b	Si e gjykoni aksesin në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike në zonën tuaj?						
2/c	A lajmëroheni për ndërprerje të planifikuara të energjisë elektrike në zonën tuaj? (1=fare; 2=rrallë; 3=një herë në ditë në media lokale; 4=2-3 herë në ditë në media lokale; 5=njoftohemi me siguri në media kombëtare disa herë/ditë ose me njoftim me shkresë nga OSHEE)						
2/d	Sa ndikon niveli i investimeve në sigurinë e furnizimit me energji elektrike? (1=aspak - duhen eliminuar vjedhjet jo të prishen para të tjera; 2=pak - duhet luftuar korrupsioni brenda OSHEE; 3=ndikim normal në uljen e humbjeve dhe rritjen e sigurisë së furnizimit; 4=ndjeshëm - rrjeti aktual është i amortizuar; 5=shumë - duhet investuar smart që të merret efekti maksimal)						
3	Si e vlerësoni shërbimin e OSHEE ndaj klientëve?						
3/a	Sa lehtësisht i regjistroni ankesat?						

3/b	Si e vlerësoni shpejtësinë dhe saktësinë e përgjigjes për ankesat tuaja?						
3/c	Si është etika e sjelljes në zyrat e shërbimit ndaj klientëve?						
3/d	Si e vlerësoni kompetencën dhe profesionizmin e punonjësve në shërbim ndaj klientëve jo-familiarë buxhetorë dhe jo-buxhetorë?						
3/e	Si e vlerësoni shërbimin në procesin e lidhjeve të reja?						
3/f	Si e vlerësoni standardin teknik për lidhjet e reja?						
4	Si e vlerësoni shërbimin e shpërndarjes së energjisë elektrike?						
4/a	Riparimi difekteve?						
4/b	Si është saktësia e faturimit?						
4/c	A është e mundur të manipulohet rrjeti i shpërndarjes? (1=lehtësisht po; 2=po; 3=me ndihmën e një elektrikisti; 4=e vështirë por me ndihmën e një punojësi të korruptuar të OSHEE; 5=shumë e vështirë)						
4/d	A vidhet energjia elektrike në zonën tuaj? (1=shumë - ne paguajmë për vjedhësit; 2=vidhet atje ku rrjeti është i amortizuar; 3=kemi dëgjuar që është e mundur; 4=raste sporadike; 5=aspak)						
4/e	Si e gjykoni cilësinë e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në zonën tuaj?						
4/f	Sa është e lidhur performanca e rrjetit me nivelin e investimeve në rrjet? (1=aspak; 2=pak; 3=nuk ndikon; 4=ndikon mjaft; 5=ndikon shumë)						
5	Si e gjykoni sistemin e ri tarifor të energjisë elektrike në Shqipëri? (1=shumë më të shtrejtë se sistemi i vjetër; 2=më i shtrejtë se sistemi i vjetër; 3=nuk ka ndryshim në efekt fundor; 4=më ekonomik; 5=shumë më ekonomik)						

5/a	Si e gjykoni sistemin e ri tarifar të përlogaritur në bazë të aksesit për nivel tensioni në krahasim me sistemin e tarifimit me bazë sektori? (1=i padrejtë; 2=nuk ka sjellë ndryshim; 3=racional; 4=i drejtë; 5=shumë i saktë)						
5/b	Sa përqind të kostove tuaja zë konsumi i energjisë elektrike? (1=peshë shumë të rëndësishme - deri 15%; 2=i rëndësishëm - 7-15%; 3=i përballueshëm - 5-7%; 4=i ulët - 3-5%; 5=i parëndësishëm - nën 3%)						
5/c	Si e gjykoni liberalizimin e tarifave të energjisë elektrike? (1=tarifa do të jetë shumë e lartë; 2=tarifa do të jetë pak më e lartë; 3=tarifa nuk do ndryshojë si shifër mesatare vjetore; 4=tarifa do të jetë më e ulët; 5=tarifa do të jetë shumë më e ulët)						
5/d	Si e konsideroni liberalizimin e tregut të energjisë elektrike? (1=vështirësi shumë e lartë për t'iu furnizuar me energji elektrike; 2=e vështirë për t'iu furnizuar të sigurtë; 3=nuk kërcënon sigurimin e furnizimit - ka një furnizues të mundësisë së fundit; 4=mundësi për rritjen e sigurisë së furnizimit; 5=siguri dhe eficiencë e lartë furnizimi me energji elektrike)						
5/e	Si e konsideroni liberalizimin e tregut të energjisë elektrike nga pikepamja e eficiencës? (1=aspak eficient - kosto shumë më të larta furnizimi; 2=do të rrisë kostot e furnizimit me energji elektrike të fundorëve; 3=kushte ekonomike të furnizimit të njejta dhe pavarësi në zgjedhjen e furnizuesit; 4=cmime energjie elektrike më të ulta; 5=cmime energjie elektrike, por edhe të energjive alternative shumë më të ulta në treg)						
5/f	Sa është e mundur për klientët buxhetorë dhe jo-buxhetorë të blejnë energji në tregun e parregulluar në kohë reale nën ligjin aktual të Prokurimeve Publike? (1=e pamundur; 2=e vështirë; 3=e mundur por kërkohen rregullime dhe përjashtim nga procedurat standard për buxhetorë dhe jo-buxhetorë; 4=e mundur dhe siguri në kohë të energjisë pa bërë ndryshime ligjore; 5=pa asnjë						

	vështirësi nëpërmjet një planifikimi në kohë të blerjes së energjisë elektrike)						
5/g	Si është energjia elektrike në krahasim me energjitë e tjera? (1=shumë e shtrenjtë; 2=e shtrenjtë; 3=njësor; 4=e lirë; 5=shumë e lirë)						
6	Sa është struktura juaj e kapitalit (kapital qarkullues/mjete themelore)	1/1 -1/2	1/3-1/5	1/5-1/10	1/10-1/20	> 1/20	
7	Sa janë të ardhurat vjetore të biznesit tuaj? (milion lekë)	- 5	5-8	8-40	40-80	80-150	< 150
8	Sa është sipërfaqja prodhuese/shërbyese e biznesit tuaj? (m ²)	-100	100-200	200-300	300-500	500-1000	> 1000

BIBLIOGRAFIA

1. Vendimi i ERE *ËPër ristrukturimin e tarifave për Prodhuesit Privatë të Energjisë Elektrike*, Dhjetor 2014.
2. *Plani i rimëkëmbjes financiare të sektorit të energjisë elektrike 2015-2019*, Shkurt 2015
3. *Plani i konsolidimit financiar të sektorit publik elektro-energjitik 2017-2022*, Janar 2019
4. *Plani strategjik i masave për reformimin e sektorit të energjisë*, Dhjetor 2018
5. *Metodologjia e përcaktimit të tarifave fikse të energjisë*, VKM Nr. 125/2015
6. Vendimi i ERE Nr. 27/2015 *ËPër përcaktimin e tarifave të blerjes së energjisë nga prodhuesit prioritarë*
7. Raportet Vjetore të ERE 2017-2019
8. VKM 322, dt. 18.05.2019, *ËPër krijimin dhe përcaktimin e formës ligjore dhe strukturës së pronësisë së kapitalit të operatorit të tregut*
9. Bilancet dhe pasqyrat financiare të çertifikuara të OSHEE 2014-2019
10. M. Shahidehpour, H. Yamin and Z. Li, *Market operations in electric power systems - Forecasting, scheduling and risk-management*, 2002
11. Paketa e Tretë e energjisë, direktiva e BE 2009/72/EC
12. https://ec.europa.eu/energy/topics/energy-strategy/clean-energy-all-europeans_en
13. Clean energy for all Europeans package, 2015
14. United Nations Kyoto Protocol to the United Nations Framework Convention on climate change. <http://unfccc.int/resource/docs/convkp/kpeng.html>, 1997
15. Madarshahian MM, Afsharnia S, Ghazizadeh MS, *Optimal investment of distributed generation in restructured power system*, IEEE Bucharest power tech conference, Romania, 2009
16. Hajizadeh A, Hajizadeh E, *PSO-based planning of distribution systems with distributed generations*, Int J Electr Comput Syst Eng 2(1), 2008
17. Acharya N, Mahat P, Mithulananthan N, *An analytical approach for DG allocation in primary distribution network*, Electr Poëer Energy Syst 28, 2006
18. Berg A Krahl S Paulun T, *Cost-efficient integration of distributed generation into medium voltage networks by optimized network planning. Smartgrids for distribution*, IET-CIRED. CIRED Seminar, Frankfurt, 2008
19. Amit Saraswat, Ashish Saini, Ajay Kumar Saxena, *ËDay-Ahead Zonal Reactive Poëer Market Clearing Model for Competitive Markets: A Multi-objective Approach*, Computational Intelligence and Communication Networks (CICN) 2012 Fourth International Conference on, pp. 709-713, 2012
20. Manuel Alvarez, Sarah K. Rönnberg, Math H.J. Bollen, Rafael Cossent, Jin Zhong, *ËRegulatory matters affecting distribution planning with distributed generation*, CIRED - Open Access Proceedings Journal, vol. 2017, no. 1, pp. 2869-2873, 2017
- Helena Gerard, Enrique Israel Rivero Puente, Daan Six, *Coordination between transmission and distribution system operators in the electricity sector: A conceptual framework*, Elsevier, 2018, volume 50, pages 40-48

21. Seung Wan Kim, Michael G. Pollitt, Young Gyu Jin, Jip Kim and Yong Tae Yoon, *Contractual framework for the devolution of system balancing responsibility from the transmission system operator to distribution system operators*, EPRG, University of Cambridge, October 2017

Publikime

- Jaho I and Metalla O, **“The sustainable destination structure, for sustainable tourism demand – selective marketing for sustainable tourism demand for unpolluted areas”** 2021, EUSER Journals (European Journal of Economics and Business) in press;
- Jaho I and Metalla O, **“Enlarginig to regional and international market – to increase security of power supply for the country: Albanian case”**, 2021 IJECM (International Journal of Economics, Commerce and Management) UK, ISSN 2348 0386, Vol IX, Issue10, Page 88.
- Jaho I and Metalla O, **“The new tariff scheme for electric energy, a better approach to open market economy”**, 2021. IJECM (International Journal of Economics, Commerce and Management) UK, id ED911-4, vol 9 issue 11 page 388.
- Metalla O, Jaho I **“Consequences of Cov-19 in SME”**, 11th International Scientific Conference of Business Faculty ñEconomic Policy and EU Integrationò, Durres, Albania 27-29 May, 2021. Proceedings, Book of abstracts page 76.
- Jaho I, **“Imperfect Competition-Hydroacarbon market, Albanian Case”**, 2021, International Interdisciplinary Conference ñEducation and Culture in Contemporary Society. N2021 UNIKO, Int Conf, 210/14, proceedings page 162.
- Jaho, I **“Sustainable and health tourism models in a local content development - Thermal tourism at Llixha of Elbasan Albania”**, 2021 IIPCCL (International Institute for Private Commercial and Competitve Law) International Scientific Conference ICSNS XVIII, Barcelona 2021. Proceedings book page 53.

Ky punim merr në analizë të thelluar fillimisht gjendjen e sektorit elektro-energjitik shqipëtar në vitet 2013-2014, faktet dhe problemet e tij të akumuluar ndë vite gjatë të gjithë ndryshimeve që ai ka pësuar. Ai shqyrton zbatimin e reformave në sektor para vitit 2014 si në reformimin e tij, ashtu edhe në përafrimin e legjislacionit dhe kuadrit rregullator që nga viti 2004 si dhe efektet që ka dhënë zbatimi i këtyre reformave në mirëmenaxhimin e sektorit. Më tej, punimi analizon të gjithë situatën nën këndvështrimin e gjetjeve të lidhura me këtë periudhë të zhvillimit të sektorit, për të renditur të gjithë elementët për të cilët kërkohet ndërhyrje dhe ndryshim, në mënyrë që të garantohej një performancë e rritur e sektorit dhe një reformim i plotë i tij sipas direktivës europiane dhe paketës së tretë të energjisë 2009/72/EC [Rregullorja për energjinë elektrike (EC) nr. 714/2009 dhe Rregullorja ACER, nr. 713/2009 e përmirësuar në lidhje me qasjen mjedisore me direktivën europiane 2009/72/EC], e cila mbulonte pesë aspekte të rëndësishme: ndarjen e plotë dhe daljen më vete të operatorëve të sistemit të transmetimit dhe atij të shpërndarjes, pavarësia e rregullatorit ERE, anëtarësimi në ACER dhe certifikimi, kooperimi ndër kufitar dhe tregje të hapura e të drejta.

This dissertation takes in deep analyses, initially the situation of the electro-energy sector of the years 2013-2014, facts and the accumulated problems during the changes undergone through the years. A revision of the implemented reforms of the sector before 2014 and in its reforming period, also approximation of laws and regulatory framework since 2004 and the effects derived from the implementation of the reforms on a better management of the sector. Further, the dissertation analyses all the situation under the perspective of the findings connected with this developing period of the sector, to list all the elements for which was necessary an intervention in order to guarantee a higher performance of the sector and a full reformation pursuant to the European directive and third energy package 2009/72/EC [Policy for the electric energy (EC) no. 714/2009 and Policy ACER, no. 713/2009 improved in connection with the environmental approach of the European directive 2009/72/EC], which covered five important aspects: undoubling process separation of the transsmition and distribution system, independence of the regulatory body ERE, membership in ACER and certification, crossborder collaboration and open and fair markets.